ISSN 1857-6443

Emri "Maqedonia e Veriut" çështje orësh!

Fq.3

REFORMAT GJYQËSORE

Lidhja me politikën e ka rrënuar gjyqësorin

Fq.5

DEMIRI, "Team Manager" i ri i ekipit

Fq.19

www.koha.mk

Koha

Kroati që mposhti sistemin

Fq.22

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3384 · E premte, 8 qershor 2018 · 16°c | 32°c · 15 DEN

AKTUALE

Zbuten dënimet

Deputetët e Kuvendit të Maqedonisë në muajin shtator duhet të votojnë plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit për Kundërvajtje. Paraprakisht deri në fund të muajit qershor pritet të kalojnë edhe filtrat qeveritar. Me ndryshimet e ligjit, parashikohet që gjobat maksimale për personat fizik apo qytetarët të jenë 500 euro, ndërsa dënimet për personat juridik apo bizneset të kenë vlerën deri në 1000 euro në kundërvlerë të denarit. "Qëllimi i zgjidhjes...

Fq.7

GLOBI

BE hakmerret ndaj SHBA, tarifa ndaj importeve amerikane

Fq.15

RAJON

Shtetet që kundërshtojnë anëtarësimin e Shqipërisë në BE

Fq.14

GJYSMA E PAGËS HARXHOHET PËR USHQIM

FITOJMË 300, HARXHOJMË 600 EURO!

Të ardhurat mujore mesatare të një punësuari në Maqedoni prej afër 400 euro mezi mjaftojnë për mbulimin e shpenzimeve jetike si banimi apo ushqimi. Këtë e dëshmojnë edhe analizat e sindikalistëve, sipas të cilave, 13.394 denarë nevojiten në muaj që të mbulohen vetëm nevojat themelore për ushqim, ndërsa afër 10 mijë denarë kushtojnë harxhimet e banimit për një familje katër-anëtarëshe

Fq.6

Regjistrimi pa komponentën etnike s'ka kuptim

Shkup, 7 qershor - "Çdo regjistrim i popullatës në Maqedoni që do të realizohet në të ardhmen në regjistrin nuk do të ketë numërim të popullsisë edhe sipas përkatësisë etnike, jo vetëm për shqiptarët si popull në por as dhe partitë politike shqiptare ky regjistrim është i pa pranueshëm". Kështu shkruan ne statusin e tij në Facebok, akademiku Izet Zeqiri. Ai thotë së Maqedonisë i duhet regjistrim i popullsisë, i cili do të sigurojë një tabllo të saktë të shtimit të popullsisë në Maqedoni edhe sipas përkatësisë etnike. "Në shumicën e vendeve në çdo dhjetë vjet bëhet regjistrimi i popullsisë, ndërsa studime pilot bëhen edhe më shpesh. Shikuar historikisht, regjistrimet e realizuara deri tash në Maqedoni janë bërë në vitin: 1953, 1961,1971, 1981, 1991 (dhe 1994 mos pranimi i rezultateve) dhe regjistrimi...

Fq.4

EDITORIAL

"LAVATRIÇJA" E SHPËLARJEVE DEMOGRAFIKE

Emin AZEMI

Nesër, pasi të mbahet regjistrimi, do të thuhet se në Maqedoni jeton një grumbull insanësh pa përkatësi etnike e religjioze. Dhe sigurisht që dikush nuk po do të futet në rubrikat e frikshme të tkurrjes etnike. Fobia nga shifrat është shndërruar në makth që pamëshirshëm mbërthen ndjenjën e të qenit i vogël

Regjistrimet që na tregojnë se sa banorë ka Maqedonia, janë gjysmake nëse nuk dihet se kush e përbën atë popullatë. Drejtori i Entit të Statistikave ka mundur të sheh ndonjë ëndërr në pikë të drekës, por atë s'e ndihmon naiviteti i shtirur se gjoja komponenta etnike qenka fare pa rëndësi në një proces regjistrimi. Madje, çfarë kuptimi ka regjistrimi, nëse njerëzit e etnive të ndryshme që jetojnë në Maqedoni nuk e dinë se janë shtuar, apo pakësuar.

Dikur insistohej me të madhe që të mbahet regjistrimi dhe "ta shohin shqiptarët se sa pak janë". Këtë e thoshin nacionalistët maqedonas, kurse tani kalohet në një ekstrem tjetër. Regjistrim pa komponentën etnike e fetare, po kërkohet. Nesër, pasi të mbahet regjistrimi, do të thuhet se në Maqedoni jeton një grumbull insanësh pa përkatësi etnike e religjioze. Dhe sigurisht që dikush nuk po do të futet në rubrikat e frikshme të tkurrjes etnike. Fobia nga shifrat është shndërruar në makth që pamëshirshëm mbërthen ndjenjën e të qenit i vogël.

Shqiptarët në Maqedoni kanë nevojë të dinë gjendjen reale, jo se me këtë ndryshon qasja radikale ndaj tyre, por është me rëndësi të dihen specifikat demografike që përcaktojnë edhe statusin juridik e politik. Nëse në të kaluarën kishte një diskriminim pozitiv që favorizonte logjikën e numrave për të shprehur politikën e përfaqësimit adekuat, sot kalohet në një diskriminim tjetër, duke ua mohuar njerëzve të deklarohen lirshëm se cilës përkatësi etnike i takojnë.

Regjistrimi i popullsisë në vetvete përbën një filozofi zhvillimi që shtetet e ndjekin për të matur parametrat e caktuar në një rrafsh më të gjerë identifikimi të problemeve sociale, ekonomike, urbane, etno-kulturore etj. Sikur të mos ishin këto atribute, nuk do ta kishim edhe strukturën e shoqërisë. Nëse bien këto atribute, bie edhe struktura. Me fjalë të tjera, Maqedonia do të popullohej prej një grumbulli njerëzish me identitet anonim etno-kulturor dhe si i tillë ky shtet do të shndërrohej në një "lavatriçe" që ua fshin banorëve etiketën e përkatësisë etnike. Mund ta imagjinojmë se si në atë "lavatriçe" hyjnë njerëzit me idenë që të pastrojnë vetullat dhe të mbeten pa sy. Vetëm kështu, të verbër,njerëzit mund të jenë të dobishëm për një të ardhme orveliane ku "kooperativa" demografike bluan identitetet dhe e shndërron në zomb gjithë atë masë amorfe njerëzish. Anonimiteti si zgjidhje idiote mund të jetë pasioni i fundit i ndonjë drejtori të Statistikave, i cili mundohet të fusë nën tavolinë një ofertë parapolitike, si test për të provuar (mos)gatishmërinë e pranimit apo refuzimit të një zgjidhje të tillë.

Joseriozitetiër të propozuar një regjistrim pa komponentën e strukturës etnike, nuk është thjeshtë ide e njerëzve që zgjohen në mes të natës nga sikleti i pagjumësisë. Ata mund të kenë edhe ndonjë siklet tjetër, por me ide të tilla, më së paku mund të shuajnë këto siklete. Përkundrazi, mund të nxisin kundërefekte.



BATON HAXHIU NË PANAIRIN E MEDALJEVE PRESIDENCIALE

"Sipas shtypit britanik Baton Haxhiu është vrarë nga forcat serbe me 28 mars 1999. Vrasjen e tij e dokumentojne të gjitha gazetat britanike, përfshirë prestigjiozen e përditshme 'The Independent' që shihet në këtë postim. Kjo gazetë, sikur edhe të gjitha tjerat, kanë botuar edhe përkujtim mortor (Obituary) për Batonin.
Kjo gazetë, në mes tjerash, për Batonin e vrarë thotë: 'Haxhiu ka qenë intelektual tipik shqiptar i Kosovës. Ai ka qenë shumë i lexueshëm, kozmopolit dhe mendjeprehtë... Por, Haxhiu ka qenë edhe dëgjues. Gjithmonë i gatshëm që të mësoj dhe angazhohet me vullnet në diskutime...' Dhe, më tutje, vazhdojnë lavdëratat e varguara për të ndjerin.
Por, ne të gjithë e dijmë që Batonin nuk e ka vra askush, madje as forcat okupuese serbo-qetniko-ruso-sllavo-bizantine. Jo. Batoni ka mbetë gjallë dhe ka vazhduar që ta çorodis skenën e gazetarisë dhe atë të politikës shqiptare. Dhe, mu kjo është arsyeja që ai është dekoruar nga një çoroditës tjetër – presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.
Dorën në zemër, nuk ishte vetëm Batoni që mori medalje për çoroditje. U dekoruan edhe çoroditës tjerë. U dekoruan mu ata që më së shumti e kanë dëmtuar prospektin e ardhmërisë së shëndoshë të Kosovës. Ky dekorim është një veprim entuziast që insiton të vërtetoj që shoqëria dhe shteti i Kosovës janë degraduar deri në nivelin më të ulët për të dështmuar se në Kosovë më nuk eksiton asnjë vlerë. Sidoqoftë, këto dekorime në mua e zgjojnë një ndjenjë të lezetshme të fëmijërisë. Dikur, kur ishim fëmijë, në qytetin tonë (Gilan) organizohej panagjyri dy herë në vit. Kjo ishte koha kur ne blenim nga janjevalitë pibëza dhe filikaqa. Sa për sqarim, pibëzat e kanë patur formën e minitrumpetave. Pibëzat dhe filikaqat i virnim në qafë me një tojë dhe fishkëllonim me to tërë ditën. Kështu më duken edhe këto medaljet që i morën çoroditësit. Do të ishte gjithçka në rregull sikur këto medaljet e tyre të kishin formën e pibëzave, pra minitrumpetave, por më të mëdha, në mënyrë që t'i fusin prajshëm në prapanicë", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti Daut Dauti.

KAPJA E SHTETIT

"Me këtë kapje të shtetit dhe luftë të brendshme si nga VMRO-ja dhe LSDM-ja, në etapa të ndryshme politike, klasa dogmatike maqedonase i ka penguar edhe qytetarët shqiptarë të Maqedonisë. Përgjegjësia në një farë shkalle është edhe tek klasa e korruptuar politike shqiptare e cila i ka dëmtuar interesat e votuesve shqiptarë.
Një bllokadë tipike e mungesës së vetëdijes politike europiane tek liderët i mban peng qytetarët. Nëse kryeministri dhe koalicioni i tij do të qeverisë drejtë dhe duke i bërë ndryshimet e domosdoshme, Maqedonia ka gjasa të demokratizohet dhe të transformohet.
Nëse me një stil bizantin do t'i trajtojë problemet e statusit të shqiptarëve, ashtu siç ndodhi që nga vitet e komunizmit, atëherë kohezioni i kërkuar s'do arrihet", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, analisti Selim Ibraimi.

MEDIACitate

AFGANISTAN, NË 9 VITET E FUNDIT KANË HUMBUR JETËN MBI 23 MIJË CIVILË

Kryetari i Komisionit për të Drejtat e Njeriut në Afganistan, Sima Semer, njoftoi se në ngjarjet e dhunshme në vend në 9 vitet e fundit kanë humbur jetën 23.130 civilë. Semer, në konferencën për media në kryeqytetin Kabul, tha se si rezultat i hulumtimeve të kryera për 69.8 për qind të vdekjeve civile janë përgjegjës organizatat terroriste. Ai gjithashtu theksoi se në 9 vitet e fundit gjithashtu janë plagosur 40.974 persona për shkak të sulmeve dhe përleshjeve, prej të cilëve 7.5 për qind e viktimave përbëjnë gratë ndërsa 17,9 për qind fëmijë. Semer tërhoqi vëmendjen për nevojën e një ligji që do t'i mbrojë të drejtat e viktimave.

(Anadolu Agency, 7 qershor)

KOKA E KËPUTUR E GJARPRIT KAFSHON NJË PERSON

Një person në SHBA është kafshuar nga koka e këputur e gjarprit me zile. Sipas lajmit të BBC, një person në shtetin amerikan Teksas, deri sa ishte duke u marrë me punët në kopsht, është përballur me një gjarpër me zile, i gjatë 1.2 metra të cilit ia preu kokën. Ai përderisa ishte duke e hedhur trupin e gjarprit në mbeturina, koka e këputur e gjarprit e kafshon atë. Bashkëshortja e ti, Jennifer Sutcliffe, tha se bashkëshorti i saj ishte rrëzuar pas kafshimit të gjarprit. Ajo tha bashkëshortin e saj e kanë dërguar në spital me helikopter i është dhënë 26 dozë antidot, ndërsa shërimi i tij ka marrë kohë dhe se ka patur ende probleme në veshkë.

(REL, 7 qershor)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KU NDODHEN MALET E VETËTIMËS?

Malet e Vetëtimës janë një pjesë e malit të Çikës, faqja perëndimore e tij që ngrihet menjëherë mbi fshatrat Palasë, Dhërmi e Vuno. Përbëjnë pjesën më të lartë, më të ashpër dhe më të thyer të gjithë Çikës, për shkak të shtrirjes së tyre në kontaktin e zonës tektonike Jonike me atë të Sazanit. Malet e Vetëtimës janë të përçarë nga përrenj të thatë e humnera shumë të thella. Janë të veshur dobët me bimësi, në pjesën e ulët me makje e në pjesën e lartë me halorë. Përmenden nga autorët antikë me

emrin Akrokeraune dhe shënohen edhe në hartat e vjetra.

AFËR EPILOGUT PËR EMRIN

"MAQEDONIA E VERIUT" ÇËSHTJE ORËSH!

Përdorimi i emrit, gjegjësisht erga omnes është pyetja kryesore në të cilën, sipas mediave greke, Athina pret përgjigje pozitive nga kryeministri Zaev. Lidhur me emrin, edhe krahas asaj që as pala e Maqedonisë dhe e Greqisë publikisht dhe zyrtarisht nuk i hapin hartat nëse ekziston marrëveshje, mediat në Greqi, tashmë disa ditë pohojnë se është dakorduar "Republika e Maqedonisë Veriore"

Koha — Fatos RUSHITI

Shkup, 7 qershor - Zëvendëskryeministri për çështje evropiane Bujar Osmani të enjten në Bruksel gjatë takimit me Komisaren evropiane për politikë të jashtme dhe çështje të sigurisë, Federika Mogherini, ka folur për progres serioz dhe epilog pozitiv të zgjidhjes së çështjes së emrit mes dy qeverive - asaj maqedonase dhe greke. "Kemi progres serioz dhe si asnjëherë më parë dy vendet nuk kanë qenë kaq afër zgjidhjes. Orët në vazhdim mund të jenë kyçe për epilogun e negociatave dhe shpresoj se epilogu eventual pozitiv do të krijojë atmosferë për thellimin e marrëdhënieve midis Maqedonisë dhe Greqisë, si dhe kushte për avancim të përshpejtuar të perspektivës euro-atlantike të Maqedonisë", ka thënë Osmani. Ai, në takim ka informuar për progresin e arritur në marrëdhëniet midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, duke shprehur kënaqësinë për përmirësimin e tyre, implementimin e masave të mirëbesimit, frenimin e përshkallëzimit të mospajtimeve politike, por edhe kënaqësinë me arritjet në bisedimet lidhur me çështjen për emrin.

Siç kanë informuar nga preshërbimi i SÇE-së, Osmani e ka informuar Mogerinin edhe për planin e ri të reformave - Planin 18, me të cilin Maqedonia mbetet e përkushtuar në procesin reformues edhe pas marrjes së rekomandimit dhe raportit pozitiv të Komisionit Evropian. "Plani 3-6-9 krijoi një bazë solide për implementimin e reformave thelbësore dhe afatgjata në drejtim të përafrimit të shoqërisë tonë me atë evropiane, me ç'rast, Plani 18 është vazhdimësi e logjikshme e agjendës reformatore të Qeverisë për koordinim sistematik dhe ndjekje e implementimit të këtyre reformave, deri në çeljen e negociatave", ka theksuar Osmani. Ai i ka shprehur pritjet e tij se progresi i arritur në implementimin e reformave, por edhe në evitimin e pengesave politike, do të valorizohet në mënyrë përkatëse në samitet vijuese të Bashkimit Evropian në fund të këtij muaji me ç'rast do të vuloset e ardhmja evropiane e Maqedonisë, por edhe orientimi euro-atlantik i të gjitha vendeve nga Ballkani Perëndimor.

Lidhur me bisedimet për zgjidhjen e kontestit shumë vjeçar me Greqinë, ambasadori amerikan në Shkup Xhes Bejli ka thënë të enjten se SHBA-tw tashmë një kohë të gjatë i jep mbështetje këtij procesi. Duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve në pauzën e Forumit të parë Energjetik të Maqedonisë, që të enjten dhe të premten po mbahet në Strugë në organizim të SHA ELEM dhe Institutit ZIP, Bejli tha se zgjidhja e këtij problemi afatgjatë do të sjellë të mira për të dyja vendet, por do të kontribuojë edhe për prosperitet dhe stabilitet të tërë rajonit.

"Vazhdojnë negociatat mes të dy vendeve me ndihmën e KB-së. Duke e pasur parasysh se është rast specifik, unë do t'ua lë të dy vendeve të gjejnë zgjidhje të përbashkët të pranueshme, të cilën qytetarët e presin një kohë të gjatë", tha Bejli. Ndihmës-sekretari shtetëror i Evropës dhe Euroazisë, Ves Miçell, paraprakisht deklaroi se SHBA-ja vazhdon të luaj rol të qetë në procesin e zgjidhjes së kontestit të emrit mes Maqedonisë dhe Greqisë. "Para pak kohësh morëm qëndrim të përbashkët jo vetëm për Serbinë dhe Kosovën, por punojmë edhe për BeH, në çështjen e emrit mes Maqedonisë dhe Greqisë. Siç përmenda, një pjesë e ekipit tonë për momentin punon në këtë çështje, ndërsa SHBA-ja vazhdon të luaj rol të qetë me BE-në, Gjermaninë dhe të tjerët, duke e inkurajuar të gjendet zgjidhje për emrin, që ta shohim Maqedoninë si anëtare e NATO-s", tha Miçel në fjalimin e fondacionit Hetrixh, ku promovohet Strategjia e presidentit Donald Tramp për Evropën. Në kohën kur procesi është afër fundit, nga opozita greke kanë reaguar ashpër lidhur me deklaratën e ish-ministrit të Punëve të Jashtme, Antonio Milloshoski se kryeministri grek Aleksis Cipras është i gatshëm që ta obligojw shtetin për marrëveshje me IRJM-në. Nga partia më e madhe opozitare greke - Demokracia e Re kanë kërkuar informacione nga Nikos Koxiasi lidhur me deklaratat e Milloshoskit. Nga Demokracia e Re kumtojnë se kanë kërkuar informacione, por deri në këto momente nuk kanë marr përgjigje.

"Qëllimi i qartë i zotërinjve Cipras dhe Koxias është që ta vendosin shtetin dhe qytetarët para një akti përfundimtar. Edhe njëherë e paralajmërojmë kryeministrin: nuk ka legjitimitet politik që ta obligon vendin dhe do të ketë përgjegjësi të plotë personale nëse pranon marrëveshje që do të dëmtojnë interesat e Greqisë", kumtuan nga Demokracia e Re. Por Ministria e Punëve të Jashtme e Greqisë i është përgjigjur partisë opozitare greke se nuk është kompetente të informojë për deklaratat e VMRO-DPMNE-së. "Ministria e Punëve të Jashtme nuk është kompetente, as nuk ka për detyrë ta njoftojë Demokracinë e Re për deklarata nga opozita në IRJM (VMRO-DPMNE) parti si motër e Demokracisë së Re në Partinë Popullore Evropiane, deri te cila duhet të drejtohet, kumtohet nga MPJ-ja greke, lidhur me kumtesën e partisë opozitare greke dhen shtojnë se duke marrë parasysh atë se lideri i partisë Kirkakos Micotakis ndodhet në Munih, për kongresin e EPP, mund të gjejë kohë të informohet nga "miqtë e tij të VMRO-së". Siç lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina, nga Ministria e Punëve të Jashtme të Greqisë e porosisin Demokracinë e Re "herën tjetër kur do të dëshirojë të marrë informacion për ngjarjet në negociatat, do të ishte mirë drejtpërdrejt ta kërkojë nga ajo Ministri". Por për opinione gjerë të dyja vendeve por edhe atë rajonal dhe ndërkombëtar me interes po pritet përgjigja e kryeministrit Zaev ndaj pakos së dakorduar mes dy ministrave të punëve të jashtme për zgjidhjen e çështjes së emrit. Në pritje të bisedës telefonike dhe përgjigjes pozitive nga Zaevi, është komenti më i shpeshtë, por edhe titull në mediat greke lidhur me përgjigjen eventuale midis Maqedonisë dhe Greqisë. Gazetarët në Greqi, parashikojnë, duke iu referuar informacioneve të tyre, por edhe informacioneve të plasuara në mediat e Maqedonisë në periudhën e kaluar se biseda telefonike midis dy kryeministrave do të mund të ndodhë në ditët në vijim. Disa nga mediat komentojnë se në pyetje janë orë, të tjerë se janë në pyetje ditë që të mbyllet problemi shumëvjeçar midis Maqedonisë dhe Greqisë. Përdorimi i emrit, gjegjësisht erga omnes është pyetja kryesore në të cilën, sipas mediave greke, Athina pret përgjigje pozitive nga kryeministri Zaev. Lidhur me emrin, edhe krahas asaj që as pala e Maqedonisë dhe e Greqisë, publikisht dhe zyrtarisht nuk i hapin hartat nëse ekziston marrëveshje, mediat në Greqi, tashmë disa ditë pohojnë se është dakorduar "Republika e Maqedonisë Veriore". Siç lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina, negociatat midis të dy vendeve, në ditët e kaluara janë temë e përplasjeve midis Qeverisë greke dhe partisë opozitare Demokracia e Re.

RUSIA DËSHIRON TË ZGJIDHET ÇËSHTJA PËR EMRIN ME GREQINË

Ambasadori rus në BE, Vladimir Çizhov, bëri të ditur se Rusia dëshiron zgjidhje të çështjes së emrit midis Greqisë dhe Maqedonisë, raportoi korrespondenti i MIA-s në Bruksel. Çizhov në takim me gazetarët tha se "Rusia konsideron se perspektiva evropiane është dimension i globalizmit, por se zgjerimi i NATO-s është përpjekje për të zgjidhur sfidat e shekullit 21 me mjete nga shekulli 20". "Nuk do të duartrokasim nëse Maqedonia bëhet pjesë e NATO-s", tha Çizhov.

PROTESTË E RE NË ATHINË MË 8 KORRIK

"Mijëra qytetarë në mbarë Greqinë porositën se Maqedonia është greke", "24 qytete, një zë", "Mijëra qytetarë në rrugë, protestuan për Maqedoninë", "Maqedonia është greke brohoritnin mijëra qytetarë në mbi 20 qytete", "Në mënyrë të qetë dhe masive përfunduan protestat për Maqedoninë", "24 qytete në ritmin e protestave për çështjen e Shkupit", janë pjesë e titujve në mediat greke për protestat e mbrëmshme në mbarë Greqinë në të cilat "është mbrojtur karakteri grek i Maqedonisë". Mediat në Greqi, kryesisht në mënyrë pozitive i vlerësojnë protestat, si në krahasim me masivitetin, ashtu edhe në raport të porosive që ishin dërguar, ndërsa theksin e vendosin në faktin që tubimet përfunduan qetë dhe pa karakteristika partiake, ndërsa qytetarët dhe demonstruesit morën përkrahje nga politikanët opozitarë të vetëqeverisjes lokale në qytete, por edhe nga mitropolitët dhe priftërinjtë.

DILEMA TË PANEVOJSHME STATISTIKORE

REGJISTRIMI PA KOMPONENTËN ETNIKE S'KA KUPTIM

Është i papranueshëm çdo regjistrim që nuk parasheh përkatësinë etnike të popullatës, sepse ky nuk është thjeshtë një operacion statistikor, por edhe një projeksion politik, ekonomik e social

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 7 qershor - "Çdo regjistrim i popullatës në Maqedoni që do të realizohet në të ardhmen në regjistrin nuk do të ketë numërim të popullsisë edhe sipas përkatësisë etnike, jo vetëm për shqiptarët si popull në por as dhe partitë politike shqiptare ky regjistrim është i pa pranueshëm".

Kështu shkruan ne statusin e tij në Facebok, akademiku Izet Zeqiri. Ai thotë së Maqedonisë i duhet regjistrim i popullsisë, i cili do të sigurojë një tabllo të saktë të shtimit të popullsisë në Maqedoni edhe sipas përkatësisë etnike.

"Në shumicën e vendeve në çdo dhjetë vjet bëhet regjistrimi i popullsisë, ndërsa studime pilot bëhen edhe më shpesh. Shikuar historikisht, regjistrimet e realizuara deri tash në Maqedoni janë bërë në vitin: 1953, 1961,1971, 1981, 1991 (dhe 1994 mos pranimi i rezultateve) dhe regjistrimi i fundit i realizuar në vitin 2002 pas tri prolongimeve, prolongimi i parë ishte prej 1 Prillit të vitit 2001, i dyti prolongim ishte në vjeshtën e 2001 dhe i treti u caktua prej 1 Prilli të vitit 2002. Të gjitha këto prolongime janë bërë për arsye më të njohura për të gjithë për shkak të situatës pas luftës që ka mbretëruar në Maqedoni dhe mos besimit të shqiptarëve lidhur me definimin real të strukturës nacionale të popullsisë. Edhe regjistrim i 2011 dështoi duke u bazuar në problemet me të cilat hasen në këtë proces" shkruan akademiku Zeqiri.

Akademiku Izet Zeqiri më tej shkruan se është i domosdoshëm regjistrimi i popullsisë se statistikat demografike nuk kanë qenë tërësisht të përpikta deri tash dhe se shqiptarët nuk u kanë besuar të gjitha regjistrimeve të popullsisë.

"Shqiptarët nuk u kanë besuar statistikave shtetërore lidhur me numrin e popullsisë në ish-Jugosllavi po ashtu edhe në Maqedoni. Arsyet për këtë mosbesim qëndrojnë në mos transparencën dhe në mossigurimin e kushteve minimale teknike-organizative, juridike dhe politike për regjistrim nga ana shtetit. Shqiptarët nuk kanë pranuar të dalin në regjistrim ose pjesërisht e kanë refuzuar regjistrimin, sepse janë frikësuar nga manipulimet e ndryshme lidhur me numrin e popullsisë", shkruan akademiku Zeqiri. Sipas tij jo vetëm shqiptarët si popull por edhe partitë shqiptare në Maqedoni njëherë e përgjithmonë duhet ta kuptojnë se regjistrimi i popullatës është shumë i

rëndësihëm për strukturën nacionale të popullsisë në Maqedoni në zhvillimin ekonomik-shoqëror dhe politik.

"Në mënyrë të vazhdueshme duhet kërkuar një transparencë më të madhe në regjistrimin e popullsisë që të fitohet numri real i shqiptarëve në Maqedoni. Çështja e regjistrimit të popullsisë nuk guxon të sakrifikohet dhe të justifikohet pas formulës së "drejtësisë ndërkombëtare" se ai do të vëzhgohet nga Këshilli i Evropës dhe EUROSTAT-i. Regjistrimi duhet të ndiqet institucionalisht nga ekspertë shqiptarë të vendit, me qëllim që të mos ngadhënjejë sërish ai fat i "verbër" dhe i "padrejtë" historik lidhur me numrin e shqiptarëve në Maqedoni", shkruan akademiku Izet Zeqiri.

Edhe demografi Abaz Islami thotë se çdo regjistrim pa deklarimin e përkatësisë etnike s'ka kuptim. "Regjistrimi fundit i cili dështoi në vitin 2012 ishte pikërisht për shkak se grafa për përkatësinë etnike ua prishi elaboratin VMRO-DPMNE-së e cila me vite e kishte përgatitur që me çdo kusht të zvogëlojnë përqindje e shqiptarëve nga regjistrimi i viti 2002 edhe pse kishte manipulime të shumta ne teren që të mos regjistrohen shqiptarët. Ky regjistrim mund të jetë deri diku më i realt që tregoi se në Maqedoni jetojnë mbi 25 për qind shqiptarë e jo siç pretendonte VMRO-ja se jetojnë 17 për qind. Partitë shqiptare në pushtet dhe ato opozitare nuk duhet në asnjë mënyrë të lejojnë të realizohet një regjistrim i popullatës pa deklarim në bazë etnike dhe se jo vetëm që s'ka kuptim por që në start ende pa filluar regjistrimi do të dështojë", thotë Abaz Islami, demograf.

Pohimet e fundit zyrtare për Regjistrimin që është paralajmëruar për vitin 2020, dhe informacionet se nuk do jetë grafa e posaçme që do ta përcaktojë identitetin e popullatës, për Aleancnë për Shqiptarët janë të papranueshme, dhe tentativë qe ky regjistrim të dështojë siç kane dështuar regjistrimet e mëparshme.

"Regjistrimi i popullatës është standard i BE-së, që i njëjti të bëhet në çdo 10 vite, Maqedonia, e ka shkelur këtë të drejtë, dhe jo rastësisht edhe PSP, ka ngritur dyshim ndaj liderit të BDI-së, Ali Ahmetit dhe atij të VMRO-së, Nikolla Gruevskit për keqpërdorim të pozitave të tyre, duke ndikuar në mosrealizimin e regjistrimit të popullatës. Përqindja e shqiptarëve, është element i rëndësishëm politik, që ndërlidhet me barazinë politike dhe ekonomike me maqedonasit. Ky element do të hapte rrugë që shqiptarët mos të trajtohen si përqindje por si etnitet shqiptar, me ç'rast edhe elementi i shtetformësimit do ishte më i realtë ", thotë për KOHën, Flakron Bexheti, zëdhënës i Aleancës për Shqiptarët.

Ndërkohë, Tomisllav Tuntev deputetët i LSDM-së nënvizon se mirë që Maqedonia më në fund po bën përgatitjet për Eegjistrimin e popullatës, ndërsa sa i përket deklarimit të drejtorit të Entit Statistikor se në regjistrin nuk do të ketë grafë për përkatësinë etnike, e vlerëson si mendim të tij personal.

"Nëse bien dakord të gjitha partitë, atëherë Regjistrimi do të mbahet në prill të viti 2020 apo 2021 dhe se do të realizohet sipas standardeve ndërkombëtare dhe Kushtetutës së Maqedonisë. Maqedonia nuk mund të jetë shtet i vetëm në botë që do të numërojë popullatën dhe nuk do të regjistrojë deklarimet e përkatësive etnike. Në Maqedoni nuk jetojnë vetëm maqedonas dhe shqiptarë, por edhe përkatësi tjera etnike të cilët e kanë të drejtën të deklarohen ashtu edhe siç ndjehen", thotë Tomislav Tuntev, koordinator i partisë LSDM në pushtet. Ndërkaq nga Lëvizja BESA, tani partner koalicioni në Qeverinë e kryeministrit Zoran Zaev, shprehen se në fillim duan t'i dëgjojnë argumentet se pse nuk duhet të figurojë kjo grafë.

"Parimisht mendoj se informacioni për përkatësinë etnike i ndihmon funksionimit të shtetit, sepse tashmë edhe disa norma juridike në Kushtetutë dhe në ligje janë sanksionuar pikërisht përmes përqindjes së bashkësive etnike. Sidoqoftë, të presim konfirmimin zyrtar dhe pastaj do të kemi qëndrim përkatës", thotë Orhan Murtezani zëdhënës i lëvizjes BESA.

IZET ZEQIRI

Në mënyrë të vazhdueshme duhet kërkuar një transparencë më të madhe në regjistrimin e popullsisë që të fitohet numri real i shqiptarëve në Maqedoni. Çështja e regjistrimit të popullsisë nuk guxon të sakrifikohet dhe të justifikohet pas formulës së "drejtësisë ndërkombëtare" se ai do të vëzhgohet nga Këshilli i Evropës dhe EUROSTAT-i. Regjistrimi duhet të ndiqet institucionalisht nga ekspertë shqiptarë të vendit, me qëllim që të mos ngadhënjejë sërish ai fat i "verbër" dhe i "padrejtë" historik lidhur me numrin e shqiptarëve në Maqedoni

ABAZ ISLAMI

Regjistrimi fundit i cili dështoi në vitin 2012 ishte pikërisht për shkak se grafa për përkatësinë etnike ua prishi elaboratin VMRO-DPMNE-së e cila me vite e kishte përgatitur që me çdo kusht të zvogëlojnë përqindje e shqiptarëve nga regjistrimi i viti 2002 edhe pse kishte manipulime të shumta ne teren që të mos regjistrohen shqiptarët. ..Partitë shqiptare në pushtet dhe ato opozitare nuk duhet në asnjë mënyrë të lejojnë të realizohet një regjistrim i popullatës pa deklarim në bazë etnike dhe se jo vetëm që s'ka kuptim por që në start ende pa filluar regjistrimi do të dështojë

ORHAN MURTEZANI

Parimisht mendoj se informacioni për përkatësinë etnike i ndihmon funksionimit të shtetit, sepse tashmë edhe disa norma juridike në Kushtetutë dhe në ligje janë sanksionuar pikërisht përmes përqindjes së bashkësive etnike. Sidoqoftë, të presim konfirmimin zyrtar dhe pastaj do të kemi qëndrim përkatës

SISTEMI I DREJTËSISË NËN ETHET E REFORMAVE

LIDHJA ME POLITIKËN E KA RRËNUAR GJYQËSORIN

Ekspertët juridikë, profesorët universitarë dhe ish-gjykatësit vlerësojnë se institucioni më i politizuar në sistemin gjyqësor në Maqedoni është Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve. Ata vlerësojnë se mungon vizioni se në çfarë drejtimi duhet të reformohet gjyqësori

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 7 qershor - Mungesa e transparencës dhe uljes së besueshmërisë në punën e gjykatave në vendin tonë, sipas gjyqtarëve të Gjykatave të Apelit në Shkup, Shtip dhe Manastir, kryesisht lidhet me heshtjen e tyre, ndërkohë që gjykatësit e Gjykatës së Apelit në Gostivar, vlerësojnë se përmes mediave duhet të krijohet perceptimi pozitiv për gjyqësorin, për shkak se sipas tyre pjesa dërmuese e gjykatësve janë të ndershëm dhe profesionin e tyre e kryejnë në pajtim me dispozitat ligjore.

Ky konstatim i shumicës së gjykatësve të katër gjykatave rajonale në Maqedoni është përfshi në analizën juridike të ish gjykatëses së Gjykatës së Strasburgut, Mirjana Llazarova Trajkovska e cila në publikimin e fundit, thekson se përfshirja e gjykatësve ne reformimin e sistemit të drejtësisë në vendin tonë është e një dobie të posaçëm për rrjedhën e mëtutjeshme të reformave.

"Vetëm një pjesë e ekspertëve juridik të intervistuar janë të mendimit se reformat mirë po ecin dhe se grupet e punës mirë po funksionojnë. Qëndrimi i gjykatësve nga katër gjykata rajonale në Maqedoni është se reformat e shpeshta nuk duhet çdoherë t'ju dedikohen ligjeve, por se problemet thelbësore janë mungesën e integritet, paanshmërisë dhe transparencës. Njëkohësisht ekspertët juridik e thellojnë këtë konstatim dhe reformat i definojnë si ndryshimet pa reforma në fokus të reformave institucionale. Ata vlerësojnë se mungon vizioni se në çfarë drejtimi duhet të reformohet gjyqësori. Sipas tyre, reformat e deritanishme në masë të madhe janë të realizuar në ndryshimin e pikave dhe presjeve në ligjet ekzistuese", thotë gjykatësja Llazarova, në analizën e saj juridike.

Në rast se me reformat e nisura në sistemit e drejtësisë në vend synohet pavarësimi i gjyqësorit, atëherë sipas ish gjykatëses së Strasburgut, Mirjana Llazarova, gjykatësit duhet të jenë lirë qoftë nga ndikimet e jashtme, por edhe ato të brendshme. Kthimi i besimit dhe rritja e transparencës në gjyqësor, siç shprehet njohësja e zhvillimeve brenda sistemi gjyqësor në Maqedoni, Llazarova, duhet të bëhet përmes krijimit të kushteve që gjykatësi lirshëm ta japin mendimin e tyre.

Nga takimet dhe bisedat me fokus grupet e gjykatësve të Gjykatave të Apelit në Shkup, Shtip, Manastir dhe Gostivar është konstatuar se vetëm gjykatës me integritet dhe të përkushtuar ndaj profesionit të tyre mund ti bëjnë ballë çdo lloj presioni. Kësisoj gjykatësit e Gjykatës së Apelit në Shkup njëzëri janë shprehur se procedura për zgjedhje të gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave, avancimi në gjykatat më të larta është jo transparente, për shkak se para anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dorëzohet vetëm emrat dhe mbiemrat e kandidatëve, ku qartë mungon biografia e tyre.

"Përvoja e deritanishme e gjykatësve të potencuar, tregon se emërimi dhe avancimi i gjykatësve dhe prokurorëve nën ndikimin e partive politike dhe lidhjet e drejtpërdrejta të tyre me politikanët e ka rrënuar reputacionin dhe integritetin e gjyqësorit, respektivisht kjo ka ndikuar që dukshëm të ulet numri i vendimeve kualitative gjyqësore. Mungesën e transparencës dhe paparashikueshmërinë e atyre veprimeve posaçërisht e kanë hetuar gjykatësit e Gjykatës së Apelit në Shkup dhe Manastirt", thekson Llazarova.

Për kaosin dhe gjendjen aktuale në gjyqësor ekspertët juridike, në mesin e të cilëve profesor universitar dhe ish gjykatës, në këtë analizë kanë thënë se institucioni më i politizuar në sistemin gjyqësor në Maqedoni është Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve. Një pjesë tjetër e tyre ka ndarë mendimi se ky institucion duhet të specializohet, me çka do të ofroj program të mirëfilltë për specializim të gjykatësve dhe kështu të bëhet revidimi i zgjedhjes së ligjëruesve, gjegjësisht përfshirjen e kuadrove të dështmuar në praktikë dhe shkencë. Ndërkohë, grupi i tretë i ekspertë vlerëson se zgjedhja e gjykatësve të gjykatave themelore nga kjo Akademi është një model i gabuar dhe gjyqësori duhet të hapet për ofrimin e kushteve të njëjta për avokatët dhe bashkëpunëtorët profesional.

Listën e ekspertëve të cilët kanë marrë pjesë në përgatitjen e kësaj analizë e kryesojnë ish gjykatësit Margarita Caca Nikollovska dhe Dane Iliev, gjegjësisht profesorët Gordana Llazhetiq, Bekim Kadriu dhe asistenti Denis Preshova.

Me diplomë false punoi në DSK

Shkup, 7 qershor - Padi penale janë parashtruar kundër disa personave nga një institucion privat të arsimit sipëror në vend për ç'arsye i kanë mundësuar 33 vjeçarit M.B nga Kumanova të marrë diplomë në mënyrë të kundërligjshme, gjegjësisht pa i dhënë provimet. Padi penale është parashtruar edhe kundër tij, sepse ai, me diplomë të rreme është punësuar dhe avancuar në Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim. SPB Kumanovë parashtroi padi penale kundër M.B (33) nga Kumanova, drejtorit të përgjithshëm të Institutit Ndërkombëtar Sllav "Gavrillo Romanoviç Derzhavin" Shën Nikollë, B.S (36), rektorit të Institutit D.N (71) nga Probishtip, kundër Institutit si person juridik dhe kundër V.M.N (59), e punësuar në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit si këshilltar - inspektor shtetëror i arsimit. Kundër të gjithëve janë parashtruar padi penale për vepra të ndryshme në tërë procesin e marrjes ilegale të diplomës nga ana e kumanovarit M.B. Ai dyshohet se ka kryer një vepër penale "përdorim i dokumentit me përmbajtje të pavërtetë". Drejtori i përgjithshëm B.S dhe rektorit D.N dhe institucionit arsimor dyshohen për dy vepra të kryera penale "keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit" dhe "Falsifikim i dokumentit. Inspektorja e arsimit V.M.N dyshohet për vepër të kryer penale "punë e pandërgjegjshme në detyrë".

KRONIKË

Arrestohet i dënuari për drogë

Pjesëtarë të Policisë së Tetovës të mërkurën mbrëma rreth orës 22 e 45 minuta, në rrugën e "176" kanë arrestuar 26 vjeçarin N.K i dënuar me tre vite burg për vepër të kryer penale "prodhim i paligjshëm dhe lëshim në treg të lëndëve, narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve". Pas arrestimit dhe mbajtjes së shkurtër të realizuar me urdhër të gjykatës, personi N.K është dërguar në burgun e Tetovës për vuajtjen e dënimit.

Vjedhje në kishën e Tearcës

55-vjeçarja F.S nga fshati Tearcë ka denoncuar vjedhje në kishën "Shën Dimitrija" në Tearcë. Sipas policisë, pasi me forcë e kanë hapur derën hyrëse, hajnat nga brendia kanë marrë gjëra të shumta që kanë qenë në kishë, ndërsa dëmi i përgjithshëm është përllogaritur 20 mijë denarë. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të kësaj vjedhje.

Rrahet 35-vjeçari në vendin e punës

35-vjeçari R.K nga fshati Nerasht, të mërkurën ka denoncuar se rreth orës 13.00, përderisa ka qenë me veturë në rrugën Industriale në Tetovë, një person i panjohur, i cili me dy fëmijë të mitur ka qenë duke kaluar rrugën, ka filluar ta ofendojë dhe shajë kurse kanë intervenuar të tjerë që kanë penguar rrahjen fizike. Më pas, personi në fjalë, me pistoletë në dorë, ka ardhur në vendin ku ka punuar 35 vjeçari dhe ka shtënë me një plumb poshtë këmbëve të tij, dhe më pas me dorezën e pistoletës e ka goditur dhe së bashku me një shok tjetër, disa herë e kanë goditur në kokë dhe trup dhe janë larguar, ndërsa 35 vjeçari ka kërkuar ndihmë mjekësore.

Arrestohen për një metër dru

Pjesëtarët e policisë nga Sektori për Punë të Brendshme Tetovë, Stacioni policor i Gostivarit të mërkurën në rrugën në afërsi të rezervuarit të ujit në fshatin Forinë, kanë vërejtur dhe kanë ndaluar veturën e tipit "Opel Frontera", me targa të shteteve të jashtme, e drejtuar nga 27-vjeçari L.S. nga fshati Çegran, ku në të njëjtën veturë ka qenë edhe babai i tij H.S., 59-vjeç. Në veturë ata kanë transportuar një metër kub dru për ngrohje, për të cilat nuk kanë pasur asnjë dokumentacion. Policia me vërtetim ka konfiskuar veturën e ngarkuar si dhe një sharrë motorike, të cilat më pas janë dorëzuar në Policinë Pyjor. Dy personat nga fshati Çegran janë privuar nga liria, për zbardhjen e plotë të rastit.

Qen endacak kafshojnë 61-vjeçarin në Tetovë

Gjashtëdhjetë e një vjeçari A.B. nga fshati Kopanicë-Tetovë, dje rreh orës 08 e 30 minuta, derisa kanë lëvizur në bulevardin"Iliria" në Tetovë bashkë me një person tjetër nga fshati Radushë i moshës 41-vjeçare, ka qenë i sulmuar dhe i kafshuar nga një qen endacak. Qeni ka vrapuar në drejtim të tyre, menjëherë është sulur ndaj personit A.B., kështu që i ka shkaktuar lëndime në pjesën e nënbërrylit të majtë, ku menjëherë ka reaguar një kalimtar i rastit dhe e ka larguar qenin. Personi i lënduar ka kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin klinik të Tetovës.

(U.H)

GJYSMA E PAGËS HARXHOHET PËR USHQIM

FITOJMË 300, HARXHOJMË 600 EURO!

Të ardhurat mujore mesatare të një punësuari në Maqedoni prej afër 400 euro mezi mjaftojnë për mbulimin e shpenzimeve jetike si banimi apo ushqimi. Këtë e dëshmojnë edhe analizat e sindikalistëve, sipas të cilave, 13.394 denarë nevojiten në muaj që të mbulohen vetëm nevojat themelore për ushqim, ndërsa afër 10 mijë denarë kushtojnë harxhimet e banimit për një familje katër-anëtarëshe

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup, 7 qershor - Qytetarët në Maqedoni me mjaft vështirësi e kapërcejnë hendekun midis të ardhurave dhe harxhimeve mujore. Bile, të ardhurat mujore mesatare të një punësuari në Maqedoni prej afër 400 euro mezi mjaftojnë për mbulimin e shpenzimeve jetike si banimi apo ushqimi. Këtë e dëshmojnë edhe analizat e sindikalistëve, sipas të cilëve, 13.394 denarë nevojiten në muaj që të mbulohen vetëm nevojat themelore për ushqim, ndërsa afër 10 mijë denarë kushtojnë harxhimet e banimit, gjithmonë për një familje katër-anëtarëshe.

Kjo, me fjalë të tjera, nënkupton se më shumë se 60 për qind e pagës mesatare të vlefshme 23.694 denarë shkojnë për ushqim. Nëse kësaj i shtohen edhe harxhimet e banimit që përfshijnë koston e pagesës së rrymës, ujit apo telefonit, del se me një pagë mesatare, sipas përllogaritjes së Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë, mund të mbulohen vetëm harxhimet minimale të ushqimit dhe banimit. Pjesa e mbetur e harxhimeve mujore prej afër 10 mijë denarë, që përfshin 2291 denarë për higjienë, 2349 denarë për transport, 2121 denarë për veshmbathje, 1070 denarë për kulturë dhe 679 denarë për mirëmbajtjen e shëndetit, mbulohet nga të ardhurat e tjera jashtë rrogës mesatare.

Standardin e ulët e qytetarëve të Maqedonisë e dëshmojnë edhe analizat e institucioneve të ndryshme. Sipas analizës së institutit "Finance Think", dy të tretat e popullatës në Maqedoni me pagat mujore që i marrin nuk arrijnë të mbulojnë harxhimet e jetesës, ndërsa vetëm një e treta e popullatës arrin të kënaqë të gjithë nevojat ose të kursejë një pjesë të të ardhurave. Rreth 42 për qind arrijnë të kënaqin vetëm nevojat për ushqim dhe llogaritë, ndërsa 28.1 për qind nuk arrijnë të mbulojnë as këto harxhime.

Gjithashtu, një familje në mesatare në Maqedoni harxhon më shumë të holla se sa fiton dhe atë vetëm për mbijetesë. Hendeku jo i drejtë mes të ardhurave dhe shpenzimeve të jetesës tejkalohet përmes punës shtesë në të zezë, shkurtimit të mjaft harxhimeve, marrjes së kredive konsumatore, hyrjes në minus në kartelat kreditore, angazhimit në bujqësi, ndërsa vend të rëndësishëm zënë dërgesat e mërgimtarëve...

Sociologët thonë se në Maqedoni, vite me radhë ekziston një nivel i lartë i ekonomisë informale 30 deri 35 për qind, ku mjaft qytetarë punojnë në të zezë që të sigurojnë jetë normale. Ky aktivitet ekonomik që në mënyrë plotësuese e praktikojnë qytetarët, e mban standardin jetësor në njëfarë niveli. Mënyra tjetër që i ndihmon qytetarët të kapërcejnë muajin është edhe hyrja e madhe në borxh në bankat komerciale në tre vitet e fundit - saldo negative në llogaritë rrjedhëse, minuse në kartelat kreditore, si dhe kreditë konsumatore, banesore dhe të veturave.

Sipas të dhënave të Bankës Popullore të Maqedonisë, borxhi i amvisërive në muajin prill të këtij viti ka qenë 145.889 milionë denarë, ndërsa në muajin dhjetor të vitit 2016, borxhi i amvisërive ka qenë 120.832 milion denarë. Me fjalë të tjera, borxhet e qytetarëve për tre vite janë rritur për afër 400 milionë euro, apo prej 1 miliardë e 960 milionë euro në fund të vitit 2016, në 2 miliardë e 370 milionë euro në muajin e katërt të 2018-ës.

"Në muajin prill, totali i kredive është rritur në nivel mujor dhe vjetor për 0.6 dhe 5.8 për qind. Rritja kreditore në nivel mujor dhe vjetor, në pjesën më të madhe i detyrohet kreditimit të amvisërive me një rritje prej 82.7 dhe 78.1 për qind", tregojnë analizat e fundit të Bankës Popullore të Maqedonisë.

Në ndërkohë, hendekun midis të ardhurave të rregullta mujore dhe nevojave mujore të amvisërive mbulohen edhe nga ekonomia gri apo informale. Analizat e Institutit "Eurofund" për vitin 2013 tregojnë se në Maqedoni - në të zezë kanë punuar 140 mijë persona, ndërsa ekonomia e fshehur përbën 34.7 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, apo afër 2 miliardë euro.

Në vitet e fundit kemi një zbutje të ekonomisë informale si rrjedhojë e legalizimit të një pjese të bizneseve, megjithatë akoma një pjesë e konsiderueshme e ekonomisë vendore mbetet në zonën gri.

Mbi 15 milionë euro për bujqësinë dhe pylltarinë

Shkup, 7 qershor - Me 15 milionë euro nga Instrumenti për ndihmë parainkuadruese të BE - IPA 2019 do të financohet bujqësia në Maqedoni. Grupi i punës, siç kumtoi Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, i definon fushat prioritare që do të mbështeten financiarisht, ndërsa për herë të parë sivjet do të marrë edhe sektori i pylltarisë. Sipas MBPEU, për herë të parë mbështetje financiar nga IPA 2019 do të marrë sektori i pylltarisë në drejtim të vendosjes së së sistemit informues për pylltari që do të jetë komponentë e rëndësishme për ekonomizim të qëndrueshëm me pyjet, për krijimin e politikave për afrim të pylltarisë së Maqedonisë ndaj rrjedhave bashkëkohore dhe sigurim të të dhënave të rëndësishme për zhvillimin e këtij sektori. Do të vazhdojë mbështetja për investime në sisteme të vogla për ujitje me 3,5 milionë euro shtesë. Përmes IPA 2013 në vijim është përpunimi i tetë studimeve fizibilite nga të cilat tre do të financohen përmes IPA 2015 për të cilat janë siguruar tre milionë euro me të cilat deri në shtator do të përgatiten studimet fizilibite për sisteme të vogla për ujitje pas ç'farë do të fillojë procedura për ndërtim. Me IPA 2019 është paraparë financimi i procesit të konsolidimit të tokës bujqësore, për çfarë janë planifikuar rreth 500.000 euro. Do të vazhdojë edhe mbështetja financiare për koperativat bujqësore. Nga delegacioni i BE-së theksuan se angazhohen për financimin e projekteve në rajonet më pak të zhvilluara si rajoni jugperëndimor, verilindor dhe i Pollogut. *(Z.V)*

PRODHUESIT E TEKSTILIT ANKOHEN PËR PAGËN MINIMALE

Mbi 5000 persona do të mbesin pa punë

Shkup, 7 qershor - Mbi 5000 persona mund të mbesin pa punë për shkak të vendosjes së pagës minimale dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese që ta shfuqizojë vendimin e normuar, ndërsa disa kompani, nga të cilat një pjesë e investitorëve të huaj, tashmë largohen nga vendi, paralajmërojnë prodhuesit e tekstilit. Ata dje, në konferencën për media në Odën Ekonomike të Maqedonisë edhe një herë kërkuan që 50 përqindëshi i paraparë i kontributeve që duhet të paguhen veprimtaritë intensive të punës, të drejtohen nga punëtorët.

"Nuk na nevojitet përkrahje për pagën minimale, por për pagat më të larta, që t'i stimulojmë punëtorët dhe ta rrisim produktivitetin", theksoi kryetarja e Klasterit për tekstil, Marjana Perkovska. Sipas saj, Qeveria duhet t'i përshpejtojë reformat në ekonomi. Shumë kohë shpenzon në çështjen për emrin dhe në probleme të tjera politike. Prodhuesit e tekstilit u ankuan edhe se pas sjelljes së pagës minimale praktikisht janë shndërruar në ndërmarrje sociale. Janë sjellë në situatë që të marrin kredi që të sigurojnë paga.

"Rreth 80 për qind e të hyrave të përgjithshme të kompanive të tekstilit shkon për paga që është shumë. Paga minimale është e papërmbajtur në çfarëdo kuptimi, në aspekt të produktivitetit, përgatitjes teknike, konkurrencës", potencon Perkovska. Kryetari i Organizatës së punëdhënësve Angel Dimitrov, tha se prodhimtaria e rrobave në periudhën janar-shkurt të vitit 2018 është zvogëluar për katër për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa prodhimtaria e lëkurës për 6,3 për qind. "Vazhdon rënia e prodhimtarisë për shkak të zvogëlimit të numrit të punëtorëve", theksoi Dimitrov. Në industrinë e tekstilit punojnë 35.000 persona ose gjithsej 40.000 së bashku me industrinë e lëkurës. (Z.V)

NDRYSHIME NË LIGJIN PËR KUNDËRVAJTJE

ZBUTEN DËNIMET

Dënimet, sipas ligjit aktual për kundërvajtje, shkojnë edhe në disa dhjetëra mijë euro, kurse thelbi i zgjidhjes se re ligjore në radhë të parë është ulja e gjobave kundërvajtëse, por edhe rritja e efikasitetit në mbrojtjen juridike të qytetarëve

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 7 qershor - Deputetët e Kuvendit të Maqedonisë në muajin shtator duhet të votojnë plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit për Kundërvajtje. Paraprakisht deri në fund të muajit qershor pritet të kalojnë edhe filtrat qeveritar.

Me ndryshimet e ligjit, parashikohet që gjobat maksimale për personat fizik apo qytetarët të jenë 500 euro, ndërsa dënimet për personat juridik apo bizneset të kenë vlerën deri në 1000 euro në kundërvlerë të denarit.

"Qëllimi i zgjidhjes se re ligjore në radhë të parë është ulja e gjobave kundërvajtëse, pastaj ndarja e qartë e shkeljes administrative dhe shkeljeve ligjore, parandalimi në vend të represionit, apo shqiptimi i paralajmërimit para se të shqiptohet shkelje administrative kur një gjë e tillë është e mundshme, si dhe përmirësimi i efikasitetit të procedurës kundërvajtëse", thonë nga Ministria e Drejtësisë, e cila po merret me përgatitjen e ndryshimeve ligjore. Duke arsyetuar ndryshimet të Ligjit për kundërvajtje, Ministria e Drejtësisë mban qëndrimin se zgjidhja e mëparshme ligjore, nuk ka zvogëluar dënimet që mund ti shqiptojnë organet kundërvajtëse, bile dënimet edhe janë rritur në vende të caktuara.

Thelbi i këtyre ndryshimeve prek mbrojtjen juridike e qytetarëve, e cila duhet të jetë më efikase dhe eliminimi i praktikave të deritanishme të shqiptimit të dënimeve të mëdha.

Ekspertët juridik thonë se dënimet sipas ligjit aktual për kundërvajtje shkojnë edhe në disa dhjetëra mijë euro, ndërsa ato shpesh i shqiptojnë edhe organet e ndryshme administrative pa ndonjë vendim gjyqësor. Parashikohet edhe shkurtim i procedurës për ankesë , si dhe mundësia që parashtrimi i ankesës të ndalojë realizimin e dënimit.

Me Ligjin për kundërvajtje të vitit 2015, për herë të parë u vendosën dy shkallë në procedurën kundërvajtëse në kuadër të administratës shtetërore, me ç'rast u mundësua që organet e administratës të shqiptojnë dënime më shuma milionëshe dhe mbrojtje ligjore që nuk anulon realizimin e dënimit. Andaj edhe u imponua nevoja e zbutjes së këtyre dënimeve.

"Lartësia e dënimeve, dhe mbrojtja juridike e qytetarëve nga zgjidhjet eventuale joligjore për kundërvajtje të përcaktuara me Ligjin aktual për kundërvajtje, e vendosin në pikëpyetje zbatimin parimor të principeve të sundimit të së drejtës, sigurisë juridike dhe përpjesëtueshmërinë e tyre . Njëherësh për momentin ekziston një numër i rëndësishëm i kundërvajtjeve që janë nën kompetencën e një numri të madh të organeve jo-gjyqësore kundërvajtëse, si dhe një numër i madh i ligjeve, me të cilat përcaktohen kundërvajtjet dhe lartësia e dënimeve për kryerjen e tyre", arsyetohen ndër të tjerash nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji.

Në ndërkohë ndryshimi i politikës kundërvajtëse ishte edhe kërkesë e Odës Ekonomike të Maqedonisë e parashtruar së fundmi në muajin shkurt të këtij viti, konkretisht në aspektin e gjobave kundërvajtëse që iu shqiptohen afaristëve, ashtu edhe në aspektin e realizimit të procedurave të përshpejtuara për anulim. Afaristët kërkojnë zgjidhjen e problemit të procedurave për lëshimin e fletëpagesës së mandatit dhe fletëpagesës kundërvajtëse.

Sikundër dihet, Ligji aktual për kundërvajtje është miratuar në vitin 2015. Zgjidhjet e tanishme ligjore janë gati me dispozita identike, si të Ligjit për kundërvajtje, të miratuar në vitin 2006 me ndryshime të caktuara të rregullave që kanë të bëjnë me krijimin e normave dhe akteve juridike.

BPV RRITET PËR 0.1 PËR QIND!

Bruto Prodhimi Vendor në kuartalin e parë të vitit ka shënuar shkallë të rritjes prej 0.1 për qind, publikoi Enti Shtetëror për Statistikë. Në tremujorin e parë të vitit 2018, rritje më e madhe është vërejtur në sektoret e artit, argëtimit dhe rekreimit, veprimtaritë e tjera shërbyese, veprimtaritë e amvisërive si punëdhënës, veprimtari të amvisërive të cilat prodhojnë mallra të ndryshëm dhe kryejnë shërbime të ndryshme për nevoja personale prej 12.1 për qind, tregti me shumicë dhe pakicë, rregullimi i automjeteve motorike dhe motoçikletave; Transport dhe deponim, objekte për akomodim dhe veprimtari servisuese me ushqim prej 10.5 për qind dhe veprimtari teknike, profesionale dhe shkencore; Veprimtari shërbyese ndihmëse dhe administrative prej 8.5 për qind. Konsumi final i amvisërive, duke i përfshirë edhe institucionet joprofitabile të cilat u shërbejnë amvisërive, në tremujorin e parë të vitit 2018, në mënyrë nominale është rritur për katër për qind, ndërsa pjesëmarrja e tij në strukturën e bruto prodhimit vendor arrin 64.3 për qind.

AZESKI ME POROSI PËR QEVERINË E ZAEVIT

TË INVESTOHET NË KORRIDORIN 8

Kriva Pallankë, 7 qershor - Maqedonia ka shkëmbim serioz tregtar prej 1.2 miliardë dollarë dhe shkëmbim të mallrave prej 22.1 për qind me Turqinë, Shqipërinë dhe Bullgarinë, vendet të cilat i ndërlidh Korridori 8, ndërsa gjendja me korridorin është dëshpëruese, veçanërisht në pikën e vetme hyrëse të gazit, tha kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë, Branko Azeski, i cili së bashku me nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të Odës kanë realizuar vizitë pune në stacionin kryesor matës të gazsjellësit të "GA-MA" në pikën hyrëse afër fshatit Zhidillovë, në Kriva Pallankë.

Qëllimi i vizitës është theksimi i rëndësisë së procesit të gazifikimit për avancimin e punës së ekonomisë dhe për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe nevojën për avancimin e zhvillimit të barabartë rajonal. "Sot jemi këtu në terren që ta shohim gjendjen faktike, ndërsa ajo është se duhet të ketë linjë hekurudhore, por ende nuk ka, ka gaz të cilin nuk e shfrytëzojmë, rruga është ndërtuar para 50 viteve, ashtu është gjendja me korridoret e Maqedonisë dhe shpenzimet shtesë dhe kushtet ndikojnë në konkurrencën e prodhimeve tona", shtoi Azeski.

Gjatësia e Korridorit 8, e cila është me gjatësi të përgjithshme prej 950 kilometra, nëpër Maqedoni është 350 kilometra, ndërsa gjendja gjithkund është e njëjtë. Qeveria, tha, ka planifikuar këtë, ndërsa ne si Odë duhet vazhdimisht të insistojmë të ekzistojë në atë dhe më intensivisht të punohet. Sistemi për transmetimin e gazit natyror në Republikën e Maqedonisë është pjesë e gazsjellësit transit rus që kalon nëpër Ukrainë, Moldavi, Rumani dhe Bullgari. gazsjellësi magjistral ka hyrë në Maqedoni afër Deve Bairit në kufirin me Bullgarinë dhe përgjatë Kriva Pallankës, Kratovës dhe Kumanovës deri në Shkup, një gjatësi prej 98.197 kilometra.

MINISTRI FILIPÇE PARALAJMËRON NDRYSHIME TË REJA

LIGJ I RI PËR ABORTIN, DËSHIRA E GRUAS NË VEND TË PARË

Ministri i Shëndetësisë tha vendimi për ndërprerjen e shtatzënisë është e drejtë e gruas dhe se këtë nuk mund askush t'ia ndalojë

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 7 qershor - Në vijim është përgatitja e Ligjit të ri për ndërprerjen e shtatzënisë me të cilin gruas i jepet mundësia për zgjedhje të lirë për abort deri në javën e 12-të, në konsultim me gjinekologun familjar. Zgjedhje të lirë për ndërprerjen e shtatzënisë, gruaja do të ketë edhe deri në javën e 22-të të shtatzënisë, me vlerësimin e komisionit të përbërë nga dy gjinekologë dhe një punonjës social. Këtë dje e kumtoi ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, në simpoziumin profesional në temë "Anomali kongjenitale - sfida, dilema dhe trajtim" në organizim të Shoqatës së Mjekëve të Maqedonisë.

"Pas mbushjes së 22 javëve të shtatzënisë, do të formohet Komision i veçantë profesional i cili do të duhet të bëjë vlerësim për miratimin e ndërprerjes së shtatzënisë. Ai komision, përveç gjinekologëve dhe obstetërve, do të përbëhet edhe nga specialistë nga kirurgjia për fëmijë, kardiologjia për fëmijë, kardiokirurgjia, neurokirurgjia, anesteziologjia dhe punonjës socialë. Në rast të anomalisë kongjenitale tek fryti, gruaja ka të drejtë ta ndërpresë shtatzëninë në bazë të mendimit të këtyre specialistëve", tha Filipçe. Ai shtoi se vendimi për ndërprerjen e shtatzënisë është e drejtë e gruas dhe se këtë nuk mund askush t'ia ndalojë. Ministri i Shëndetësisë deklaroi se kanë bërë disa ndryshime në ligj në harmonizim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe në komunikim të vazhdueshëm me grupin e punës të përbërë nga gjinekologë dhe ekspertë të tjerë të cilët kanë rol profesional në procesin e abortit.

"Ajo që është e re, që nuk ka qenë në ligjin e deritanishëm, është që dëshirën e gruas e vendosim në vend të parë në këtë periudhë", tha Filipçe. Shtoi se draft versioni i ligjit është përgatitur dhe se është e nevojshme edhe një konsultim final me të gjithë të cilët janë të interesuar për ndryshim të ligjit, me personat profesionistë nga Klinika për gjinekologji dhe obstetrikë, MPPS dhe organizatave joqeveritare. Filipçe deklaroi se ka avancim të madh në lidhje me diagnostifikimin, prenatale dhe intrauterina, me metoda të ndryshme të cilat, siç tha, në mënyrë shtesë dëshirojmë t'i avancojmë me mundësimin e metodave të reja për diagnostifikim, por edhe në trajtimin e foshnjave të lindura para kohe dhe foshnjave të lindura me sukses të shkëlqyer, implementohen metoda të reja në shëndetësinë tonë publike. Ekspertë në specialitete të ndryshme, në simpozium do t'i promovojnë arritjet në mjekësinë tonë. Të dhënat tregojnë se për shkak të një anomalie kongjenitale në vit në botë vdesin rreth 300.000 foshnja në periudhën prej katër javësh pas lindjes.

REGJISTËR PËR SËMUNDJET MALINJE

Ministria e Shëndetësisë ka parashikuar dhe filloi të zbatojë masa për parandalim të sëmundjeve malinje në nivel vjetor, me përkrahje të Qendrës për hulumtim në suaza të KE-së. Në fund të verës pritet mision i ekspertëve, ndërsa tashmë kanë filluar edhe përgatitjet për sjelljen e regjistrit për sëmundjet malinje, për popullatën dhe në kushte spitalore. Këtë e deklaroi ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, duke i'u përgjigjur pyetjes së gazetarëve, pas hapjes së simpoziumit profesional me temën "Anomalitë - sfida, dilema dhe trajtim", në organizim të Shoqatës së mjekëve të Maqedonisë. Ai shfaqi shpresë se në vjeshtë do të kenë mjaft të dhëna që të ndërmarrin hapa konkrete. Në pyetjen e gazetarëve për reagimet e VMRO-DPMNE-së opozitare dhe nga ish bashkëpunëtorët e tij për centralizim të laboratorive, Filipçe tha se dokumentacioni i tenderit tërësisht është harmonizuar me Ligjin për furnizime publike, që është konfirmuar nga disa komisione, nga komisioni profesional në suaza të Ministrisë së Shëndetësisë dhe nga Komisioni për Furnizime Publike.

Vitin e kaluar më pak të vdekur

Shkup, 7 qershor - Numri i të vdekurve vitin e kaluar është zvogëluar për 0.5 për qind në raport me vitin e kaluar dhe është 20.318 të vdekur, tregojnë të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikës. Prej tyre numër më i madh janë nga gjinia mashkullore edhe atë 10.554 persona ose 51.9 për qind prej gjithsej numrit të të vdekurve. Numri i foshnjave të vdekura është 201, ndërsa pjesëmarrja e tyre në numrin e përgjithshëm të të vdekurve është 1.0 për qind nga personat e vdekur. Numri më i madh i rasteve - 2681, janë shënuar në janar. Mosha mesatare te të vdekurit e gjinisë mashkullore është 71.1 vjet, gjegjësisht 75.3 vjet te personat e gjinisë femërore ose për 4.2 vjet moshë mesatare me e lartë vërehet te gratë. Si edhe vitet e kaluara, pjesëmarrje më të lartë kanë personat e vdekur nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut 55.0 për qind raste nga gjithsej të vdekurit, e pastaj janë rastet te të cilat si shkak për vdekje paraqiten neoplazmat edhe atë 18.3 për qind, e pastaj me 4.8 për qind janë të prekura rastet te të cilat shkak për vdekje janë sëmundjet endokrine, nutritive dhe metabolike. Rastet te të cilat shkak për vdekje janë sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut janë të përfaqësuara me 4.2 për qind nga personat e vdekur.

TEMPERATURAT SIVJET MË TË LARTË PËR MBI TRE GRADË CELSIUS

Në pret një verë më e nxehtë se vjet

Shkup, 7 qershor - Na pret një verë më e nxehtë në të cilën temperaturat, sipas paralajmërimeve të sinoptikëve, do t'i tejkalojnë proceset shumëvjeçare në disa pjesë edhe për tre gradë. Veçanërisht devijime do të ketë gjatë qershorit. Sipas parashikimeve, priten edhe periudha me mot jashtëzakonisht të ngrohtë dhe të thatë. Reshjet gjatë verës do të jenë në kuadër të mesatares. "Në tërë rajonin juglindor të Evropës, temperaturat gjatë verës do të arrijnë vlera mbi mesataren. Në Republikën e Maqedonisë ekziston siguri e madhe për tejkalimin e temperaturave nga vlerat mesatare të vitit të kaluar që do të jetë më shumë se tre gradë në rajonin verilindor, ndërsa për pjesën tjetër të territorit deri në tre gradë. Devijim më i madh i temperaturës së ajrit pritet gjatë këtij muaji", tregojnë analizat e Drejtorisë për punë hidrometeorologjike. Meteorologët parashikojnë mundësi që në sezonin e ardhshëm veror të paraqiten periudha me mot jashtëzakonisht të ngrohtë dhe të thatë, si dhe siguri për devijime të theksuara negative nga vlerat e zakonshme mesatare të temperaturës, por edhe periudha me lagështi. Nga DPHM, megjithatë, përmendin se pamja sezonale e motit nuk mund të siguroj informacione të detajuara për kushtet intensive afatshkurte të motit. Mesatarja shumëvjeçare nga viti 1981-2010 e temperaturës në Shkup për muajin qershor, korrik dhe gusht arrin 21.9, 24.2 dhe 23.9 gradë Celsius. Vargu i temperaturës së mesatares shumëvjeçare 1981-2010 për verën në Maqedoni është prej 16 gradë në pjesët malore deri në 25.3 gradë të matura në Gjevgjeli. Temperatura e ajrit në korrik të vitit të kaluar në Maqedoni e tejkaloi mesataren për 1.5 gradë, ndërsa në gusht për një deri në dy gradë. Verën e kaluar në korrik janë regjistruar edhe më së shumti ditë tropikale edhe atë në Gjevgjeli, ndërsa net tropikale me mbi 20 gradë Celsius janë regjistruar në Gjevgjeli, Shkup, Demir Kapi, Shtip, Strumicë dhe Prilep. Temperatura më e lartë e matur vjet është 41 gradë në Demir Kapi më 4 gusht. Gushti i vitit të kaluar në dekadën e parë ka qenë më i ngrohtë për katër deri në gjashtë gradë. Reshjet gjatë kësaj vere do të jenë rreth vlerave mesatare ose më pak. Devijimi më i madh negativ i reshjeve për këtë sezon pritet të jetë në muajin gusht. Sasia mesatare shumëvjeçare e reshjeve për qershor, korrik dhe gusht arrin 44 mm, 37.6 mm dhe 34.4 milimetra. Reshjet në këtë periudhë janë në kufi prej 23.9 mm të matura në Shtip deri në 96.7 milimetra në Mavrovë. *(D.K)*

PËR NJË MUAJ, 1329 SHKELJE NË TRAFIK

BULEVARDET DHE RRUGËT REGJIONALE, MË TË PASIGURTA

Të gjitha kundërvajtjet janë realizuar me padi adekuate, fletëpagesë të detyrueshme, apo për kundërvajtje, në funksion të sanksionimit efikas, me qëllim që përfundimisht të bëhet ngritja e ndërgjegjes dhe kulturës së shoferëve në komunikacion, por edhe siguria e përgjithshme në rrugët dhe lagjet e këtij rajoni

Koha — Urim HASIPI

Tetovë, 7 qershor - Vendbanimet dhe rrugët kryesore të qytetit vazhdojnë të jenë në krye të listës së aksidenteve të trafikut në Tetovë dhe më rrethinë. Sipas raporteve policore, problematike janë bulevardet kryesore të qytetit ku regjistrohen shumë aksidente, jo me pasoja të rënda, por vetëm me dëme materiale. Por si çdoherë, nuk mungojnë aksidentet edhe nëpër rrugët regjionale, të cilët vazhdojnë të jenë të rrezikshme. Nga Policia e Tetovës thonë se numri më i madh i aksidenteve kanë ndodhur nëpër vendbanime gjithsej 54 dhe nëpër rrugët e Tetovës 38, kryesisht në bulevardet "Ilinden", "Iliria" dhe "Vidoje Smilevski Bato", pastaj rrugën rajonale Tetovë-Pirok 17, autostradën Gostivar-Tetovë-Shkup 14, dhe kështu me radhë. Si shkaku më i shpeshtë i aksidenteve në muajin e kaluar ka qenë shpejtësia e papërshtatshme 17 , kurse aksidentet janë shkaktuar edhe si pasojë e kryerjes së veprimit të parregullt 15. Si ditë më të rrezikshme në komunikacion, gjatë muajit të kaluar kanë qenë dita e martë dhe dita e enjte me nga 14 aksidente, ku pason e shtuna dhe e diela me nga 12 aksidente, deri sa periudhë më e shpeshtë aksidenteve është prej ora 10 deri ora 12 dhe prej ora 14 deri ora 16, thotë zëdhënësi i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë, Fatmir Rexhepi. Përndryshe , gjatë muajit të kaluar në këtë rajon gjithsej janë kontrolluar 4099 vetura ku janë zbuluar 1329 lloje të ndryshme të kundërvajtjeve. Kundërvajtjet e zbuluara, gjatë periudhës që bëhet fjalë janë sanksionuar me 664 fletëpagesa të detyrueshme, 479 fletpagesa për kundërvajtje, dhe me 168 paralajmërime me shkrim.

Me tej, sipas policia e Tetovës, në aksidentet e muajit maj nuk ka patur viktima, për dallim nga muaji maj i vitit. "Gjatë muajit maj të këtij viti, në rajonin më të gjerë të Tetovës, janë regjistruar gjithsej 77 aksidente trafiku, ose 10 aksidente më tepër krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Megjithatë, në këto aksidente nuk ka pasur viktima në njerëz, për dallim të muajit maj të vitit të kaluar ku pati një viktimë në aksident trafiku, edhe numri i të lënduarve rëndë është më i vogël se vitin e kaluar. Duke përmendur se lëndime të rënda trupore ka marrë vetëm një person, për dallim të vitit të kaluar, ku ka pasur gjashtë persona rëndë të lënduar, 26 persona kanë marrë lëndime të lehta trupore, kurse në 43 aksidente janë shkaktuar vetëm dëme materiale, e cila kumulativisht vlerësohet me mbi 43 milion e 600 mijë denarë", thotë zëdhënësi policor Fatmir Rexhepi. Në ndëkrohë, sipas raporteve të policisë në territorin e Tetovës, gjatë muajit të kaluar, janë evidentuar gjithsej 1329 kundërvajtje në trafik. Numri më i madh i tyre është tejkalimi i shpejtësisë së lejuar, në vendbanime dhe jashtë vendbanimeve si dhe më pas janë edhe kundërvajtjet tjera. Në muajin maj, janë zbuluar 62 vetura pa regjistrim ose me regjistrim të skaduar,nëntë vetura me parregullsi teknike, derisa 44 shoferë kanë drejtuar veturën në gjendje të alkoolizuar,.Për këto kundërvajtje parashihet gjobë ligjore me vlerë prej 100 deri 500 euro në kundërvlerë të denarit. Në këtë periudhë, gjithashtu janë regjistruar edhe 125 të ashtuquajtur ,"vozitës të egër", individ të cilët nuk kanë poseduar leje valide për vozitje, si dhe 100 vozitës fillestarë, të nuk u janë përmbajtur përkufizimeve të parapara me ligj. Dy persona kanë vozitur gjatë masës së ndalesës dhe si dhe dy vozitës kanë drejtuar me kategori të papërshtatshme për drejtim të automjetit, kundërvajtje që jo rrallë konstatohen në rajonin e Tetovës. Të gjitha kundërvajtjet janë realizuar me padi adekuate, fletëpagesë të detyrueshme, apo për kundërvajtje, në funksion të sanksionimit efikas, me qëllim që përfundimisht të bëhet ngritja e ndërgjegjes dhe kulturës së shoferëve në komunikacion, por edhe siguria e përgjithshme në rrugët dhe lagjet e këtij rajoni.

Sot përfundon viti shkollor

Shkup, 7 qershor - Për rreth 270.000 nxënës të shkollave të mesme dhe fillore, prej të cilëve 20.000 filloristë, sot është dita e fundit shkollore dhe fillimi i pushimit të verës. Semimaturantët këtë muaj do të regjistrohen në vitin e parë në shkolla të mesme për vitin shkollor 2018/2019. Më 18 dhe 19 qershor është paraqitja e parë në shkollat e mesme publike, ndërsa paraqitja e dytë në afatin e korrikut është më 28 qershor. Në afatin e gushtit paraqitja është më 23 gusht. Maturantët, ndërkaq, pasnesër (9 qershor) do ta kenë testin për gjuhën amtare (maqedonisht, shqip, turqisht) dhe literaturë, që është një ndër tre provimet eksterne dhe të obligueshme në maturën shtetërore. Provimi i parë ekstern (gjuhë të huaj - anglisht, frëngjisht, rusisht apo gjermanisht) e japin të shtunën. Më 11 qershor është testimi për lëndën e tretë eksterne (kimi, fizikë, biologji, histori, filozofi, estetikë apo biznes), ndërsa më 13 qershor do ta japin provimin kandidatët të cilët janë paraqitur për provim për matematikë. Sipas Qendrës Shtetërore të Provim, ky vit shkollor për dhënin e maturës shtetërore janë paraqitur gjithsej 15 256 kandidatë. Ky është kushti për regjistrim në fakultete. Nxënësit të cilët e vazhdojnë arsimin e mesëm dhe fillor, në mësim sërish do të kthehen më 3 shtator të vitit 2018 (e hënë), për fillimin e vitit shkollor 2018/2019.

KRONIKË

24-vjeçari vdes duke luajtur futboll

Një djalosh 24 vjeçar ka vdekur dje në lagjen e Shkupit "11 Tetori", pasi i është përkeqësuar gjendja duke luajtur futboll. Policia kumtoi se të mërkurën mbrëmë rreth orës 19:30 në Sektorin e Punëve të Brendshme Shkup pati paraqitje se në sallën sportive në lagjen "11 Tetori", derisa D.K.(24) nga Shkupi ka qenë duke luajtur futboll, gjendja shëndetësore i është përkeqësuar, pas çka ra në tokë dhe ka vdekur. Nga ana e mjekut të Ndihmës së shpejtë u konstatua vdekja. Me leje të prokurorit publik, trupi i të vdekurit i është dorëzuar familjes për varrim.

Vetura godet 11-vjeçarin

Shkup, 7 qershor - Një fëmijë i moshës njëmbëdhjetëvjeçare është lënduar rëndë, pasi ishte goditur nga një automobil në Shkup. Në Sektorin për Punë të Brendshme Shkup dje rreth orës 13:30 u denoncua se në rrugën "Brigada e Dytë e Maqedonase" një veturë e tipit "BMV" me targa të Shkupit, i drejtuar nga A.H. (57) nga Shkupi e kishte goditur fëmijën. Në fatkeqësinë fëmija u lëndua rëndë, gjë që u konstatua nga ana e mjekut nga Kirurgjia e fëmijëve pranë Kompleksit të klinikave "Nëna Terezë". Ishte kryer inspektim në vendin e ngjarjes dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Shkup, 13 aksidente me një të lënduar rëndë

Një person është lënduar rëndë, ndërsa shtatë janë lënduar lehtë në tetë nga gjithsej 13 aksidente që kanë ndodhur gjatë 24 orëve të fundit në rajonin e Qytetit të Shkupit. Në pesë është regjistruar vetëm dëm material. Sipas raportit policor të SPB Shkup, 84 shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, 29 shoferë janë përjashtuar nga komunikacioni nga të cilët tre për shkak të drejtimit të automjetit nën ndikimin e alkoolit, 14 pa e marrë të drejtën e drejtimit të automjetit motorik, tre shoferë fillestarë... Nga komunikacioni policia ka përjashtuar 21 automjete edhe atë 10 skadim të afatit të patentë shoferit, një për shkak të parregullsive teknike dhe 10 sepse ishin të paregjistruara. Në mënyrë të parregullt janë parkuar 98 automjete, ndërsa karrotreci ka marrë 73 automjete. *(O.Xh)*

Plaku, glasa dhe nazistët

Nga
Enver ROBELLI

Alexander Gauland është 77-vjeçar dhe në këtë moshë ndoshta njeriu nuk e sheh botën aq qartë. Por, kjo nuk vlen për Gaulandin. Ai duket se qëndron mirë me shëndet, madje edhe me shëndetin mendor. Në Parlamentin gjerman Gauland është shef i Grupit parlamentar të Alternativës për Gjermani (Alternative für Deutschland, AfD), e cila është partia më e madhe opozitare. Kur u themelua AfD-ja fillimisht kundërshtoi Bashkimin Evropian dhe politikat e tij monetare. Kritika, pak a shumë, tingëllonte kështu: të tjerët, sidomos italianët, spanjollët e portugezët, janë dembelë, ndërsa gjermanët e zellshëm duhet të paguajnë dhe t'i shpëtojnë ata nga falimentimi. Pastaj AfD-ja u shndërrua në parti kundër refugjatëve, veçanërisht pas vjeshtës së vitit 2015, kur kancelarja Angela Merkel vendosi të pranojë rreth një milion refugjatë, shumica sirianë. Ndërkohë AfD-ja, përveç retorikës pothuaj raciste ndaj të huajve, ka nisur të minimizojë edhe krimet naziste.

Të dielën Gauland mbajti një fjalim para forumit të të rinjve të partisë, me ç'rast ai tha: "Hitleri dhe nazistët janë vetëm një glasë në historinë e suksesshme gjermane mbi 1.000-vjeçare". Edhe kësaj radhe Gauland bartte mbi këmishën e tij një kravatë të gjelbër me disa qenë të qëndisur me ngjyrë të artë. Këtë kravatë ai a bart shpesh, ndoshta për të ilustruar gjuhën e tij të ashpër që nganjëherë tingëllon si lehje e rrezikshme. Bash si të dielën.

Duke thënë se krimet naziste janë vetëm një glasë në krahasim me historinë e lavdishme gjermane, Gauland u përpoq të minimizojë krimet naziste. Hap pas hapi, provokim pas provokimi krerët e AfD-së po kalojnë të gjitha vijat e kuqe dhe po etablojnë në politikën gjermane një gjuhë që në këso përmasash ka qenë e panjohur në parlamentarizmin dhe politikën gjermane pas Luftës së Dytë Botërore. Holokausti dhe agresioni gjerman ndaj vendeve si Polonia, miliona viktima të çmendurisë racore dhe megalomane gjermane, zhdukja industriale e hebrenjve – vetëm "një glasë", sipas Gaulandit? 50 milionë viktima, një shkatërrim i paparë i Evropës – sall një glasë? Gauland dhe shokët e tij jetojnë nga provokimet. Dhe kur njeriu me kravatë me qenë bërtet, fyen viktimat dhe minimizon krimet, atëherë atij dëshirojnë t'ia kalojnë edhe zagarët e vegjël politikë. Njëri nga ta pas fjalimit të Gaulandit tha se "Bashkimi Evropian duhet të vdesë, në mënyrë që

Evropa të jetojë". Tronditja në Gjermani pas deklaratës së Gaulandit është e madhe. Ish-kryetari i Partisë Socialdemokrate (SPD) Martin Schulz shkroi në Twitter: "Kush i minimizon krimet e nazistëve, ai ua shtron udhën nazistëve të rinj. Gaulandi është turp për Parlamentin gjerman. SPD-ja është digë kundër kësaj mendësie". A është vërtet SPD-ja digë? Sipas anketave, partia dikur krenare socialdemokrate ka rënë nën 20 për qind dhe gjendet vetëm pak para AfD-së. Me vite të tëra SPD-ja ka injoruar shqetësimet e klasës punëtore dhe shtresave të paprivilegjuara, duke përkrahur politikat neoliberale në koalicion me konservatorët e CDU-së së Angela Merkelit.

Pas zgjedhjeve të fundit, në të cilat pësoi rënie dramatike, SPD-ja fillimisht tha se do të kalonte në opozitë për të marrë veten. Pasi dështuan negociatat mes konservatorëve të Merkelit, liberalëve dhe të gjelbërve, SPD-ja shkeli premtimin dhe hyri sërish në koalicion me CDU-në. Kështu në Parlament partia më e madhe opozitare mbeti Alternativa për Gjermaninë, një bandë politike e provokatorëve. Politikanë të saj i quajnë të gjithë të huajt "njerëz me thika", ndërsa kundërshtojnë kulturën gjermane të kujtimit të krimeve, duke e quajtur përmendoren në kujtim të krimeve mbi hebrenj në Berlin si "përmendore të turpit".

Politika gjermane ende nuk ka gjetur një recetë efikase për të luftuar AfD-në. Reagimi pas çdo provokimi të politikanëve të AfD-së po tregohet joefikas. Kjo vetëm sa po i siguron prani

Politikani i së djathtës ekstreme gjermane, Alexander Gauland, është përpjekur të minimizojë krimet naziste në një fjalim para përkrahësve të rinj të partisë Alternativa për Gjermaninë

edhe më të madhe mediale AfD-së. Me të njëjtin problem po ballafaqohen edhe shumica e mediave. AfD-ja kritikon dhe provokon, mediat kundërgodasin me komente të ashpra, shpesh edhe me leksione moraliste. Efekti deri më tani nuk po shihet. Nëse në dy-tre vjetët e ardhshëm partitë deri më tani popullore, si CDU-ja dhe SPD-ja nuk e marrin veten dhe nëse njëra prej tyre nuk kalon në opozitë dhe, po ashtu, nëse Merkel nuk e prezanton një pasardhëse apo pasardhës në post, AfD-ja mund të forcohet edhe më shumë. Trendi në Evropë po çon ujë në mullirin e nacionalistëve, të cilët po marrin përkrahje edhe nga regjimi i Vladimir Putinit.

Jo rastësisht AfD-ja kërkon heqjen e sanksioneve të BE-së kundër Rusisë dhe deputetë të AfD-së vizitojnë Damaskun me ftesë të regjimit diktatorial të Bashar al-Asadit. Forcimi i AfD-së mund të ketë pasoja edhe për zgjerimin e BE-së. Në të vërtetë, disponimi për pranimin e shteteve të reja anëtare nga Ballkani ka rënë dukshëm. Presidenti i ri i Francës është kundër, Berlini e ka shpikur "Procesin e Berlinit" që është një lloj korridori i ri për t'i mbajtur vendet e Ballkanit me shpresën se do të anëtarësohen një ditë, por askush nuk e di se kur vjen ajo ditë.

(koha.net)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
E përditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 7 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Pyetje për Merkelin

Nga
Jens THURAU

Dikur, para ca kohe, në një nga mbledhjet e grupit parlamentar unionist Angela Merkel thuhet se e shprehu dakordimin e saj. "Nëse duhet patjetër, atëherë le ta bëjmë". Shumë parlamentarë të të gjitha grupeve parlamentare kishte kohë që kishin kërkuar që t'i zëvendësonin pyetjet e thata ndaj qeverisë prej përfaqësuesve të popullit, gjithmonë të mërkurave në çdo javë seancash parlamentare, me një spektakël të vërtetë me kryetaren e pranishme të qeverisë. Të paktën tri herë në vit. Sepse deri tani, me vite të tëra, përgjigjje për pyetjet e komplikuara kanë dhënë sekretarët e shtetit nga ministritë.

Por në vizitat në botën e jashtme, si për shembull në Britaninë e Madhe dhe në Spanjë deputetët e Bundestagut patën përjetuar sa të gjalla mund të jenë orët e pyetjeve me kryetarët e qeverisë. Dhe tani, pas premierës në Gjermani mund të thuash: ata kishin të drejtë, ia vlejti.

Ia vlejti edhe për Angela Merkelin. Pse druhej kancelarja nga kjo marrje në pyetje? E sigurtë në fakte dhe pa iu dredhur qerpiku iu përgjigj

ajo pyetjeve për raportin me Rusinë, për Donald Trumpin, për Kinën, për skandalin me Zyrën Federale për Refugjatët. Dhe natyrisht, kjo është bërë tashmë e zakonshme në Bundestag, populistët e djathtë të Alternativës për Gjermaninë shkumëzuan dhe provokuan pa fund. Merkeli ka shkaktuar një përmbytje me migrantë, ka asgjësuar miliarda, kur ka ndër mend të japë dorëheqjen?

Bën pjesë pa dyshim në virtytet e mëdha të kancelares që e humbet rrallë kontrollin, kjo u konfirmua edhe këtë herë. Në vend të kësaj, ajo e shfrytëzoi rastin për të shprehur falenderime për mijëra punonjësit e Zyrës Federale të Migrimit. Kështu veprohet, kur do ta lësh që të vejë huq kundërshtari politik. Dhe: kancelarja e shfrytëzoi orën e pyetjeve për disa pozicionime shumë të qarta. A nuk do ta përfshijë ajo Rusinë sërish në grupin e shteteve të mëdha të industrializuara, pra që grupin G7 ta bëjë sërish G8? Në asnjë mënyrë, sepse "aneksimi i Krimesë ishte një shkelje flagrante e së drejtës ndërkombëtare". Prandaj përjashtimi i Rusisë është i drejtë,

> **Kancelarja iu përgjigj për herë të parë pyetjeve të deputetëve të Bundestagut. Dhe u përgjigj tepër e qetë, duke nxjerrë në pah përvojën, e sigurtë në fakte. Pse e kishte kundërshtuar ajo më parë këtë?**

tha kancelarja. Pikë.

Mirë për Merkelin ishte edhe që partneri i saj i koalicionit, socialdemokratët i rezistoi tundimit që tensionet e krijuara në aleancën qeveritare t'i shkarkonin në seancën e pyetjeve për Merkelin. Socialdemokratët bënë pyetje të sjellshme specifike, këtu mund të ishin treguar edhe më të ashpër, për shembull duke bërë pyetjen se sa bashkëpërgjegjësi mban Merkeli për kushtet e këqia në Zyrën Federale për Migrimin, bashkëpërgjegjëse ajo me siguri që është. Por kjo pyetje nuk u dëgjua.

Si përfundim: Po të ketë pasur ndonjëherë frikë nga kjo marrje në pyetje Merkeli, nga "pjekja në skarë" siç shkruan disa gazeta, atëherë mund të thuash se frika ka qenë pa bazë. Po të vazhdojë gjithmonë kështu, Merkeli me siguri që do të shkojë me dëshirë për ta pyetur. Dhe fare në fund ajo i la të pranishmit të shijonin pak humorin e saj të qetë, të cilin përndryshe e njohin vetëm njerëz shumë pranë me të: "Sado keq që të vjen, ja që e gjitha mbaroi. Po do të vij prapë", iu drejtua ajo sallës. Epo atëherë... *(DW)*

Shqipëria, drogat dhe përgjimet

Nga
Riccardo CELEGHINI

Ngjarjet, ku përfshiheshin dy figura kyçe të Partisë Socialiste (PS), nxitën sulmin e opozitës, të udhëhequr nga Partia Demokratike (PD), e cila doli në rrugë për të kërkuar dorëheqjen e Kryeministrit Edi Rama. Dinamikat gjyqësore, politike dhe mediatike rreth të dy rasteve nuk janë shumë të qarta, por ajo që është e sigurt është se rikrijimi i një ndërhyrjeje të rrezikshme mes politikës dhe krimit, si dhe një klimë tensionesh midis forcave politike, hedh një hije mbi vendin në javët vendimtare për të marrë dritën e gjelbër për hapjen e negociatave të pranimit me Bashkimin Evropian.

Dy skandale në lidhje me trafikimin e drogës kanë goditur nivelet më të larta të politikës shqiptare. Ashtu si ish-ministri i Brendshëm përfundon nën arrest shtëpiak, pasardhësi i tij është në sy të stuhisë për një rast gjyqësor që përfshin vëllain e tij

Në javët e fundit, ministri aktual i brendshëm, Fatmir Xhafaj, arkitekt i reformave të mëdha të drejtësisë, përfundoi në qendër të një skandali. Në fillim të majit, Partia Demokratike ka bërë publik një vendim të një gjykate italiane, të vitit 2002, kur vëllai i ministrit u dënua me shtatë vjet burg për "bashkëpunim kriminal me qëllim trafikimin e drogës", një vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë e Kasacionit në vitin 2012. Një ditë më vonë, po PD-ja lëshoi përgjime të tjera, nga e cila dukej se vëllai i ministrit, ka qëndruar në Shqipëri për t'i shpëtuar dënimit në Itali, ai ende vazhdonte të ishte i angazhuar në trafiqet e paligjshme dhe marrëdhëniet kriminale. Opozita gjithashtu akuzon ministrin se ka mbrojtur vëllain e tij, duke modifikuar një ligj ekstradimi të për të lehtësuar qëndrimin e tij në Shqipëri. Akuzat janë përgënjeshtruar nga ana e Ministrit të Brendshëm dhe Partisë Socialiste: sipas kryeministrit Rama, kjo është një vepër e falsifikuar e ndërtuar për të dëmtuar qeverinë dhe imazhin e jashtëm të Shqipërisë. Megjithatë, fushata e ndërmarrë nga opozita është shumë vendimtare.

Më 24 maj, kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka zënë podiumin e parlamentit për të nisur sharjet e tij, para se të gjithë deputetët e opozitës të largoheshin nga salla e kuvendit, duke refuzuar votimin e një mocioni e cila mbështeste aderimin evropian të vendit. Disa ditë më vonë ajo u pasua nga një demonstratë e cila kërkonte dorëheqjen e Xhafaj dhe Ramës. Ajo është në fakt vazhdimi i strategjisë së "murit kundër murit" të kryer nga PD-ja vitet e fundit, nën drejtimin e liderit të vjetër të partisë, Kryeministrit dhe Presidentit të Shqipërisë, për pjesën më të madhe të viteve '90 dhe në vitin 2000, Sali Berisha. Çështja është veçanërisht e nxehtë dhe pritet të ketë të reja. Janë jo pak analistë që flasin për një fushatë të hartuar për të hedhur në erë karrigen e ministrit, autor i reformave të guximshme. Dyshimet vijnë edhe për kohën e fushatës opozitës: pse tani janë vënë në lëvizje audiot dhe dokumentet në lidhje me ngjarjet e shumë viteve më parë? *(zëri.info)*

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

Kapërcimi i mëngjesit shkakton probleme të pakëndshme

Është e njohur se mëngjesi është shujta më e rëndësishme në ditë, pasi stimulon metabolizmin dhe siguron energjinë e nevojshme për trupin. Shumë prej njerëzve ende nuk hanë mëngjes për arsye të ndryshme, por mund të ndryshojnë kur të gjejnë se mund të kenë një frymë të keqe për shkak të kësaj. Kapërcimi i mëngjesit lë bakteret që ne përndryshe do t'i kishim larguar me rastin e ngrënies. "Nëse nuk hani mëngjes, ju keni një nga zakonet më të këqija që shkakton frymëmarrje të keqe, sepse zgavra e gojës mbetet e thatë dhe e mbushur me baktere", tha Mervin Druian nga Qendra e Londrës për Stomatologji Estetike. Më shumë baktere mund të ndodhin nëse zgjedh drithërat me bazë sheqeri për mëngjes. Në vend të kësaj, Druian këshillon të konsumohen fruta dhe ujë, pasi në këtë mënyrë do të largoni më efektivisht bakteret nga goja juaj.

PERSONAT ME BEL MË TË GJERË KANË NIVEL TË ULËT TË VITAMINËS D

Njerëzit e trashë të cilëve u mblidhen depozita dhjamore rreth belit, kanë mangësi të vitaminës D, u konstatua kështu në një studim të kryer nga Universiteti i Amsterdamit. Yndyra në mëlçi gjithashtu lidhet me një nivel të reduktuar të ekspozimit ndaj dritës së diellit tek meshkujt me mbipeshë, por jo edhe tek femrat, transmeton Koha.net. Nuk është e qartë nëse mungesa e vitaminës D kontribuon në akumulimin e yndyrës së barkut apo obesiteti e redukton nivelin e vitaminës.

Hulumtimi i mëhershëm ka sugjeruar se ulja e nivelit të vitaminës D çon në artrit, astmë, dhe diabet të tipit 1, sepse e ka rolin e forcimit të imunitetit dhe parandalimit të inflamacionit.

"Personat të cilët kanë bel më të gjerë do të duhej ta kontrollojnë nivelin e vitaminës D, por ende nuk e kemi gjetur shkakun e drejtpërdrejtë ose lidhjen midis nivelit të vitaminës D dhe obesitetit. Sido që të jetë, lidhja tregon për rolin potencial të vitaminës D në grumbullimin e yndyrës abdominale", tha dr. Rachida Rafiq, udhëheqëse e studimit.

> Studiuesit e analizuan yndyrën abdominale dhe yndyrën në pjesë të tjera të trupit të njerëzve prej moshës 45-65 vjeç, të cilët kishin marrë pjesë në studimet e mëparshme. Gjithashtu, atyre u është matur niveli i vitaminës D

Studiuesit e analizuan yndyrën abdominale dhe yndyrën në pjesë të tjera të trupit të njerëzve prej moshës 45-65 vjeç, të cilët kishin marrë pjesë në studimet e mëparshme. Gjithashtu, atyre u është matur niveli i vitaminës D.

Më parë u theksua rëndësia e kësaj vitamine e cila, sipas shkencëtarëve, ndihmon në "riparimin" dhe parandalimin e dëmtimit të zemrës, e stimulon prodhimin e acidit nitrik, i cili e rregullon qarkullimin e gjakut dhe e parandalon mpiksjen e gjakut. Gjetjet u prezantuan në Shoqatën evropiane të endokrinologëve në konferencën vjetore në Barcelonë.

Sulmet në zemër më vdekjeprurëse gjatë dimrit thotë studimi i fundit

Sulmet në zemër janë më vdekjeprurëse gjatë muajve të ftohtë, thotë hulumtimi i fundit. Nëse keni një atak në zemër midis nëntorit dhe prillit, mund të keni gati 50 për qind më shumë gjasa të vdisni se sa dikush që ka një të tillë në verë. Kardiologët në një spital në Leeds shikuan të dhënat e më shumë se 4.000 pacientëve me sulm në zemër gjatë katër viteve për të gjetur statistikat përkatëse. Ata gjetën se numri i sulmeve të zemrës mbetet i qëndrueshëm gjatë gjithë vitit, por rreziku i vdekjes brenda një muaji është rreth 50 për qind më i lartë gjatë dimrit. Nuk ka asnjë arsye të qartë për ndryshimin, thanë ata, por vonesat në spital dhe një numër në rritje i infeksioneve ndoshta fatale mund të jetë për t'u fajësuar. Në Mbretërinë e Bashkuar dikush është hospitalizuar nga një atak në zemër çdo tre minuta - Fondacioni britanik Heart thotë se ka një nevojë urgjente për kërkime në reduktimin e numrit të sulmeve në zemër. Ndërsa në Kosovë, ende nuk ka ndonjë raport të lëshuar hulumtues sa i përket pacientëve me sulme në zemër.

Larg kamomilit nëse vuani nga...

A është konsumimi i kamomilit i sigurt? Sipas shumë ekspertëve të shëndetit, konsumimi i kamomilit është i sigurt dhe nuk sjell rreziqe për shëndetin, mirëpo nëse e përdorni në doza të lart mund të shkaktojë dridhje dhe të vjella. Ka potencialin që të nxisë edhe reaksionet alergjike tek personat që janë alergjikë ndaj bimëve të familjes së margaritës, edhe përse këto reaksione janë shumë të rralla. Shmangeni nëse jeni alergjikë ndaj këtyre bimëve: kamomili, kumaku, krizantema, margarita. Kremrat e lëkurës me kamomil mund të shkaktojnë ekzemë alergjike dhe irritojnë sytë. Efektet e përdorimit të gjatë të kamomilit nuk dihen.

RREZIQET: Flisni me mjekun para se të përdorni kamomil nëse keni një problem shëndetësor. Kamomili përmban një sasi të vogël të kuomarinës, që mund të ketë efekte shumë të lehta të hollimit të gjakut, por zakonisht vetëm në doza të larta për periudha të gjata kohe. Mos përdorni kamomil 2 javë para një operacioni të planifikuar, pasi mund të kundërveprojë me ilaçet për anestezi, transmeton shendeti.com.

KUNDËRVEPRIMET: Nëse merrni ilaçe rregullisht, flisni me mjekun para se të përdorini suplemente të kamomilit. Ato mund të kundërveprojnë me sedativët, holluesit e gjakut, ilaçet antiplatelet, aspirina, ilaçet për lehtësimin e dhimbjeve, si iburpofeni dhe naprokseni etj. Kamomili mund të kundërveprojë gjithashtu me suplemente si ginkgo biloba, hudhra, sanëza etj.Duke qenë se nuk ka shumë informacione rreth sigurisë së përdorimit të kamomilit për periudha të gjaku, nuk rekomandohet për gratë shtatzëna dhe ato që ushqejnë fëmijët me gji. Flisni me pediatrin para se t'ju jepni kamomil të vegjëlve tuaj.

Përfitimi i fshehtë i një gjumi të rehatshëm!

Ka shumë gjëra që arsyetojnë një ngopje me gjumë të mirë gjatë një natë. Por sipas studimit të fundit, gjumi i rehatshëm për të paktën tetë orë, mund të ndihmojë në përmirësimin e kujtesës, frenimin e inflamacionit dhe përforcimin e vëmendjes tuaj. Por ka edhe një përfitim tjetër të fshehtë thotë hulumtimi i fundit- ata që marrin më shumë gjumë çdo natë kanë seks më të mirë dhe më shumë orgazmë! Terapisti dhe autorja e librave të seksit, Dr Laurie Mintz, ka gjetur në hulumtimin e saj se më shumë sy mbyllur mund të çojë në një rritje më të madhe të dëshirës seksuale dhe të nxisë hormonet seksuale si testosteroni. Ajo tha se edhe seksi edhe orgazma janë aq të lidhura ngushtë dhe se jo vetëm gjumi i mirë mund të çojë në seks më të mirë, por seksi i mirë mund të çojë edhe në gjumë më të mirë.

Në bazë të nenit 28 paragrafi 1 e Ligjit për koncesione dhe të partneritetit publik dhe privat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 6/12, 144/14, 33/15, 104/15 dhe 215/15), nenit 41 paragrafi 1 të Ligjit për Lëndët e para të mineraleve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/12, 25/13, 93/13, 44/14, 160/14, 129/15, 192/15, 39/16, 53/16, 120/16 dhe 189/16) dhe Vendimit për fillim të procedurës për ndarje të koncesioneve për eksploatim të lëndëve të para minerale nr. 44-4187/1 të datës 19.12.2017 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 189/2017), Komisioni për zbatim të procedurës për ndarje të koncesioneve për eksploatim të lëndëve të para minerale – mermer në lokalitetin "Debrishtë", Komuna Rosoman publikon

THIRRJE PUBLIKE

PËR NDARJE TË KONCESIONEVE PËR EKSPLOATIM TË LËNDËVE TË PARA MINERALE – MERMER NË LOKALITETIN "DEBRISHTË" KOMUNA ROSOMAN

4/2018

1. Koncedent është Republika e Maqedonisë - Qeveria e Republikës së Maqedonisë.
2. Lëndë e kësaj thirrje publike është ndarje të koncesioneve për eksploatim të lëndëve të para minerale mermer në lokalitetin "Debrishtë", Komuna Rosoman nga Vendimi për fillim të procedurës për ndarje të koncesioneve për eksploatim të lëndëve të para minerale nr. 44-4187/1 të datës 19.12.2017 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 189/2017), edhe atë:
   - "Debrishtë" komuna Rosoman për lëndën e parë minerale – mermer.
3. Koncesioni për eksploatim të lëndëve të para minerale ndahen për periudhë prej 30 vite.
4. Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë të gjitha subjektet e vendit dhe të huaj juridike dhe koncorsiume të cilët do të marrin dokumentacionin tenderues përmes sistemit elektronik www.e-koncesii.mk dhe do ti plotësojnë kushtet në pajtim me përcaktimet në dokumentacionin tenderues.
5. Në dokumentacionin tenderues janë të përmbajtura të dhëna në lidhje me lokalitetin për të cilin jepet koncesioni për eksploatim të lëndëve të para teknogene, si dhe vlera e ofertës të koncesionit i shprehur si shumë e vlerësuar fillestare e koncesionit dhe kushte që duhet të plotësohen nga ana e koncesionerit.
6. Ofertuesit duhet domosdo përmes sistemit www.e-koncesii.mk të dorëzojnë dokumentacionin e skenuar në vijim për të dëshmuar kushtet personale, profesionale dhe financiare që duhet ti plotësojnë për pjesëmarrje në Thirrjen publike:
   1) Dokument për veprimtari të regjistruar dhe gjendja aktuale
      - Për subjektet e vendit juridike: dokument për veprimtari të regjistruar dhe gjendja aktuale nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike: dokument nga organi kompetent – vërtetim se gjendet në regjistrin zyrtar tregtar që udhëhiqet nga ana e organit kompetent të shtetit ose vërtetim nga organi kompetent për certifikim që i plotëson kushtet të përcaktuara me ligj;
   2) Informata për gjendje ekonomiko-financiare të subjektit, raportet pozitive financiare, së paku për vitin e fundit. Nëse subjekti juridik është i regjistruar në periudhën më të shkurtë se ai, raportet financiare dorëzohen në periudhën prej regjistrimit
      - Për subjektet e vendit juridike: Informata për gjendje ekonomiko-financiare të subjektit të cilin e jep Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike: raporti pozitiv revizor nga institucioni revizor me renome të regjistruar për kryerje të revizionit. Raporti revizor të përmbajë të dhëna për punën e përgjithshme ekonomike të ofertuesit të huaj për vitin e fundit Nëse subjekti juridik është i regjistruar në periudhë më pak se kjo, raportet financiare të dorëzohen për periudhën prej kohës së regjistrimit;
   3) Certifikatë për tatimet dhe kontributet e paguara
      - Për subjektet e vendit juridike: të dhënë nga Drejtoria për të hyra publike e Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike dokument të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.
   4) Dokument se ndaj personit nuk ka procedurë se është në falimentim
      - Për subjektet e vendit juridike të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.
   5) Dokument se ndaj personit nuk ka procedurë se është në likuidim
      - Për subjektet e vendit juridike të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.
   6) Dokument se nuk i është shqiptuar dënim për vepër penale:
      - Për subjektet e vendit juridike Informacion për vendim gjyqësor penal të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.
   7) Dokument se nuk i është shqiptuar dënim në procedurë kundërvajtje ndalesë për kryerje të detyrës profesionale:
      - Për subjektet e vendit juridike të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
      - Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.
   8) Deklaratë të vërtetuar në noter nga personi përgjegjës se personi juridik ose anëtari i organit të tij për menaxhim ose organi mbikëqyrës nuk janë të dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për veprat penale në vijim: korrupsion, mashtrim dhe larje parash; (ANEKS G)
      - Për ofertuesit e huaj është e nevojshme që deklarata e tillë të jetë e vërtetuar në noter, ose nga ndonjë organ tjetër derisa në shtetin prej nga vjen ekziston institucion i tillë që kryen vlerësimin e llojeve të tilla të deklaratave.
   9) Deklaratë, të vërtetuar në noter se subjekti juridik duke përfshirë edhe subjektet e huaja juridike me filial të regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë më herët nuk i është marrë koncesion për hulumtime të detajuara gjeologjike ose eksploatim të lëndëve të para minerale, si dhe subjekti juridik i cili është i lidhur me atë subjekt juridik; (ANEKS E)
   10) Për konzorcium është e nevojshme çdo anëtar i grupit të plotësojë të gjitha kushtet personale, profesionale dhe financiare të kësaj pike

   Vetëm ofertat e ofertuesve të cilët janë të vlerësuar si të aftë do të jenë lëndë e evoluimit.
7. Ofertuesit patjetër përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë duhet të dorëzojnë garanci tenderuese në origjinal.
8. Oferta e tërësishme duhet të jetë në gjuhën maqedonase. Dokumentacioni shoqërues i ofertës, e cila kërkohet në pajtim me dokumentacionin tenderues, duhet të jetë e skenuar nga origjinali. Ofertuesit të cilët do të zgjidhen si më të volitshëm duhet të dorëzojnë në origjinal dokumentacionin të cilin më herët e kanë të skenuar dhe të vendosur në ueb portalin www.e-koncesii.mk, në afat prej 5 ditëve nga dita e pranimit të kumtesës dhe Vendimit për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm. Nëse bëhet fjalë për ofertues të huaj, ky dokumentacion duhet të përkthehet nga ana e përkthyesit të autorizuar gjyqësor në gjuhën maqedonase. Dokumentacioni nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga dita e hapjes së Thirrjes Publike, përveç se Raportit revizor.
9. Ofertuesit mund të dorëzojnë vetëm një ofertë për lokalitetin për ndarje të koncesionit për eksploatim të lëndës së parë minerale.
10. Dokumentacioni tenderues merret në mënyrë elektronike nga ueb portali: www.e-koncesii.mk. Të drejtë për marrje të dokumentacionit tenderues ka çdo subjekt i cili do të regjistrohet në ueb portalin: www.e-koncesii.mk. Të drejtë për pjesëmarrje në procedurën e mëtutjeshme të Thirrjes publike ka çdo subjekt i regjistruar në ueb portalin: www.e-koncesii.mk, i cili ka marrë dokumentacion tenderues, ka aplikuar me ofertë të vet dhe ka dorëzuar dëshmi për pagesë të realizuar për dokumentacionin e marrë tenderues. Dokumentacioni tenderues mund të merret në portalin: www.e-koncesii.mk
11. Ofertat duhen të jenë me afat të vlefshëm për një vit duke filluar nga data e ankandit publik.
    Për të aplikuar në thirrjen publike, ofertuesi i interesuar është i obliguar që të paguajë mjete të pakthyeshme në shumë prej 6.000,00 (gjashtëmijë) denarë, të skenojë fletëpagesën dhe ta postojë përmes sistemit në www.e-koncesii.mk.
    Pagesa duhet të bëhet në interes të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, me shenjë: për dokumentacion tenderues për ndarje të koncesioneve për eksploatim të lëndëve të para minerale në pajtim me Vendimin për fillim të procedurës për ndarje të koncesioneve për eksploatim të lëndëve të para minerale nr. 44-4187/1 të datës 19.12.2017 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 189/2017):
    Llogaria trezore: 100000000063095
    Llogaria e pagesës: 840_____06163
    Shifra e të hyrave dhe programi: 724125-00
    Deponent: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë
    Numri tatimor: 4030000392597
    Për ofertuesit e huaj:
    Ministria e ekonomisë
    Banka popullore e Republikës së Maqedonisë
    Bul. Kuzman Josifovski Pitu nr. 1
    1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
    SWIFT BIC: NBRM MK 2X
    IBAN: MK07 1007 0100 0028 009
12. Ofertat dorëzohen përmes portalit www.e-koncesii.mk, gjegjësisht vetëm Garancia tenderuese dorëzohet përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë.
13. Afati për dorëzimin e ofertave dhe Garancisë tenderuese është më së voni deri më 17.07. 2018 deri në ora 10.00. Do të shqyrtohen vetëm ofertat të dorëzuara përmes sistemit www.e-koncesii.mk. Dhe garancia tenderues e dorëzuar përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë.
14. Oferta duhet të përmbajë gjërat në vijim:
    - Ofertë,
    - Garanci tenderuese dhe
    - Dokumente me të cilat dëshmohet plotësimi i kushteve personale, profesionale dhe financiare të ofertuesit, të theksuara në pikën 6 të kësaj thirrje publike.
15. Gjatë zgjedhjes së ofertuesit më të volitshëm do të shqyrtohen vetëm ofertat që e përmbajnë dokumentacion e plotë në pajtim me Dokumentacionin tenderues.
16. Kriteri sipas të cilit do të bëhet zgjedhja e ofertës më të volitshme është kompensimi më lartë i ofruar i koncesionit, por jo më i ulët se çmimi fillestar për lokalitetin dhe lëndën e parë minerale teknogjene të kësaj Thirrje publike.
    Kushti për vlerësimin e ofertave është Garancia e rregulluar tenderuese.
17. Ankandi publik përmes sistemit për ankand elektronik www.e-koncesii.mk, do të mbahet më 19.07.2018 në ora 12.00.
18. Obligimet e koncesionerit do të përcaktohen në Marrëveshjen për koncesion për eksploatim të lëndëve të para minerale. Koncesioneri është i obliguar që hulumtimet e detajuara gjeologjike ta kryejë në pajtim me ligjet dhe rregullat në fuqi të Republikës së Maqedonisë.
19. Qeveria e Republikës së Maqedonisë: mund të kryejë ndryshim ose plotësim të dokumentacionit tenderues, më së voni 15 ditë para kalimit të afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave, të mos ndajë koncesionet ose plotësisht të ndërpresë procedurën.
20. Mënyra e evaluimit të ofertave:
    Dorëzimi i ofertave bëhet përmes portalit www.e-koncesii.mk, gjegjësisht vetëm Garancia tenderuese dorëzohet përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë. Evaluimi bëhet për të gjitha ofertat të dorëzuara deri më 17.07. 2018 deri në ora 10:00.
    Evaluimi i ofertave do të realizohet në dy mënyra, edhe atë:
    Në hapin e parë kontrollohet kompletimi dhe validiteti i Dokumentacionit të domosdoshëm. Nëse vërtetohet se dokumentacioni nuk është i kompletuar, oferta financiare nuk shqyrtohet dhe ofertuesit nuk i lejohet pjesëmarrje në ankandin elektronik.
    Në hapin e dytë, pas vërtetimit të kompletimit dhe validtetit të dokumenteve nga ana e Komisionit, shqyrtohet oferta financiare dhe lejohet qasja për pjesëmarrje në ankandin elektronik. Secili ofertues në sistem mund të shohë rangimin e tij në vijim në lidhje me ofertat financiare dhe mund të ofrojë në pajtim me rregullat e definuara të publikuara në sistemin www.e-koncesii.mk.
    Komisioni do të përpilojë Raport nga evaluimi i ofertave, në të cilën do të përshkruhet procedura gjatë evaluimit, ankandit elektronik, vërejtjet eventuale të Komisionit.
21. Organi kompetent për shqyrtimin e ankesave në procedurën për ndarje të koncesioneve për eksploatim të lëndëve të para minerale është Komisioni shtetëror i ankesave për furnizime publike (bul. "Ilinden" nr. 63 A, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë) Ankesa mund të shtrohet në afat prej tetë ditëve nga dita e:
    - publikimit të Thirrjes publike për ndarje të koncesioneve për eksploatim të lëndëve të para minerale në lidhje me të dhënat, veprimet ose lëshimet për ndërmarjen e veprimeve nga Thirrja publike;
    - evaluimi i ofertave, në lidhje me veprimet ose lëshim e ndërmarrjes së veprimeve në lidhje me dokumentacionin tenderues, gjegjësisht procedurën për evoluimin e ofertave dhe ankandit;
    - pranim të vendimit me të cilin vendos për të drejtë individuale nga procedura për ndarje të koncesionit për eksploatim të lëndëve të para minerale tehnogene në lidhje me vërtetimin e aftësisë së paraqitjeve për pjesëmarrje ose evaluim të ofertave dhe vendimit dhe
    - informatë për parregullsi gjatë procedurës së ndarjes së koncesioneve për eksploatim të lëndëve të para minerale tehnogene, më së voni në afat prej një viti nga dita e mbarimit të procedurës së realizuar.
22. Për të gjitha çështjet në lidhje me këtë thirrje publike kandidatët e interesuar mund të drejtohen tek personat e autorizuar për kontakt:

m-r Jeton Kuçi tel: +389 2 3093 519
e-mail: jeton.kuci@economy.gov.mk
Snezhana Trajanovska – Bogoeva tel: +389 2 3093 422
e-mail: snezana.trajanovska@economy.gov.mk

Komisioni për realizimin e procedurës për ndarje të koncesioneve për eksploatim të lëndëve të para minerale

JA SHTETET QË KUNDËRSHTOJNË ANËTARËSIMIN E SHQIPËRISË NË BE

Tri janë, sipas agjencisë "Reuters", vendet që e bëjnë momentalisht të pasigurtë çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me BE-në: Franca, Holanda dhe Danimarka.

Prandaj është e paqartë, – shkruan "Deutsche Welle", – nëse Komisioni Europian do të japë "dritën jeshile" në Samitin e BE-së në fund të qershorit, e ky dyshim qarkullon jo vetëm në qarqe të KE-së, por edhe të qeverisë gjermane.Duke cituar përfundimet e "Reuters", gjiganti mediatik gjerman thotë se brenda Berlinit ka zëra kritikë ndaj qëndrimit të Macronit, për të cilin thonë se nuk po e dallon rëndësinë gjeostrategjike të Ballkanit Perëndimor për stabilitetin e Europës. Ndërsa në Bruksel thuhet se, "presidenti francez ka ndjesinë se do t'u hapte krahun djathtistëve në

politikë, sepse për Shqipërinë mendohet menjëherë për kriminalitetin e organizuar". Edhe qeveria holandeze e argumenton qëndrimin e saj kundër me frikërat e brendshme. Komisioni Europian kërkon hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë, sepse të dyja vendet i kanë përmbushur formalisht kriteret dhe BE-ja duhet t'i qëndrojë fjalës së saj. Por, edhe në Gjermani ka dyshime lidhur me hapjen e negociatave brenda Unionit konservator. "Reuters" thotë se Kancelarja gjermane Angela Merkel dhe ministri i Jashtëm socialdemokrat, Heiko Mass, janë megjithatë për hapjen e negociatave. Në qarqet qeveritare kujtohet se bëhet fjalë për fillimin dhe jo përmbylljen e negociatave që zgjasin me vite.

Danas: "Vuçiq po e përgatit opinionin në Serbi për një katastrofë rreth Kosovës"

Autoritet serbe edhe më tej mendojnë se për zgjidhjen e nyjës së Kosovës ndarja do të ishte më e mira ashtu që Serbia do të merrte veriun e Kosovës dhe manastiret, porse Perëndimi nuk dëshiron as të dëgjojë rreth kësaj.

Kështu shkruan gazeta "danas", siç thotë, duke u thirrur, në qarqe diplomatike, transmeton Koha.net.

Mesazhi i pardjeshëm i kryetarit serb Aleksandar Vuçiq se "fuqitë e mëdha nuk e njohin, përkatësisht nuk e kanë ndër mend ta respektojnë rezolutën 1244 dhe kjo do të thotë se kemi shumë pak mundësi të bëjmë diçka" , i është dedikuar opinionit të brendshëm dhe atij në Perëndim para fazës së re të negociatave me Kosovën.

"Në kohë të fundit Vuçiq po e përgatit opinionin në Serbi se është e mundshme katastrofa e plotë lidhur me Kosovën dhe se në këtë rast është i mundshëm edhe një pozicionim i ri gjeopolitik i Serbisë, pra kthim më i madh drejt Rusisë", kanë thënë burime të kësaj gazete nga Beogradi, transmeton Koha.net.

Sipas tyre, Vuçiq edhe më tej shpreson në koncesione nga Perëndimi, përkatësisht se Perëndimi, përfshirë SHBA-në e BE-në, do të vlerësojnë se për shkak të paqes e stabilitetit të Ballkanit Perëndimor, Serbia të mos shtyhet në përqafim edhe më të madh drejt Rusisë.

Shqiptari u shpall sipërmarrësi i vitit në Itali

Çmimi i sipërmarrësit më të mirë të huaj në Itali këtë vit i ka takuar një emigranti shqiptar. Erion Kaso, 38 vjeç, u vlerësua nga juria në Romë në kategorinë e rritjes së biznesit, për suksesin e punishtes së tij të akulloreve në Padova.

Erioni u largua nga vendlindja e tij, Përmeti, në vitin 1997, vetëm 16 vjeç, për të emigruar fillimisht në Greqi. Pas 7 viteve shkollë e punë atje, ai u zhvendos në Itali për të ndjekur të fejuarën, Elisa Lazzaretto, me të cilën ka sot një fëmijë.

Fillimisht, Kaso punoi si punonjës në dyqanin e akulloreve "Gianni", të cilin ai vetë në vitin 2013 mundi ta ngrejë drejt suksesit. Disa vite më vonë, Kaso hapi edhe një dyqan tjetër dhe sot planifikon një të tretë. Madje vitin e kaluar, dyqani i tij i akulloreve u rendit mes 10 më të mirave në Itali falë gamës së gjerë me 30 shije të ndryshme me cilësi të lartë.

EFJ kërkon zbardhjen e vrasjes së gazetarëve në Kosovë

Kuvendi i Federatës Europiane të Gazetarëve (EFJ) sot e ka miratuar njëzëri Rezolutën me të cilën kërkohen hetime rreth vrasjes së gazetarëve në Kosovë.

Rezoluta është propozim i Shoqatës së gazetarëve të Serbisë, i shoqatave të tjera gazetare nga ky shtet si dhe nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK).Ajo kërkon hetime efikase rreth vrasjes dhe rrëmbimit të gazetarëve në Kosovë në periudhën 1998 – 2005.Reklamë

Sipas b92, kërkohet hetim më efikas për rrëmbimin e gazetarëve Gjuro Slavuj e Ranko Pereniq, vrasjn e Afrim Maliqit, Enver Malokut, Aleksandar Simoviqit, Kristë Gegajt, Momir Stokuqas, Shefki Popovës, Xhemal Mustafës, Bekim Kastratit dhe Bardhyl Ajetit dhe zhdukjen e Lubomir Knezheviqit dhe Marjan Melonashit si dhe rrëmbimin e Mila Buleviqit.Me rezolutë kërkohet bashkëpunimi i prokurorëve të Beogradit te të Prishtinës për zgjidhjen e këtyre rasteve.

Bie përgjysmë numri i lindjeve në Kosovë

Më herët, shumica e familjeve shqiptare të Kosovës kanë pasur shtatë, tetë fëmijë e dhjetë fëmijë. Sot, familja mesatare në Kosovë është 6 anëtarë.

Numri i lindjeve në Kosovë është përgjysmuar krahasuar me katër dekada më parë. Pavarësisht kësaj, kosovarët janë të parët në rajon me shtim natyror të popullsisë. Profesori Rifat Blaku thotë se shteti serb më së shumti i frikësohet natalitetit të kosovarëve.

Në dy vitet e fundit, në Kosovë, janë lindur mbi 60 mijë bebe. Shtimi i popullsisë ka rënë por përsëri kosovarët prijnë në rajon në aspektin demografik. Kjo e re nga Prishtina, nuk dëshiron të ketë më shumë se dy fëmijë në të ardhmen. Njëjtë si Ardita, edhe banorët e tjerë të Kosovës, për dallim nga disa dekada më herët, kanë ndërruar qëndrim për planifikim familjar.

Më herët, shumica e familjeve shqiptare të Kosovës kanë pasur shtatë, tetë fëmijë e dhjetë fëmijë. Sot, familja mesatare në Kosovë është 6 anëtarë. Edhe profesori i demografisë Rifat Blaku konstaton se shtimi natyror i popullsisë në Kosovë është përgjysmuar. Fajtor për këtë, sipas ti, është faktori ekonomik, social e psikologjik, raporton T7.

Krahas kësaj, sipas tij, Kosova është vitale në aspektin demografik në krahasim me vendet e tjera me numrin e lindjeve. Blaku komenton edhe deklaratat e Presidentit Vuciq, për shtimin natyror të popullsisë serbe. Sipas tij serbët kanë demofobi ose frikë nga shtimi i popullsisë së Kosovës. Mirëpo një politikë e tillë sipas Blakut, nuk funksionon. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se brenda katër dekadave të ardhshme, nëse nuk do të ketë shtim të popullsisë në Serbi, atëherë kombi serb rrezikon të zhduket. Madje, ai ka vënë edhe çmime për lindje të fëmijëve.

Për secilën familje serbe që do të kenë fëmijën e katërt, Vuçiq tha se do të japë shpërblim 18 mijë euro. Edhe në Kosovë ka pasur zotime se për secilën lindje Shteti do të ndajë mjete, por një premtim i tillë kurrë nuk është realizuar.

Donald Trump shtron iftar në Shtëpinë e Bardhë

Donald Trump shtron iftar në Shtëpinë e Bardhë: Të respektojmë traditën e njërës nga fetë më të mëdha në botë. Presidenti amerikan Donald Trump ka shtruar iftar në Shtëpinë e Bardhë, me rastin e muajit të shenjtë të Ramazanit.

Trump u ka uruar myslimanëve në mbarë botën agjërim të lehtë, dhe siç raporton AP, me këtë lëvizje ka befasuar komunitetin mysliman, për faktin se gjatë vitit të nuk e kishte bërë një gjë të tillë.

Para iftarit ai i është drejtuar të pranishmëve, komunitetit mysliman në SHBA dhe në mbarë globin me një porosi.

"Jemi mbledhur sonte, të respektojmë traditën e njërës nga fetë më të mëdha në botë", u është drejtuar Trump të pranishmëve, në mesin e të cilëve ishin edhe ambasadorët të vendeve myslimanë, Arabisë Saudite, Kuvajtit, Jordanit dhe Emirateve të Bashkuara Arabe.

Iftari organizohet në Shtëpinë e Bardhë qysh nga administrata e ish-presidentit Bill Clinton, kurse këtë traditë e kishte ndërprerë vitin e kaluar Trump.

Suedia mobilizon ushtrinë vullnetare

Suedia ka thirrur të gjithë vullnetarët e saj të ushtrisë për herë të parë pas më shumë se katër dekada në një përpjekje për të forcuar forcën e saj ushtarake.
Suedia, e cila ka një reputacion për neutralitetin, ka qenë për herë të fundit në luftë më tepër se 2 shekuj më parë.
Por prej aneksimit të Krimesë nga Rusia, ajo ka shtuar nivelin e sigurisë në rajonin Balltik.
Forcat e Armatosura të Suedisë testuan ushtrinë vullnetare të përbërë nga 22 mijë persona, për të testuar gatishmërinë e tyre.
Vullnetarëve iu kërkua të qëndronin në shërbim këtë të mërkurë, e cila është gjithashtu edhe dita kombëtare e Suedisë.
"Atyre iu kërkua të kryenin detyra patrullimi, mbrojtjeje dhe ruajtjeje", ka deklaruar ushtria suedeze.
Gjenerali Micael Bydén, komandanti suprem i Forcave të Armatosura të Suedisë, tha se ishte hera e parë që e gjithë forca ushtarake vullnetare ka pasur një mobilizim të tillë prej vitit 1975.

NEW YORK TIMES SHPËRTHEN NDAJ QEVERISË ITALIANE

Hitler u emërua kancelar në vitin 1933 pas një zgjedhjeje demokratike. Por ky fenomen aktualisht po vë në rrezik të vazhdueshëm drejtësinë dhe median e lirë.

Editorialisti i Nju Jork Tajms, Roxher Kohen është treguar shumë i ashpër në shkrimin e tij për qeverinë italiane duke e cilësuar sit ë mjerë dhe të neveritshme. Ai shkon më tej duke krahasuar fitoren e legës dhe Lëvizjes me Pesë Yje, me emërimin si kancelar të Hitlerit në vitin 1933.

Nju jork Tajms nëpërmjet shkrimit të editorialistit Roxher Kohen, është treguar shumë e ashpër ndaj qeverisë së re në Itali të përbërë nga Lega dhe Lëvizja me pesë yje. Një qeveri që është cilësuar e tmerrshme, fanatike dhe e mjerë. Ndër të tjera në shkrim thuhet se partitë që kanë fituar zgjedhjet dhe tashmë janë pjesë e qeverisë – lega ksenofobe dhe lëvizja me pesë yje anti semite – janë fanatike dhe të paafta në një masë shumë të pazakontë. Një grup i mjerë që janë ngritur në valën anti liberale globale. Kohen vijon më tej duke cituar dhe titujt e disa mediave gjermane që mbështesin qëndrimin e tij, dhe pse shton se është dakord me qeveritë që janë serioze në qëllimet e tyre dhe kjo nuk mund të përfshijë premtimet që nuk mbahen dot. Dhe për këtë arsye ai thekson se nuk sheh asgjë nga ajo që propagandohet në internet nga Lega dhe Lëvizja me Pesë Yje që të mos e neverisë.

Problem sipas Kohen është se disa herë demokracitë bëhen lëmsh dhe në fund krijohet një qeveri që nuk i pëlqen askujt. Në fund të editorialit ai bën një krahasim të papranueshëm: E di, Hitler u emërua kancelar në vitin 1933 pas një zgjedhjeje demokratike. Por ky fenomen aktualisht po vë në rrezik të vazhdueshëm drejtësinë dhe median e lirë.

TURQIA NGRE AVIONËT E LUFTËS

Turqia ka ngritur në fluturim avionë luftarakë që kanë gjëmuar mbi hapësirën ajrore greke, teksa tensionet mes dy vendeve fqinje sa vijnë e rriten, edhe për shkak të lirimit nga paraburgimi të 8 oficerëve ushtarakë turq të përshkruar si tradhtarë nga Ankaraja zyrtare.

Formacione avionësh "F-16" fluturuan në lartësi të ulëta mbi ishujt e Egjeut për mbi 20 minuta gjatë së martës, mes kërcënimeve dhe akuzave me nota të larta të Turqisë ndaj Greqisë për strehimin, siç i konsiderojnë turqit, e terroristëve.

Ankaraja është zotuar të përndjekë komandot, që sipas saj morën pjesë në përpjekjen e dështuar për grusht shteti në korrik të vitit 2016, kundër presidentit Recep Tayyip Erdogan dhe qeverisë së tij.

"Është detyra dhe detyrimi ynë t'i gjejmë këta ushtarë puçistë kudo që ndodhen. T'i rrëmbejmë ata dhe t'i kthejmë në Turqi", tha zv.kryeministri turk, Bekir Bozdag gjatë mbrëmjes së të hënës.

Ai kritikoi personalisht kryeministrin grek, Alexis Tsipras, për mosdorëzimin e ushtarëve në Turqi, pasi ata u arratisën dhe shkelën edhe hapësirën ajrore greke.

"Nga deklaratat e bëra në Greqi prej kryeministrit të tyre menjëherë pas puçit, ne krijuam opinion pozitiv se ata do të mund të ekstradoheshin në Turqi, – tha ai. – Ne menduam se Tsipras do ta mbante fjalën. Por, me kalimin e kohës kemi parë që autoritetet juridike të vendit helen janë mobilizuar në mbrojtje të tyre dhe këta puçistë nuk janë ekstraduar".

Fati i 8 ushtarakëve ka qenë në duart e grekëve që kur ata befasuan autoritetet lokale greke duke ulur helikopterin e tyre në periferinë veriore të qytetit kufitar të Alexandroupolisit, një ditë pas dështimit të grushtit të shtetit.

Komandot mohojnë të kenë qenë pjesë e puçit, që la 250 të vdekur dhe mbi 2.000 të plagosur. Të hënën, autoritetet greke i nxorën nga paraburgimi ushtarakët turq, e tashmë pas skadimit të periudhës 18-mujore të procesit paragjyqësor, ata edhe mund të burgosen teksa aplikojnë për azil. Ata janë zhvendosur në vende "top sekret" nën mbrojtjen e policëve të armatosur deri në dhëmbë.

Ndërmarrja publike "Parkiralishta Strumica" – Strumicë
rr. "Boro Xhoni" nr. 10, 2400 Strumicë
tel./faks 034 343787 e-mail: parkiralista_strumica@yahoo.com

Në bazë të nenit 37-e dhe nenit 37-i të Ligjit për ndërmarrjet publike (Gazeta Zyrtare e RM nr. 38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16 dhe 64/18), ndërsa në lidhje me nenin 20-g dhe 20 paragrafi 2 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Vendimit për punësim për kohë të pacaktuar në NP "Parkiralishta Strumica" – Strumicë me nr. 04-399/1 të datës 04.06.2018, U. D Drejtori i NP "Parkiralishta Strumica" – Strumicë, publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR 1/2018

Për punësim për kohë të pacaktuar të 5 (pesë) ofrues të shërbimit publik të Grupit III, nëngrupi V në NP "Parkliralishta Strumica" – Strumicë për vendet e punës në vijim:

1. KDR 0305A03061 Udhëheqës të departamentit për parkingje publike, Departamenti për parkingje publike, Sektori për parkingje publike dhe karrotrec,1 realizues.

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- Kualifikime profesionale, së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, Shkencat organizative dhe menaxhment, Shkencat juridike ose Komunikacion dhe transport
- së paku dy vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku një vit në vendin e punës në sektorin publik, gjegjësisht së paku katër vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vjet përvojë udhëheqëse të punës në sektorin privat.

Kompetencat e posaçme të punës
-njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, përmes parashtrimit të vërtetimit

Orari i punës:
Ditët e punës e hënë - e premte
Orët javore të punës 40
Orari i punës prej ora 08:00 deri në ora 16:00
Rroga neto: 21.819,00 denarë

VËREJTJE: Punësimet e planifikuara në pajtim me planin vjetor të institucionit për vitin 2018 janë: Maqedonas(e) 1.

2. KDR 0305B02070 Vozitës të makinës – karrotrec, Departamenti për shërbim të karrotrecit, Sektori për parkingje publike dhe karrotrec,1 realizues.

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- së paku nivel të kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërvjeçar
- së paku dy vjet përvojë pune në profesion
-Leje të vozitjes të kategorisë C

Orari i punës:
Ditët e punës e hënë - e shtunë
Orët javore të punës 40
Orari i punës me ndërrime
Rroga neto:15.302,00 denarë

VËREJTJE: Punësimet e planifikuara në pajtim me planin vjetor të institucionit për vitin 2018 janë: Maqedonas(e)

3. KDR 0305B02084 Vendosës të bllokatorëve, Departamenti për shërbim të karrotrecit, Sektori për parkingje publike dhe karrotrec, 2 realizues.

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- së paku nivel të kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërvjeçar
- së paku dy vjet përvojë pune në profesion
- Leje të vozitjes të kategorisë B

Orari i punës:
Ditët e punës e hënë - e shtunë
Orët javore të punës 40
Orari i punës me ndërrime
Rroga neto: 15.302,00 denarë

VËREJTJE: Punësimet e planifikuara në pajtim me planin vjetor të institucionit për vitin 2018 janë: Turk(e) 1.

4. KDR 0305Б02166 Elektromontues për ndriçim publik, Departamenti për ndriçim publik, 1 realizues.

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- së paku nivel të kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërvjeçar, elektroteknik
- së paku dy vjet përvojë pune në profesion

Orari i punës:
Ditët e punës e hënë - e premte
Orët javore të punës 40
Orari i punës me ndërrime
Rroga neto: 16.143,00 denarë

VËREJTJE: Punësimet e planifikuara në pajtim me planin vjetor të institucionit për vitin 2018 janë: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet ti përmbushin në momentin e paraqitjes në formë të shkruar.

Afati për paraqitje është 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Kandidatët janë të obliguar që fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, saktë dhe me të dhëna të sakta, fletëparaqitjen mund ta marrin nga arkivi i ndërmarrjes.

Fletëparaqitjet e plotësuara së bashku me shtojcat, kandidatët mund ti dorëzojnë personalisht në arkivin e NP "Parkiralishta Strumica" – Strumicë ose përmes postës në adresën: NP "Parkiralishta Strumica" – Strumicë, bul. Marshall Tito pn (në ndërtesën mbi Bankën Komerciale kati i 3-të) Strumicë.

Procedura për përzgjedhje të kandidatëve të paraqitur përbëhet nga kontrollimi i të dhënave të futura në fletëparaqitjen për punësim me kushtet e përcaktuara në shpalljen publike, kontrollim të dëshmive të parashtruara në fletëparaqitje dhe intervistë. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike, do të informohen për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë:
-biografi të shkurtë;
- certifikatë të shtetësisë,
-dëshmi për arsimin e mbaruar;
-dëshmi për përvojën e punës;
- vërtetim për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë (për vendin e punës - Udhëheqës të departamentit për parkingje publike)
-fotokopje të dokumentit për identifikim;
- fotokopje të lejes për vozitje (për vendet e punës Vozitës të makinës – karrotrec dhe vendosës së bllokatorëve);
- dëshmi për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
-dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Fletëparaqitja e dorëzuar pas afatit, jo e plotë dhe e parregulluar, nuk do të jetë lëndë e shqyrtimi nga ana e Komisionit për realizim të procedurës për punësim.

NP "Parkliralishta Strumica" – Strumicë
U. D Drejtor , Mitko Bujukliev

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes me letër

---

Në bazë të nenit 21, paragrafi 2 i Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra për punë sociale – Krushevë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 4 (katër) realizuesve për kohë të pacaktuar në IN QPS – Krushevë

IP Qendra për punë sociale – Krushevë publikon shpallje për punësim të 4 (katër) realizuesve për kohë të pacaktuar në pozitat në vijim

1. Psikolog – niveli A6 në Shërbimin e mbrojtjes sociale .....1 realizues
2. Pedagog - niveli A6 në Shërbimin e së drejtës së ndihmës në të holla .....1 realizues
3. Sistem operator për vendosje – niveli B2 në Shërbimin e së drejtës së ndihmës në të holla ..... 2 realizues

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra për punë sociale – Krushevë (për të gjithë kandidatët):
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra për punë sociale Krushevë:

Për vendin e punës me numër rendor 1 (një)
-Për nivelin A6 të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti filozofik – dega psikologji pa përvojë pune ose së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale;
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;

Për vendin e punës me numër rendor 2 (dy):
- Për nivelin A6 të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti filozofik – dega pedagogji pa përvojë pune ose së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale;
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;

Për vendin e punës me numër rendor 3 (tre) :
- Për nivelin B2 së paku nivel të kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërvjeçar.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë dëshmi për përmbushjen e kushteve, në formë origjinale ose kopje të vërtetuar në noter. Kandidatët për të gjitha pozitat e punës është e nevojshme të parashtrojnë dokumentet në vijim:
-Dëshmi për shtetësi;
- Dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë/diplomë për shkallë të mbaruar të arsimit;
- Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë për vendin e punës me numër rendor 1 (një) dhe 2 (dy);
- Certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- Biografi të shkurtë;
- Letër motivimi

Orari i kohës së punës: 40 orë punë në javë, kohë fleksibile e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 7.30/8.30 deri në ora 15.30 / 16.30.

Shuma në të holla e neto pagesës fillestare për vendin e punës me numër rendor 1 (një) dhe 2 (dy) është 23.181,00 denarë, ndërsa për vendin e punës me numër rendor 3 (tre) është 12.600,00 denarë.

Me kandidatët e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e shpalljes). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrohet në arkivin e IP Qendra për punë sociale Krushevë, ose përmes postës në rr. "Niko Doaga" nr. 66a (me shenjë "Për shpallje")

Personi për kontakt: Hrisulla Kuzmanoska, kontakt telefoni 071 816 210.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

IP Qendra për punë sociale Krushevë

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E STRUGËS

Nr. 09-2598/2

06.06.2018

STRUGË

SHESHI "NËNË TEREZA" P.N., 6330 STRUGË
./Tel. +389 46 781 335, 781 223, 782 015, /Faks 781 434
web: struga.gov.mk, e-mail: kryetari@struga.gov.mk, info@struga.gov.mk

Në bazë të nenit 50 paragrafit 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02), nenit 23 paragrafi 3 të Ligjit për Ndërmarrje publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15 dhe 39/16) dhe nenit 21 të Statutit të NP "Oktis" - Strugë, Kryetari i komunës së Strugës, shpall

KONKURS PUBLIK
për zgjedhje të drejtorit të
NP "Oktis" – f.Oktis

Komuna e Strugës ka nevojë për zgjedhje të drejtorit të NP "Oktis" – f.Oktis me mandat prej 4 (katër) viteve.

Kandidatët përveç kushteve të pëgjithshme të parapara me Ligj duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:
- Të ketë të kryer Arsim të lartë të nivelit VII/1, arsim të lartë ose arsim të mesëm;
- Të ketë përvojë pune të paktën 5 vjetë në profesion;
- Paga bazë neto mujore 25.000,00 denarë.

Kandidatët me fletëparaqitjen duhet të dorëzojnë:
- Program për punë dhe zhvillim të ndërmarrjes.
- Dëshmi për arsim të kryer në origjinal ose vërtetuar në noter;
- Certifikatë për shtetësi;
- Certifikatë që nuk i është shqiptuar aktvendim i plotfuqishëm për ndalim profesioni, veprimtarie ose detyrimi;
- Vërtetim mjekësor;
- Dëshmi për përvojë pune.

Konkursi zgjat 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet të pakompletuara dhe jashtë afatit nuk do të shqyrtohen.

Zgjedhjen e drejtorit e kryen Kryetari i komunës së Strugës në afat prej 10 ditëve nga dita e dorëzimit të dokumenteve nga ana e komisionit.

Fletëparaqitja me dokumentet e nevojshme të dorëzohen: në arkivin e Komunës së Strugës ose me postë në adresën Komuna e Strugës rr."Marshall Tito" – pn – Strugë, me shenje për Konkurs publik.

KOMUNA E STRUGËS
Kryetar i komunës,
Dr. Ramis Merko

м.п. / v.v.

Republika e Maqedonisë
Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të nenit 17, nenit 18 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nenit 20 paragrafi 1 dhe nenit 234 të Ligjit për energjetikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/2018), Qeveria e Republikës së Maqedonisë publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për emërimin e kryetarit dhe tre anëtarëve të Komisionit rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë

1). Me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë do të emërojë kryetarin dhe tre anëtarë të Komisionit rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë, duke patur parasysh përfaqësimin përkatës dhe të drejtë të anëtarëve të të gjitha bashkësive, me mandat prej pesë vjet.

2). Një anëtar i Komisionit rregullator për energjetikë duhet të jetë ekspert për çështje juridike nga sfera e energjetikës, një anëtar duhet të jetë ekspert për çështje ekonomike nga sfera e energjetikës dhe/ose shërbimeve të ujit, një anëtar duhet të jetë ekspert për çështje teknike nga sfera e shërbimeve të ujit dhe anëtarët tjerë janë persona profesional për çështje teknike nga sfera e energjetikës.

3). Mandati i secilit anëtar dhe kryetarit të Komisionit rregullator për energjetikë është pesë vjet dhe asnjë anëtar nuk mund të jetë në atë funksion më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

4). Funksioni anëtari i Komisionit rregullator për energjetikë kryhet në mënyrë profesionale dhe nuk është në lidhje me kryerjen e funksionit të tjetër publik ose funksion në parti politike ose vend të punës. Nëse anëtari i Komisionit rregullator për energjetikë ka qenë në marrëdhënie pune para emërimit, marrëdhënia e punës i pushon.

5). Kryetari i Komisionit rregullator për energjetikë prezanton dhe përfaqëson Komisionin rregullator për energjetikë në vend dhe jashtë vendit dhe ka të drejta, obligime dhe autorizime të tjera të përcaktuara me statut.

6). Për anëtar dhe kryetar të Komisionit rregullator për energjetikë mund të emërohet personi, shtetas i Republikës së Maqedonisë i cili plotëson kushtet në vijim:

- të ketë të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga sfera e elektroteknikës, makinerisë, teknologjisë, ndërtimtarisë, ekonomisë ose juridiku;
- në 15 vitet e fundit para emërimit të ketë së paku dhjetë vjet përvojë pune në energjetikë, gjegjësisht sigurim të shërbimeve të ujërave;
- së paku dy vjet para emërimit për anëtar të Komisionit rregullator për energjetikë të mos kishte qenë anëtar i këshillit mbikëqyrës ose drejtues ose këshillit të drejtorëve në shoqëri e cila kryen veprimtari energjetike, gjegjësisht veprimtari në lidhje me shërbimet e ujërave dhe
- dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

7). **Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët patjetër duhet të dorëzojnë dokumentacionin në vijim:**

- Biografi të shkurtë;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Diplomë për arsim të mbaruar sipëror me së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga sfera e elektroteknikës, makinerisë, teknologjisë, ndërtimtarisë, ekonomisë ose juridiku;
- Dëshmi se në 15 vitet e fundit para emërimit të ketë së paku dhjetë vjet përvojë pune në energjetikë, gjegjësisht në sigurimin e shërbimeve të ujit;
- Dëshmi se së paku dy vjet para emërimit për anëtar të Komisionit rregullator për energjetikë nuk ka qenë anëtar i këshillit mbikëqyrës ose drejtues ose këshillit të drejtorëve në shoqëri e cila kryen veprimtari rregullator të energjetikës, gjegjësisht veprimtari në lidhje me shërbimet e ujit;
- Dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

8). Dokumentet nga pika 7 duhet të parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter dhe të njëjtat të parashtrohen në arkivin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ose përmes postës në adresën: Qeveria e Republikës së Maqedonisë Bul. "Ilinden" nr. 2, 1000 Shkup, me shenjë **"Për shpallje publike për emërim të kryetarit dhe tre anëtarëve të Komisionit rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë".**

9). Neto pagesa e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit rregullator për energjetikë nuk mund të jetë më e lartë se mbledhja e pesë pagesave mesatare mujore neto pagesa të paguara në Republikën e Maqedonisë gjatë vitit të kaluar, sipas të dhënave të publikuara nga Enti shtetëror i statistikave.

10). Afati për paraqitjen e kandidatëve të interesuar është 5 ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes publike në gazetat ditore, **ndërsa deri më 14 qershor 2018.**

11). Dokumentacioni i pakompletuar dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit për aplikim nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Republika e Maqedonisë
KOMUNA E NEGOTINËS
Nr. 09-291
05.06.2018
Negotinë

Në bazë të nenit 11 paragrafi 3 të Ligjit për muzetë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 66/2004, 89/2008, 116/10, 51/11, 88/15, 152/15 dhe 39/16), nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16) dhe nenit 12 paragrafi 3 i Ligjit për Statutin e Institucionit komunal Muzeu i Qytetit të Negotinës, Kryetari i Komunës së Negotinës publikon

KONKURS PUBLIK

Për zgjedhje të drejtorit të Institucionit komunal Muzeu i Qytetit Negotinë

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushte e posaçme në vijim:

1. Të ketë të mbaruar shkallën e VII/1 të arsimit sipëror – shkencat shoqërore (fakulteti filologjik, fakulteti filozofik, fakulteti i historisë, fakulteti i historisë së arteve me arkeologji, fakulteti për arkeologji me histori të arteve, fakulteti për etnologji, fakulteti i artit figurativ)
2. Të ketë së paku 5 (pesë) vjet stazh pune në sferën e kulturës ose 5 (pesë) vjet përvojë pune të punëve ose projekteve në sferën e kulturës në bazë të marrëveshjeve të lidhura për vepër.
3. Të ketë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
   - TOEFEL IBT – së paku 74 pikë,
   - IELTS – së paku 6 pikë,
   - ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
   - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
   - BULATS – së paku 60 pikë ose,
   - APTIS – së paku niveli B2;

Mandati për drejtorin e zgjedhur zgjatë 4 (katër) vjet.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të dorëzojnë:

- Certifikatë të shtetësisë
- Certifikatë të mjekut
- Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ose ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Diplomë për arsimin e mbaruar
- Vërtetim për përvojën e punës
- Certifikatë për njohje të gjuhës angleze
- Propozim program për zhvillim të muzeut

Dokumentet e nevojshme të kandidatët duhet t'i parashtrojnë deri në Këshillin drejtues të Muzeut të qytetit Negotinë në rr. "Marshall Tito" nr. 119, Negotinë.

Afati për parashtrim të fletëparaqitjeve është 5 ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimt të konkursit në shtypin ditor.

Kryetari i komunës në afat prej 15 ditëve nga marrja e propozimit bën zgjedhjes së drejtorit.

Kryetari i Komunës
Toni Dellkov

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – Teksti i pastruar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/2015) dhe vendimit të U.D Drejtorit të Shkollës së mesme ekonomike dhe juridike të Qytetit të Shkupit "Arseni Jovkov – Shkup, publikohet

SHPALLJE

Për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar për vitin shkollor 2017/2018

1. Një mësimdhënës të lëndëve ekonomike me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë pune në javë, për kohë të caktuar për mësimin në gjuhën shqipe si zëvendësim të ndihmësdrejtorit për mësimin në gjuhën shqipe deri në kthimin e tij, por jo më gjatë se deri më 31.08.2018, me studime të mbaruara të ekonomisë dhe përgatitje të arritur pedagogjike-psikologjike dhe metodike, me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë.

Orari i punës së mësimdhënësve është në dy ndërrime edhe atë në ndërrimin e parë prej ora 7,30 deri në ora 13,20, ndërsa në ndërrimin e dytë prej ora 13,30 deri në ora 19,20 në pajtim me orarin e orëve.

Kandidatët për mësimdhënës duhet të njohin gjuhën letrare dhe alfabetin e gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi për çka do të bëhet kontrollim nga komisioni në shkollë, edhe atë për ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e theksuara në shpallje, ndërsa për terminin e kontrollimit do të informohen enkas me e-mail.

Dokumentet e nevojshme:

* Lutje me CV;
* Diplomë për arsimin e mbaruar përkatës (të vërtetuar në noter);
* Certifikatë të shtetësisë;
*Certifikatë për përgatitje të arritur pedagogjike-psikologjike dhe metodike.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentet dorëzohen në adresën në vijim: Shkolla e mesme ekonomike dhe juridike e Qytetit të Shkupit "Arseni Jovkov"- Shkup, rr "Kosturska" pn – Shkup, tel. 02/2611-195, personi për kontakt është sekretari i shkollës.

SHMEJQSH "Arseni Jovkov" – Shkup

Synimi kryesor i Entela Komninos me veprën e saj 'E vërteta për Nolin' është porosia dhe kërkesa që të folurit dhe të shkruarit të mbështeten në rregulla e retorikë, që aq shumë kishte nevojë në të kaluarën, ndërsa tash u bë domosdoshmëri e kulturës sonë kombëtare

RETORIKA DHE HISTORIA NË VEPRËN E 'E VËRTETA PËR NOLIN'

Izber Hoti

Në fillim të këtij vështrimi u gjenda para dilemës ta citoj Biblën: "Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ajo (fjala) ishte në fillim me Perëndinë. Të gjitha gjërat u bënë me anë të saj (fjalës), dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë." (Bibla, Gjoni 1), apo pohimin e Entela Komninos: "Në kohën kur punimi bëhej libër, një lajm krejt i shkencës së saktë e pa lidhje në dukje me retorikën, ngacmoi një nga konceptimet fillestare të punimit, që ishte quajtur 'Kohët e Nolit'. Shkencëtarët deklaruan se arritën të konservojnë kohën në kristal, fakt që portalet e pakta që e botuan, e quajtën shumë të çuditshëm, që u bë dhe më shumë i tillë nën citimin shkencor-filozofik se koha e baraspeshës në natyrë kishte kaluar" (Entela Komnino, 'E vërteta për Nolin', fq. 22).

Nuk e zgjodha citimin e Entela Komninos vetëm, sepse kishte të bënte me shkencë të saktë e drejtpërdrejt me histori, por për dy arsye: së pari, unë jam shqiptar dhe nuk duroj asnjë të dijë më shumë se unë, aq më parë një femër me moshë të vajzës sime dhe e dyta që pohimi i shkencëtarëve ende nuk është verifikuar, por për të filozofuar ishte i mjaftueshëm, aq më parë kur për ndaljen e kohës është menduar edhe në kohën e paradixhitalizimit.

U përcaktova për të dy citatet i vetëdijshëm se me citatin e dytë jo që nuk mendojmë kështu fjalë për fjalë dhe në mënyrë të thjeshtësuar as unë dhe as autorja e veprës 'E vërteta për Nolin'. Entela Komnino, por sepse është e vërtetë se kemi ndërmend dhe mendojmë për fjalën si njësinë bazë të retorikës dhe për vetë retorikën si pjesë e mundshme dhe e pamundshme e semantikës dhe semasiologjisë së shkencave shoqërore, para së gjithash të historisë së tyre, pse jo edhe të historisë si shkencë e përgjithshme shoqërore.

Kjo është e natyrshme kur kihet parasysh lidhshmëria e artit me shkencën, veçanërisht retorikës dhe shkencave shoqërore e në këtë kuadër historisë, synim i të cilave është gjetja e kodeve të veta të së kaluarës dhe të së tashmes, përkatësisht të bërit retorikë, historiografi, po të bërit edhe shqiptarë, sepse, siç shkruan Entela, në shekullin XIX dhe XX 'më lehtë bëheshe publicist shqiptar se shqiptar vetë'. Ama "nëse s'do të ishte as Rilindja, s'bëheshe dot as publicist" (E vërteta për Nolin, f. 40)

Thënë shkurt, duhej (dhe duhet) të bëhej Shqipëria dhe shqiptarët. Kështu do të duhej të bënin të gjithë. Kështu bëri edhe Fan Stilian Noli, sepse, siç dihet, ai nuk ishte vetëm personalitet kulture e historie, por edhe njëri nga ata që merreshin me to në mënyrë të dallueshme, dhe origjinale e me stil të veçantë, që nuk mund ta mohonin ata të cilëve nuk i pëlqenin qëndrimet dhe veprimet e Nolit. Kështu ndodh edhe me veprën Entela Komninos 'E vërteta për Nolin'. Edhe pse autorja është doktore në letërsi, ajo vërtet nuk e ndan letërsinë dhe historinë, por këtyre dy fushave u bashkëngjit edhe gazetarinë apo mediatikën në tërësi (të mos harrojmë mëdyshjen e saj në mes të kohës filmike dhe historisë), që dëshmohet nga kjo vepër dhe vepra e saj më e hershme"30 minutat e darkës '20" (1997), por edhe nga vetë jetëshkrimi i saj.

Mbështetur në këto të dhëna, studimet e saj, në veprën 'E vërteta për Nolin', marrin ngjyra e vlera të ndryshme dhe ç'është e rëndësishme ato janë origjinale, duke u bërë kështu shembuj për breza të ardhshëm për të cilët shoqëria, me gjithë ato që e shoqërojnë atë në kohë të ndryshme, bëhen objekt i studimit të tyre.

Mund të thuhet lirisht se Entela Komnino nuk synon të bëhet gjurmuese e pastër e njëres nga këto tri fusha (gjuhës e letërsisë, historisë e mediatikës), por e të triave së bashku. Kështu disi mendoi dhe veproi edhe Noli, i cili edhe nëse nuk është idoli i Entela Komninos, është i përzgjedhuri i saj për studim dhe trajtim të gjithanshëm të jetës dhe veprimtarisë së tij. Në të vërtetë, del se vetë jeta dhe veprimtaria e Nolit, sipas Entela Komninos, është rasti më i mirë "ku pasqyrimi i realitetit dhe figuracionit artistik zgjerojnë kuptimin dhe shkrimin e ekzistencës", që në njëfarë mënyre është edhe synimi i autores, gjithnjë duke pasur parasysh logos-in e leg-un, ligjërimin, që aq shumë ishte dhe është i përhapur tek shqiptarët, madje, edhe kur lotojnë (siç kujton Entela 'qaj me ligje').

Këtu mendoj se duhet shtuar se për autoren Entela Komnino retorika nuk është oratoria, por thënë ndryshe apo si e kuptoj unë, është shtjellimi vetë me mjete, forma e synime të caktuara (Entela Komnino, E vërteta për Nolin f. 12), pra nuk është thjeshtë stili i paraqitjes së materies i cili deri në vitet '90 përzihej në kulturën tonë të gjithëmbarshme. Po kështu për autoren e kësaj vepre zmadhimi si figurë retorike (jo stilistike) i përdorur në Publicistikën e Nolit nuk është i paqëndrueshëm ngase ka mbështetjen e vet, është i funksionalizuar, bëhet me qëllime e synime të veçanta në rrjedha kohore e hapësirë të caktuar, thënë ndryshe është i domosdoshëm dhe i natyrshëm.

Qasjet dhe format bashkëkohore të dëshmuara, por që pritet edhe më tej të dëshmohen, shfrytëzimi i një gjuhe të pastër e të pasur (nderur, pandehmë, vendkohë /sintagmë e krijuar nga autorja/ etj), ikja me mjeshtri nga shumë tabu të vjetra e të reja, në radhë të parë veprimi me ngulm mbështetur në origjinalitet, duke shfrytëzuar me mjeshtri fusha të ndryshme të jetës sociale, si dhe arritjet teknike, teknologjike e kibernetike, të cilave autorja i kushton rëndësi, e bën veprimtarinë e saj që shkurt mund të vlerësohet me sintagmën shkencë filozofike me një truall të sigurt e të mbështetur në ndjenja dhe shpirt, mu ashtu siç mendoj se do të duhej të bëhej në të gjitha veprat artistike dhe shkencore.

Thënë shkoqur, shkurt dhe si përfundim, synimi kryesor i Entela Komninos me veprën e saj 'E vërteta për Nolin' është porosia dhe kërkesa që të folurit dhe të shkruarit të mbështeten në rregulla e retorikë, që aq shumë kishte nevojë në të kaluarën, ndërsa tash u bë domosdoshmëri e kulturës sonë kombëtare.

Vjen në Shkup ekspozita "Pasditja e një ideologjie"

Ekspozita "Pasditja e një ideologjie" i paraqet veprat artistike në pronësi të galerisë me "sy joartistikë", duke kërkuar tek ato dëshmi të një kohe dhe mënyre që kanë përjetuar artistët, duke konsideruar se ata i kanë shkruar në gjuhën e tyre amtare faqet e mikrohistorisë së komunizmit dhe se krijuesi gjithmonë merr pjesë në "lojën e dyfishtë", ndërkohë që e paraqet realitetin dhe kjo lojë vepron brenda tij, është prezente në veprat e tij sipas dëshirës së tij, por edhe e pavarur nga ajo. Nga ky aspekt, cilësitë estetike nuk janë faktorë kyç në përzgjedhjen e pikturave dhe skulpturave, por nuk do të thotë se ato janë inekzistente – mes autorëve të tyre gjenden disa prej emrave më të rëndësishëm bullgarë, si: Ljubomir Dallçev, Ivan Kirkov, Vaska Emanuillova, Pavell Kojçev, Galin Mallakçiev, Atanas Jaranov, Dimitar Kazakov, Millko Bozhkov, Ljuben Zidarov, Andrej-Daniel, Nedko Sollakov, Vihroni Poshnedellev, Stanisllav Pamukçiev, Teklla Aleksieva, Vanko Urumov...Veç kësaj, të gjithë janë krijues të asaj kohe dhe vizitorët do të mund t'i ndjekin në mendimet e tyre dhe udhëzimet e tyre artistike.

Në këtë rast nuk është aq i rëndësishëm stili i tyre, sa ç'është ndjenja e mjedisit shoqëror si pjesë e veprave të tyre artistike. Mjedisi në të cilin kanë mbijetuar jashtë roleve të tyre publike, kur shkojnë në shtëpi ose për pak kohë i mbyllin sytë.

Në këtë gjurmim të "dëshmive artistike" për njeriun e thjeshtë në socializëm veçohen katër fusha tematike, të cilat kushtimisht mund të emërohen si në vijim: transport/qytet, dritare/kontemplim, përditshmëri/festë dhe fëmijëri/faj.

Ekspozita është pjesë e projektit afatgjatë "Syri tjetër", i cili ka për qëllim ta paraqesë dhe ta socializojë pasurinë dhe larminë e veprave të fondit të Galerisë qytetare artistike të Sofjes nëpërmjet syve të intelektualëve "joprofesionistë".

Katalogu i ekspozitës është në bullgarisht dhe anglisht dhe përfshin tekste të autorëve, të dy kuratorëve dhe një pjesë me vepra të përzgjedhura.

Ndërroi jetë shkrimtari Mateja Matevski

Në moshën 89-vjeçare ka ndërruar jetë poeti i njohur dhe akademiku Mateja Matevski. Matevski ka lindur në Stamboll në vitin 1929, fëmijërinë e ka kaluar në Gostivar, kurse ka studiuar në Beograd dhe Shkup, ku dhe ka mbaruar Fakultetin Filozofik.

Poeti i njohur është autor i shumë veprave poetikë ku disa prej tyre janë "Rrethi", "Bliri", "Lindja e tragjedisë", "Largësia", "Kulla e zezë", "Ikja e xixëllonjës".

Ndërsa presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga në vitin 2013 e kishte dekoruar akademikun me origjinë shqiptarë Mateja Matevski për veprën e tij jetësore dhe kontributin e dhënë në letërsi, shkencë dhe afrimin e popujve të Ballkanit.

Por poeti edhe akademiku Matevski gjatë pranimit të dekorimit kishte deklaruar se atij i vjen keq që s'mund të drejtohet në gjuhën shqipe, pasi shqipja e tij është dialektike dhe e harruar, si dhe kishte treguar që nuk ka banuar në Rekë dhe është rritur në Gostivar dhe Shkup, ndërsa shtëpinë e prindërve e kishte në Rekë, kurse atë rrugët e kishin çuar në drejtime të tjera, si shkrimtar dhe si gazetar.

Akademiku Matevski gjithashtu ka qenë edhe kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Maqedonase (ASHAM) në periudhën 2001- 2004, drejtor i përgjithshëm i Radiotelevizionit të Maqedonisë, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve në Maqedoni, si dhe i njohur me shumë çmime të fituara në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

SHKUPI PËRFORCON EDHE STAFIN

DEMIRI, "TEAM MANAGER" I RI I EKIPIT

"Unë do të jem urë lidhëse mes kryesisë,lojtarëve dhe stafit teknik, gjithashtu do angazhohem edhe te shkolla e futbollit për të ndihmuar maksimalisht që të prodhojmë' sa më shumë lojtarë për ekipin e parë si dhe lojtar për transferim jashtë vendit", tha për faqen e klubit Demiri

Shkup, 7 qershor - Për një skuadër stabile dhe me ambicie evropiane, pa dyshim se duhen shumë faktorë në ekip. Kryesia e klubit edhe pse ditët që lamë pas ka arritur të mbajë numrin më të madh të futbollistëve që rikthyen skuadrën në arenën ndërkombëtare, ka filluar dhe me përforcimet në skuadër që do të vazhdojnë të sjellin rezultate edhe në të ardhmen. Por së fundmi Shkupi ka përforcuar edhe stafin menaxhues të ekipit, duke afruar një emër të madh të klubit tonë dhe futbollit në përgjithësi. Bëhet fjalë për Ertan Demirin, i cili nga sot do të jetë në detyrën e menaxherit ekipor, apo "Team manager". Demiri menjëherë pasi ka vënë firmën e tij është prononcuar për faqen zyrtare të klubit, ku ka shprehë kënaqësinë që përsëri kthehet në folenë e tij të vjetër për të bërë punë të mëdha.

"Më në fund u ktheva në shtëpinë time. Falënderoj përzemërsisht kryesin e klubit për besimin e dhënë, besoj që me gjithë përvojën time do të kontribuoj që klubi të vazhdon të ngritët edhe më shumë. Ardhja ime te Shkupi është si rezultat i projektit shumë ambicioz dhe të sinqertë. Unë do të jem urë lidhëse mes kryesisë,lojtarëve dhe stafit teknik, gjithashtu do angazhohem edhe te shkolla e futbollit për të ndihmuar maksimalisht që të prodhojmë' sa më shumë lojtarë për ekipin e parë si dhe lojtar për transferim jashtë vendit. Dashtë Zoti do kemi shumë shëndet, suksese si dhe fatin sportiv ne anën tonë", ka thënë Demiri.

Demiri kishte një karrierë të bujshme si në vend, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Përveç se ishte futbollist i Shkupit, ka luajtur edhe te Rabotniçki, Vardari, Shkëndija, Metalurgu dhe Teteksi. Në Shqipëri me Besën e Kavajës, Vllaznin dhe Partizanin, në Belgjikë me Lokerenin, ndërsa ishte pjesë edhe e ekipit Al Tavon nga Arabia Saudite. Para se Demiri të vijë në postin e menaxherit sportiv te Shkupi, me shumë sukses kreu edhe detyrën e drejtorit sportiv te Trepça '89 nga Mitrovica.

BILALI, PËR NJË MBROJTJE MË TË FORTË

Skuadra e FC Shkupi pasi që të mërkurën ka promovuar përforcimin e parë, gjatë ditës së djeshme ka sjellë edhe një tjetër futbollist. Me skuadrën bardhekaltër është bashkuar qendërmbrojtësi 24 vjeçar Amir Bilali, me të cilin ka nënshkruar kontratë dy vjeçare. Bilali, te FC Shkupi vjen nga Superliga e Shqipërisë, ku ishte pjesë e skuadrës së Teutës, ndërsa para se të kalonte te Teuta ishte pjesë e skuadrës së Rabotniçkit, derisa posedon shtetësi të dyfishtë, shqiptare dhe të Maqedonisë. Bilali gjithashtu ka qenë pjesë e skuadrës së Bylisit, ndërsa ka luajtur edhe në kampionatin slloven me Celjen, si dhe ishte pjesë e U19 te Kremonezes e Lacios në Itali. "Jam shumë i kënaqur me mikpritjen e gjithë stafit, nga presidenca e deri te trajneri. Bisedova me menaxherët e mi të cilët më treguan për projektin qe ka ekipi i FC Shkupit, andaj nuk mendova dy herë për të qenë pjesë e ekipit që ka pas vete një traditë të madhe të futbollit. Nuk do të fsheh se kisha shumë oferta nga ekipe të Shqipërisë,

Maqedonisë por edhe jashtë vendit, por jam shumë i lumtur për zgjedhjen qe kam bërë. Tani duhet vetëm punë dhe sakrificë, e që me ndihmën e Zotit të fillojmë një aventurë të re dhe të arrijmë së bashku sa më shumë suksese. Te Shkupi me shumë dëshirë kamë ardhur duke e ditur edhe se çfarë tifozerie ka, të cilëve u premtoj se në secilën ndeshje do japim maksimumin si ekip që të kënaqim pritshmërit e tyre", deklaroi Bilali.

RENDITJA E FIFA-s

Kosova, 11-të vende më lartë

Shkup, 7 qershor - Shqipëria vijon me rënien e lirë në renditjen e FIFA-s. Shkak janë bërë dy humbjet e thella, respektivisht 3-0 me Kosovën, dhe 4-1 me Ukrainën. Shqipëria renditet në vend të 58 me 538 pikë, duke humbur edhe këtë muaj dy pozicione në renditje. Por ky trend negativ mund të thellohet deri në shtator për shkak të Botërorit dhe humbjeve radhazi të Shqipërisë.

Në anën tjetër Kosova ka bërë një hap të madh duke u ngjitur me 11 pozicione falë fitores së thellë ndaj Shqipërisë. Kosova renditet në vend të 141 me 197 pikë të grumbulluara, një rekord i ri për përfaqësuesen, e cila ka shumë pak kohë që është bërë anëtare në FIFA. Ndërkohë, përfaqësuesja e Maqedonisë ka regjistruar një lëvizje pozitive prej 6 vendeve. Edhe pse gjatë muajit të kaluar nuk zhvilluan asnjë ndeshje, verdhekuqtë tashmë shohin veten në pozitën e 71. Sa i përket përfaqësueseve që kryesojnë, kampionët e botës në fuqi, Gjermania vijon të kryesojë me 1558 pikë, ndërsa Brazili ndjek me 1431 pikë. Bie në sy rënia e Spanjës me dy pozicione, duke shkuar në vend të 10-të dhe ngjitja e Polonisë në vend të tetë. Po ashtu Anglia është përmirësuar me një pozicion dhe Uruguai me tre të tilla.

SIPAS GAZETES TURKE "FANATIK"

Hasani, futbollist i ri i Rizespor

Shkup, 7 qershor - Ferhan Hasani siç njofton gazeta e njohur sportive "Fanatik" do të transferohet te skuadra e Rizespor, skuadër kjo e cila këtë sezon arriti të plasohet në Superligën e Turqisë. "Buba" ka disa ditë që po qëndron në Turqi, ndërsa më në fund është bërë e ditur se ku do të vazhdojë karrierën e tij futbollistike. Sipas "Fanatik", bisedimet të cilat kanë filluar para disa ditëve, kanë ardhur në fazën finale. Cekim, gjatë ditëve të fundit Hasani lidhej me një transferim të mundshëm në Gallatasaraj, Sivaspor dhe Kasimpasha, por ja që në fund ka vendosur të pranojë ofertën e Rizespor. Me largimin e kapitenit Ferhan Hasani, drejtuesit e KF Shkëndija do të hidhen në sulm për të mbuluar këtë zbrastirë, duke marr parasysh se ai dhe Besart Ibraimi, kanë qenë hallka kryesore e ekipit.

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7 e Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 113/08.33/2010,116/2010....67/2017) dhe nenit 80 paragrafi 1 alineja 7 e Statutit të SHFK "Dame Gruev" – Gradsko, Këshilli i shkollës së SHFK "Dame Gruev" – Gradsko publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
për zgjedhje të drejtorit të shkollës

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim, në pajtim me Ligjin për arsim fillor:
- Të kenë të mbaruar së paku arsimin sipëror;
- Të përmbushin kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore.
- Të kenë së paku pesë vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimore;
- Të kenë të dhënë provim të dhënë për drejtor;
- Të kenë të dhënë test psikologjik dhe test për integritet.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:
- Diplomë për arsim sipëror të mbaruar
- Vërtetim për përvojë të punës në institucion edukativo-arsimor
- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor
- Certifikatë të shtetësisë
- Certifikatë për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet
- Program për punë për periudhë prej 4 (katër) vjet

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në tri gazeta ditore.
Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të parashtrohet te Këshilli i shkollës së SHFK "Dame Gruev" – Gradsko në adresën: rr. Marshall Tito nr. 68 – Gradsko me shenjë "për zgjedhje të drejtorit" ose personalisht në arkivin e shkollës.
Zgjedhja drejtorit dhe informimi i kandidatëve do të realizohet në pajtim me nenin 132 të Ligjit për arsim fillor.
Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Këshilli i shkollës së SHFK "Dame Gruev" – Gradsko
Bllagoj Ristov

Universiteti "Shën Klimenti Ohrit "- Manastir
FAKULTETI PËR TURIZËM DHE HOTELERI – OHËR
University "Sv. Kliment Ohridski" – Bitola
FACULTY OF TOURISM AND HOSPITALITY OHRID

Në pajtim me nenin 172 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare nr. 82 e datës 08.05.2018), Fakulteti për turizëm dhe hoteleri nga Ohri publikon:

KONKURS
Për zgjedhje të mësimdhënësit në të gjitha titujt mësimor – shkencor

1. **Një mësimdhënës për zgjedhje në sferat shkencore 50318 Ekonomika e turizmit dhe hotelerisë, 50328 Kontabilitet dhe 50329 Të tjera (sipas kualifikimit të njësive, fushave dhe sferave);**
2. **Një mësimdhënës për zgjedhje në sferat shkencore 50608 Marketing menaxhment, 50619 Menaxhment në sigurime dhe 50624 Të tjera (sipas kualifikimit të njësive, fushave dhe sferave);**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e dhëna me nenin 164, nenin 165 dhe nenit 166 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare nr. 82 e datës 08.05.2018) dhe akteve të përgjithshme të Universitetit dhe Fakultetit për turizëm dhe hoteleri – Ohër.
Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: diplomë për arsimin e mbaruar përkatës (magjistraturë ose doktoratë të mbrojtur), certifikatë për provimet e dhëna në ciklin e partë dhe të dytë të studimeve, certifikatë të shtetësisë, biografi të shkurtë me informata për përvojën e mëhershme të punës në profesion/sferën për të cilën është publikuar konkursi, listë të punimeve shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje të punimeve, vërtetim se njeh një prej gjuhëve të huaja.
Fletëparaqitja së bashku me dokumentet e tjera parashtrohen në katër kopje, deri në Fakultetin për turizëm dhe hoteleri – Ohër, personalisht ose në adresën: Kej "Maqedonia" nr. 95 – Ohër.
Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.
Shuma në të holla e pagesës mujore në shumë bruto për vendin e punës mësimdhënës është prej 41.524,00 den. deri në 49.338,00 den, sipas titullit të kandidatit të zgjedhur. Punëtori ka të drejtë të pagesës dhe kompensimit të pagesës të përcaktuara me ligj dhe akte të Fakultetit.
Pagesa bazë mund të jetë e ndryshueshme.
Java e punës zgjatë pesë ditë pune (e hënë – e premte).
Orari i punës është në pajtim me programet për realizim të Programeve studimore të Fakultetit për turizëm dhe hoteleri – Ohër.
Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 pika 7, nenit 128 dhe nenit 132 paragrafi 4, 5 dhe 6 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18), nenit 71 paragrafi 1 alineja 7 dhe nenit 77 të Statutit të SHFK "Koço Racin" Kratovë, Vendimit nr. 04-19/3 të datës 03.01.2018 nga Kryetari i Komunës së Kratovës dhe Vendimit nr. 02-286/3 të datës 06.06.2018 nga Këshilli i shkollës së SHFK "Koço Racin" Kratovë, Këshilli i shkollës pranë SHFK "Koço Racin" Kratovë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
për zgjedhje të drejtorit të SHFK "Koço Racin" – Kratovë

1. **Kandidati për drejtor të shkollës, krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligjin për marrëdhënie pune, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:**
   - Të kenë të mbaruar së paku arsimin sipëror (me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar);
   - Të përmbushin kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore.
   - Të kenë së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimore të verifikuar nga Ministria;
   - Të kenë të dhënë provim për drejtor;
   - Të jenë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
   - Të jetë i shëndoshë psikofizikisht dhe i aftë për punë;
   - Në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
2. **Kandidatët për drejtor të shkollës duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:**
   - Fletëparaqitje me biografi të shkurtë dhe letër motivimi;
   - Diplomë ose certifikatë për arsim sipëror të mbaruar;
   - Vërtetim për përvojë të punës në punë edukativo-arsimore;
   - Certifikatë për provim të dhënë për drejtor në shkollë fillore;
   - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë;
   - Certifikatë të mjekut (jo më të vjetër se gjashtë muaj);
   - Vërtetim nga gjykata kompetente;
   - Program për punë për periudhë prej 4 (katër) vjet;
3. Orari i punës së drejtorit është 8 orë pune në ditë ose 40 orë pune në javë, të shpërndara në pesë ditë pune prej ditës së hënë deri ditën e premte, me fillim prej ora 08 deri në ota 16.
4. Neto pagesa mujore fillestare është në shumë prej 26.833,oo denarë.
5. **Shpallja publike zgjatë 8 (tetë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.**
6. Zgjedhja do të realizohet në pajtim me nenin 132 të Ligjit për arsim fillor.
7. Me kandidatët të cilët do të përmbushin kushtet do të realizohet intervistë për çka do të informohen enkas.
8. Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter të parashtrohen deri te Këshilli i shkollës së SHFK "Koço Racin" Kratovë, rr. "Mihaill Apostollski" nr. 11, Kratovë, personalisht ose përmes postës, me shenjë për shpalljen e publikuar për drejtor të shkollës.
9. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Këshilli i shkollës së SHFK "Koço Racin" Kratovë

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – tekst i pastruar (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015) dhe Vendimit të Drejtorit të SHMEJQSH "Vasil Antevski – Dren" Shkup publikohet:

SHPALLJE PUBLIKE
Për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar për vitin shkollor 2017/2018 për mësimin në gjuhën maqedonase

1. Një mësimdhënës të grupit të lëndëve të ekonomisë me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë pune për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 dhe pagesë prej 21.522,00 denarë, me studime të mbaruara për ekonomi dhe me përgatitje të fituar pedagogjike-psikologjike dhe metodike.
2. Një mësimdhënës të psikologjisë afariste me 14 orë mësimore gjegjësisht 28 orë pune për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 dhe pagesë bazë prej 12.052,00 denarë, me fakultet të mbaruar filozofik – psikologji, pedagogji dhe pedagogji me filozofi.

Orari i punës së mësimdhënësve realizohet me ndërrime edhe atë ndërrimi i parë prej ora 7.45 deri më 13,30 ndërsa ndërrimi i dytë realizohet prej ora 14,00 deri në ora 19,40 në pajtim me orarin e orëve.
Kandidatët për mësimdhënës duhet të njohin gjuhën letrare dhe alfabetin në të cilën realizohet mësimi për çka do të ketë kontrollim nga ana e Komisionit në shkollë, edhe atë për kandidatët të cilët i përmbushin kushtet e theksuara në shpallje, ndërsa kandidatët për kontrollim do të informohen enkas përmes e-mail-it.
Dokumentet e nevojshme:
- Lutje me CV
- Diplomë për arsim të mbaruar përkatës të vërtetuar në noter
- Certifikatë të shtetësisë
- Kandidatët nga pika 1 dëshmi se kanë përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike.
- Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.
- Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentet të dorëzohen në adresë: SHMEJQSH "Vasil Antevski-Dren" Shkup, rr. Vera Josiq" pn Shkup, tel. 2777-343, personi për kontakt është sekretari i shkollës.

SHMEJQSH "Vasil Antevski-Dren" Shkup

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

Shërbimet mbështetëse të programi *Localworks*

USAİDğMaöedonia kërkon të kontraktojë shërbimet e një organizate lokale për të siguruar logjistikën e nevojshme për aktivitetet e dëgjimit dhe gjithashtu të ofrojë shërbime të nevojshme për të siguruar lëvizjen e vazhdueshme përpara në zhvillimin e programit *localworks*.

Të gjithë ofertuesit e interesuar mund të marrin Kërkesën për Kuotim (Ofertim) numër SOL_720165-18-Ö-00003 nga faëja e internetit të USAİDğMaöedoni në https©ğü ü ü .usaid.govğmacedoniağpartnership-opportunities

Data e fundit për pranimin e ofertave është 2 korrik 2018, ora 14Ç00.

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit të punësimit në sektorin publik dhe nenit 22 dhe 23 Ligjit të marrëdhënieve të punës, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, boton

SHPALLJE

I. Për nevojat e themelimit të marrëdhënies së punës për kohë të caktuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë, për vendet e punës siç vijojnë:
1. Referent për dorëzimin e materialeve zyrtare në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë – shërbimi qendror- një realizues;

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:
- Të ketë arsim të lartë ose të mesëm
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njërës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 14.900,00 denarë

II. Marrëdhënie e punës themelohet me orar të plotë pune – 40 orë në javë, prej të hënës deri të premten, ndërsa orari i punës ditore është prej 07:30 – 15:30
III. Bashkë me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dëshmi me të cilat vërtetohen kushtet e plotësuara.
IV. Shpallja zgjat pesë ditë pune nga dita e botimit të saj në shtypin e përditshëm.
V. Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen në arkiv ose nëpërmjet postës në adresën siç vijon: Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë – Shërbimi qendror, rr. "Vasil Gjorgov", nr. 43 Shkup.
Dokumentet e pakompletuara dhe ato që nuk dorëzohen brenda afatit, nuk do të merren në shqyrtim.

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

NUK KA KTHIM PAS

RONALDO LARGOHET NGA REAL MADRIDI

Kristiano Ronaldo ka vendosur. Do të largohet nga Reali i Madridit në merkaton e kësaj vere. Është e bindur për këtë gazeta portugeze "Record" e cila rikthehet të flasë për të ardhmen e yllit luzitan vetëm 12 ditë pas finales së "Champions League" që kulmoi me deklaratat e KR7-ës në fund të sfidës se të ardhmes së tij në Madrid i ka ardhur fundi

Kristiano Ronaldo ka marrë një "vendim të pakthyeshëm" për ta lënë Real Madridin, sipas gazetës portugeze, "Record". Premtimet për rishikim financiar të kontratës thuhet se janë thyer nga "Los Blancos" drejt pesë herë fituesit të "Topit të Artë", i cili e ndihmoi klubin madrilen të fitojë një trofe të tretë radhazi të Ligës së Kampionëve, muajin e kaluar. Paris Sen Zhermen mbetet një destinacion i mundshëm për sulmuesin portugez, i cili gjithashtu, mund të shkojë në Angli, ose Itali. Zëra të tilla ka pasur shpesh këto kohët e fundit, por konfirmimi vjen nga një media portugeze, e njohur për afërsinë që ka me KR7. Lajmet e saj për Ronaldon kanë qenë shumicën e rasteve të vërteta. Pra, në Portugali sigurojnë se Kristiano Ronaldo do të largohet nga "Santiago Bernabeu".

"Kristiano largohet nga Real Madridi". Ky është titulli i "Record" në faqen e parë të numrit të kësaj të enjteje. Sipas informatave nga gazeta portugeze, vendimi i yllit të "Los Blancos" është i i pakthyeshëm dhe do të jetë i motivuar prej "premtimeve të pambajtura nga Florentino Perez", në lidhje me përmirësimin e kontratës së tij me Merengues. Spanjollja "MARCA", duke iu referuar Hose Angel Sançez, menaxher i përgjithshëm i Real Madridit, bën me dije është zhvilluar një takim të martën me Jorge Mendes, përfaqësuesin e Ronaldos, në të cilin ai është informuar se klubi nuk është i gatshëm për të arritur atë që kërkon KR7 në negociatat për rinovimin e kontratës. Kështu, "Record" siguron që vendimi i Ronaldos "nuk është çështje e parave, por e njohjes". Dhe kjo është se portugezi nuk pëlqen premtime shumë të thyera për përmirësimin e kontratës së tij. Obsesioni është edhe me Nejmar, teksa Florentino Perez është gati të bëjë çmenduri financiare për të siguruar nënshkrimin e brazilianit. I gjithë ky siklet është trajtuar mirë nga KR7, qysh nga dhjetori, kur filloi të qeshë sërish me rënien e tij të supozuar të formës, si në vitin 2016. Pastaj erdhi lamtumira e trajnerit Zinedin Zidan, i cili ishte një "magnet" për të në "Bernabeu", sepse Kristiano Ronaldo nuk kishte më shumë lidhje personale me Madridin. Ishte lidhja e tij e madhe me Zidan që e mbajti te Real Madridi në mënyrë progresive, pas largimit të Pepe, Koentrao dhe Rodriguez. Përtej situatave emocionale, Ronaldo e ka nderuar gjithmonë punën e "Zizou" me Real Madridin si trajner: nëntë tituj në dy vite e gjysmë. Sipas të dhënave të "Record", "Italia, Franca dhe Anglia janë destinacionet e mundshme" të Kristiano Ronaldos, nëse largimi i tij nga Real Madridi më në fund konfirmohet.

Spaleti e Alegri miratojnë shkëmbimin Ikardi-Higuain

"Tuttosport" mëngjesin e së enjtes ka raportuar se trajneri i Juventusit Max Alegri dhe ai i Interit Luçiano Spaleti janë të hapur ndaj shkëmbimit Mauro Ikardit dhe Gonzalo Higuain. Qarkullojnë fjalë që bardhezinjtë janë të interesuar për Ikardin dhe se janë të gatshëm të ofrojnë yllin e tyre Higuain, si pjesë të marrëveshjes. Higuain në një intervistë gjatë ditës së djeshme u shpreh se ndjehej shumë i lumtur në Torino, por që nuk mohoi mundësin e një largimi, përkundrazi ai pranoi që do i pëlqente të luante në Premier Ligën angleze. "Tuttosport" gjithashtu raporton se Alegri dhe Spaleti kanë dhënë të dy miratimin e tyre, për këtë shkëmbim midis dy sulmueseve. Nëse të dy klubet do të miratojnë këtë marrëveshje lojtarëve nuk u ngelet gjë tjetër veçse të pranojnë negociatat.

PAVARËSISHT SE E KËRKON REALI I MADRIDIT

Alaba zotohet se do të qëndrojë në Munih

David Alaba thotë se nuk ka dëshirë të largohet nga Bajern Munihu, mes raportimeve se Real Madridi është i interesuar për të. 25-vjeçari austriak ka kaluar 10 vite me ekipin bavarez, duke i dhënë fund sezonit 2017-2018 me titullin e shtatë të Bundesligës, që nga debutimi i tij në vitin 2010. Anësori i majtë është lidhur vazhdimisht me një lëvizje drejt Spanjës, sidomos gjatë muajve të fundit. Babai dhe agjenti i tij e lanë derën hapur për një transferim të verës, muajin e kaluar, kur ai pretendoi se interesi i Real Madridit nuk është sekret. Megjithatë, Alaba ka hedhur poshtë deklarimin e tij për të dalë nga "Allianz Arena", pasi e ardhmja e tij mbetet në Bavari për momentin. "Unë jam duke qëndruar te Bajerni,—tha ai për "Bild".—Kam një kontratë deri në vitin 2021. Ndihem shumë mirë në Munih, nuk kam asgjë për të thënë për këtë", shtoi ai. Ndryshe, Bajern Munihu u rrëzua nga Ligën e Kampionëve, në gjysmëfinale, pasi humbi 4-3 në total ndaj Real Madridit, duke e dërguar në pesë vite periudhën që kur gjigandët gjermanë e morën më së fundi kurorën evropiane. Por Alaba është i sigurt se skuadra e tij mund të kërcejë përfundimisht dhe të shkojë gjatë gjithë rrugës në garën më prestigjioze të klubeve në Evropë. "Me skuadrën tonë kemi absolutisht potencial të vazhdojmë të arrijmë shumë larg në këtë garë,—vazhdoi ai, duke këmbëngulur se çështja nuk është poshtë, tek trajnerët që klubi ka caktuar. "Trajnerët tanë te Bajerni kanë treguar gjatë viteve të fundit se sa shumë përvojë kanë në krijimin e skuadrave të mëdha, që kanë qenë, gjithashtu, të suksesshme në Ligën e Kampionëve", përfundoi Alaba.

LAJME SHKURT

Nainggolan mund të shkojë në Kinë?

Ragja Nainggolan mund të largohet nga Roma gjatë verës. Mesfushori belg, i cili u la jashtë Botërorit nga trajneri Martinez, lidhet me një kalim të mundshëm te Interi apo në kampionatin kinez. Zikaltrit edhe vitin e kaluar janë përpjekur të transferojnë mesfushorin në Milano, por pa arritur një akord me Romën. Por më tepër se sa në "San Siro", Nainggolan lidhet me një kalim në Kinë, me Guangzhou Evergrande që është e gatshme t'i ofrojë futbollistit 12 milionë euro në vit ndërsa për Romën mund të shkojnë rreth 30 milionë euro.

Perin te Juve, punë e kryer

Matia Perin është portieri i Juventusit, të gjitha mediat në Itali raportojnë njëzëri se Juventus dhe Xhenoa kanë gjetur gjuhën e përbashkët për të kryer transferimin. Nga kjo marrëveshje Xhenoa do të arkëtojë 12 milion euro, plus tre milionë të tjerë shpërblime, ndërsa vetë lojtari ka nënshkruar kontratë katër vjeçare me "Zonjën e Vjetër", me të ardhura 2,5 milionë euro në sezon. Kështu Perin mbyll epokën me Xhenoan pas pesë vjetësh në këtë klub, dhe vjen në Torino me detyrën e vështirë për të zëvendësuar legjendën Gjianluigji Buffon.

Zhoao Marion për Dembelen

Mesfushori i Totenhemit, Mousa Dembele ka përfunduar në radarët e Interit. Edhe më herët belgu ka qenë i lidhur me një kalim në Serie A, pasi Milani dhe Juve kishin shfaqur interes për të, por së fundmi në skenë kanë dalë zikaltrit. Për të arritur te 30-vjeçari, Interi është i gatshëm të ofrojë kartonin e portugezit Zhoao Marios, i cili e mbylli sezonin pikërisht në Premier Ligë, i huazuar te Uest Hemi. Totenhemi e vlerëson mesfushorin rreth 30 milionë euro, ndërkohë që Inter për të lënë të lirë Zhoao Marion kërkon 35 milionë euro.

Publicitet

REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA DOGANORE

01.10.00.UP.001.02-OB.05.02

Në bazë të nenit 50 paragrafi 2 të Ligjit doganor ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr 39/05, 04/08, 48/10, 158/10, 44/11, 53/11, 11/12, 171/12, 187/13, 15/15, 129/15, 154/15, 192/15 dhe 23/16), nenit 94 paragrafi 2 dhe nenit 148 të Urdhëresës për zbatimin e Ligjit doganor ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 66/05, 73/06, 40/07, 62/07, 42/09, 48/09, 38/10, 46/10, 61/10, 141/11, 147/11, 158/11, 14/12, 2/13, 92/13, 177/13, 62/15, 11/15, 215/15, 192/16, 21/17 dhe 181/17) dhe pikës 8 të Udhëzimit të Drejtorisë doganore për kushtet minimale dhe mënyrën e përcaktimit të hapësirës punuese ku malli i automjeteve transportuese vihet në shikim dhe bëhet kontrolli nga ana e organeve doganore nr. 01-013669/15-0002 datë 10.03.2015.

DREJTORIA DOGANORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
Shpall
THIRRJE PUBLIKE Nr.3/18
Për mbledhjen e ofertave për të lidhur kontratë për shfrytëzimin e hapësirës punuese për këto organe doganore:

1. Njësia doganore Shkupi 3-1013 (për hapësirën e dedikuar për import dhe eksport – terminal),

Dokumentet të cilat ofertuesi duhet t'i dorëzoj dhe kushtet që duhet t'i plotësoj, si dhe mënyra e përzgjedhjes janë dhënë në Udhëzimin për kushtet minimale dhe mënyrën e përcaktimit të hapësirës punuese ku malli i automjeteve transportuese vihet në shikim dhe bëhet kontrolli nga ana e organeve doganore nr. 01-013669/15 datë 10.03.2015 i publikuar në faqen e internetit të Drejtorisë doganore www.customs.gov.mk, në linkun: "Udhëzimi për regullimin e punës të terminaleve doganore" nga ku edhe mund të merret.

Afati për dorëzimin e ofertave është 14 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike në mjetet e informimit publik.

Ofertat të cilat nuk do të dorëzohen në afatin e paparë, si dhe ato të cilat nuk do t'i përmbajnë të gjitha dokumentet e nevojshme nuk do të merren në shqyrtim.

Ofertat dorëzohen në këtë adresë:
Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë
Sektori për punë administrative dhe teknike
(me shënimin "për Thirrjen publike nr. 3/18")
Rr. Llazar Liçenovski nr.13
1000 Shkup

Nejmar nuk e fiton dot i vetëm Botërorin

Na kanë mbetur edhe 7 ditë nga starti i Kupës së Botës Rusi 2018, ndërsa janë mësuar edhe emrat e ekipeve pretendent për të fituar kupën. Ekipi më favorit është Brazili, por për legjendën e këtij klubi, Pele nuk është kështu. Ai në një deklaratë tha se klubi ka lojtarë shumë të mirë, ndërmjet tyre piketoi Nejmarin, si më të mirin në botë, por kombëtares braziliane i mungon fryma e grupit dhe për këtë ajo nuk mund ta fitojë kupën e botës. Në deklaratën e tij legjenda Pele u shpreh se: "Unë kam besim maksimal në aftësinë e Tites. Shqetësimi im i vetëm është se kanë mbetur vetëm disa ditë derisa të fillojë Kampionati Botëror dhe ne ende nuk e kemi ekipin e duhur. Individualisht të gjithë lojtarët janë shumë të mirë. Por ne nuk jemi një ekip. Nejmar, për mua, është një nga lojtarët më të mirë në botë. Është më i pjekur dhe ka më shumë përvojë, por nuk do të mund të fitojë i vetëm Kupën e Botës", përfundoi braziliani.

KRAMARIÇ, HISTORIA E KROATIT QË MPOSHTI SISTEMIN

Andrej Kramariç është një ndër futbollistët që do të përfaqësojnë Kroacinë në Kupën e Botës në Rusi dhe historia e tij është një histori triumfi kundër gjithë pengesave, kundër një sistemi kanceroz që ka zaptuar futbollin kroat prej dekadash

Gazetari kroat Aleksandar Holiga, për "The Guardian", ka përmbledhur historinë e jetës së Andrej Kramariç, një sulmues që ende nuk konsiderohet në nivelin e Manxhukiç apo Kaliniç, por që në Kroaci është shumë i respektuar, jo thjesht për dy golat që vlejtën fitoren ndaj Ukrainës në finalen plej-off për një vend në Rusi 2018.

Historia e Kramariç lidhet ngushtë me Zdravko Mamiç, oktapodi që ka mbërthyer futbollin kroat prej shumë vitesh. Derisa të mërkurën Gjyqi në Osjek i shqiptoi dënim Zdravko Mamiqit dhe të akuzuarit të tjerë për fshehje të tatimit dhe marrjes mito. Zdravko Mamiq është shpallur fajtor në të gjitha pikat e akuzës dhe do të qëndrojë në burg plot 6 vite e gjysmë, ndërsa vëllai i tij, Zoran Mamiq, do të duhet të qëndrojë pas grilave plot 4 vite e 11 muaj. Në Kroaci e dinë të gjithë që Mamiç vepronte edhe si agjent futbollistësh, firmoste me ta që kur ishin të rinj të panjohur dhe u merrte një pjesë të madhe të fitimeve nga transferimet. Edhe shitjet nga Dinamo e Zagrebit drejt klubeve të tjera çonin në xhepat e Mamiç miliona, ndërkohë që ai akuzohet se ka depozituar në Federatën Kristen edhe kontrata të parregullta, pa dijeninë e lojtarëve, pas shitjes së tyre, duke u marrë përqindje të mëdha fitimi. Në gjyq ishin thirrur edhe Lovren e Modriç, të cilët fillimisht pranuan se disa klauzola në kontratat e tyre ishin shtuar pas shitjes së tyre, por me pas ndryshuan dëshmi, duke përfunduar edhe vetë nën akuzë për dëshmi të rreme, ndërsa imazhi i tyre në Kroaci është shkatërruar.

E kundërta ka ndodhur me Kramariç, i cili nuk pranoi kurrë të firmoste kontrata të tilla me Mamiç he i shpalli luftë atij, derisa Dinamo e shiti të Rjeka, pas disa sezonesh ku nuk po luante rregullisht e po huazohet nga një klub në tjetrin. Te Rjeka Kramariç shpërtheu, me 55 gola në 2 sezone, duke kaluar në janar 2015 te Leiçester Siti në Angli. Aty nuk i eci, preferoi të largohej për të luajtur futboll, edhe pse vitin pasardhës Leiçesteri doli kampion Anglie. Kramariç shkoi tek Hofenhajmi dhe u bë superstar, duke u zgjedhur Lojtari i sezonit 2016/17 nga tifozët e Hofenhajmit dhe duke u përfshirë në formacionin e Bundesligës për sezonin e sapombyllur nga revista "Kicker".

Tani Kramariç shpreson ta tregojë veten edhe në Kupën e Botës, sepse ka treguar që është vendimtar për Kroacinë, sa herë luan. Një histori suksesi, në fushë dhe jashtë saj, për një lojtar të respektuar dhe të admiruar mbi të gjitha për karakterin e vet.

SKANDAL NË FIFA

Gjyqtari i Botërorit dhe zyrtari i lartë filmohen duke marrë ryshfet

BBC ka publikuar një investigim dy vjeçar në Afrikë, ku tregohet qartë se futbolli atje kontrollohet nga paratë e pista që përcaktojnë fatet e ndeshjeve. Në materialin prej dy orë video shfaqen mbi 100 raste kur gjyqtarët, futbollistët, trajnerët apo zyrtarët e lartë të futbollit marrin shuma parash për të përcaktuar ndeshjet në vende si Gana, Gambia, Mali apo vende të tjera në Afrikë. Gazetari Anas Aremeyav, i cili ka bërë përgjime të tilla nuk e ka zbuluar asnjëherë identitetin e tij para kamerave, por të gjithë në Gana e falënderojnë për nderin që po i bën futbollit. Në video shfaqet edhe gjyqtari Aden Marua duke marrë 600 dollarë kesh, gjyqtari në fjalë do të ishte

pjesë gjyqtarëve të Botërorit, por vetë gjyqtari më herët kishte vënë në dijeni FIFA-n se ishte tërhequr nga aktiviteti për arsye personale. Po ashtu është filmuar edhe vetë presidenti i Federatës Ganeze të Futbollit, Kvesi Nyantakyi, i cili shfaqet duke marrë 65 mijë dollarë kesh. Nantaki është anëtar dhe në Këshillin e FIFA-s, organit më të lartë drejtues të futbollit në botë.

TRANSFEROHET DY HERË NË KATËR DITË

Klubi fiton 3 milionë euro!

Stok Siti ka marrë sulmuesin Benik Afobe nga Vulverhempton, vetëm katër ditë pasi skuadra e sapo ngjitur në Premier Ligë e bleu nga Burnmaut, ekipi me të cilin ai u aktivizua në sezonin e kaluar. Afobe luajti i huazuar në pjesën e dytë të kampionatit të kaluar me Vulverhempton dhe shënoi gjashtë gola në 16 ndeshje, duke i ndihmuar të ngjiten në Premier Ligë. Katër ditë më parë, ai u ble përfundimisht, pasi u paguan 12 milionë euro te Burnmaut, në bazë të marrëveshjes paraprake. Gjithsesi, sot, sulmuesi nga Republika Demokratike e Kongos, kaloi zyrtarisht te Stok për 15 milionë euro. Pra, Vulverhempton fitoi tre milionë euro për katër ditët që pati pronësinë e kartonit të Afobe, i cili dikur ka qenë pjesë e Arsenalit.

DASHI 21. mars - 20. prill

Ky është momenti më i mirë për të nisur të eksperimentoni më shumë, sidomos në sferën profesionale. Kjo ditë do të jetë mjaft e favorshme për takime të reja dhe intervista pune. Tregohuni spontanë dhe të sigurtë në veten tuaj.

DEMI 21. prill - 21. maj

Mundohuni të mos përfshiheni në projekte që i njihni shumë pak, për shkak se mund të gjendeni në vështirësi të mëdha. Më mirë përqendrohuni në realizimin e gjithë atyre aktiviteteve, të cilat prej kohësh i keni lënë pas dore.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Kjo ditë do të jetë mjaft e favorshme për sferën profesionale, marrëveshjet dhe transaksionet. Do përparoni në sajë të një propozimi shumë interesant, i cili gjithsesi do të sjellë një sërë sakrificash.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Në dashuri do të përballeni me momente të vogla tensioni, të cilat duhet ti trajtoni me kujdesin maksimal. Në të vërtetë, nuk do të ndiheni aspak të përkëdhelur nga partneri/ja dhe kjo gjë do ju nervozojë.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Nisni të punoni intensivisht lidhur me realizimin e një projekti të ri, pasi në këtë fazë, do të keni mundësi të parandaloni të papritura të mundshme. Mundohuni të silleni me sa më shumë diplomaci me kolegët tuaj. Favorizohen takimet.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Do të jeni tejet të tërhequr nga një person me karakter shumë të fortë dhe këmbëngulës. Jeni gjithmonë në kërkim të një personi që t'iu tërheqë, por mos u përfshini në një aventurë, nëse nuk ndiheni gati që të përfshiheni edhe emocionalisht.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Duhet të mundoheni të jeni sa më të përqendruar në vendin e punës, pasi në këtë moment, duhet të tregoni se dini të mbani nën kontroll të gjitha situatat dhe bashkëpunëtorët tuaj. Mbrëmja parashikohet të jetë romantike dhe melankolike.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Do të jeni të inatosur dhe të acaruar dhe kjo për shkak të sjelljes së një personi, i cili po iu zhgënjen. Gjithsesi mundohuni që të mos tregoheni shumë agresiv si dhe fokusohuni në ato çështje që kanë vërtetë rëndësi për ju, si puna dhe familja.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Kjo e enjte do ju lejojë që të sheshoni çdo debat që mund të keni pasur dhe të riktheheni në harmoni. Megjithatë bëni kujdes me krenarinë e tepruar, pasi do ju pengojë që të veproni me diplomaci.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Do të ndjeni se ka disa zgjedhje të rëndësishme që duhen marrë, për ti dhënë një shtysë të rëndësishme karrierës tuaj. Kjo gjë do ju bëj të ndiheni nën presion, por mundohuni që të ruani qetësinë, pasi është diçka kalimtare.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Do të ndjeni se ka disa zgjedhje të rëndësishme që duhen marrë, për ti dhënë një shtysë të rëndësishme karrierës tuaj. Kjo gjë do ju bëj të ndiheni nën presion, por mundohuni që të ruani qetësinë, pasi është diçka kalimtare.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Kjo e enjte do të jetë mjaft interesante në fushën e ndjenjave, sidomos nëse së fundmi keni kaluar një periudhë aspak të favorshme. Këshillohet që të mos veproni në mënyrë shumë impulsive. Këshillohet që të jeni sa më të komunikueshëm në familje.

Mensur Mamuti

Mensur Mamuti	KËNGËTARJA UELLSIANE NË FOTO	SHTETET NË SHBA	KËNGË E KËNGËTARES NË FOTO "... I ZEMRËS"	MELIHATE AJETI						
LLOJ ËMBËLSIRE										
BALENA VRASËSE										
NAVY ELECTRONICS LABORATORY				FUTBOLLISTI SHQIPTAR I SLLOVENISË, IDRIZI (SHQ.)						
VEND NË ZVICËR										
ARMË E RËNDË ZJARRI (SH. PASHQ.)										
FUTBOLLISTI SHQIPTAR, AGOLLI										
JODI		ITRIUMI / BANORËT E QYTETIT RUMUN, ORADEA								
LËNGU I SYRIT / TRIM										
H					KOHA	QYTET NË FRANCË	KËNGË E KËNGËTARES NË FOTO "E HUMBUR ..."	ENERGJIA	ZHANRI I MUZIKËS SË KËNGËTARES NË FOTO	THEMELUESI I KLUBIT "GALLATASARAJ", FRASHËRI
KËSTI					TRUP I RRUMBULLAKËT, RRETH / AZOTI					
KOHA	KËNGË E KËNGËT. NË FOTO "MË SHUMË SE ..." / MUZEU I NJOHUR I MADRIDIT							ORGANIZATA LIRIA / SHUMË I RI NË MOSHË		
MBRETI I FUTBOLLIT, EDSON ARANTES DO NASCIMENTO					VEGËL MUZIKORE POPULLORE / ELIDA TOPÇIU					
RADIUMI			ELEMENT KIMIK (NE) / INTERNATIONAL NETWORK OF UNIVERSITIES						SUEDIA / LEZET	
NDIHMË, ASISTENCË						PJESË E SHKËPUTUR / LORO KOVAÇI				
KËNGËTARI BOSHNJAK, MERILIN					LEJIM, LIRIM / AUSTRIA					
ENË PËR TË BËRË NEVOJËN FEMIJËT							JO I MOSHUAR			

ZGJIDHJET: BOEM, ORKA, NEL, IGIS, TOPA, ANSI, J, IT, LOTI, HERO, RATA, SFERA, DASHNOR, OL, PELE, SHARKI, RA, NEONI, S, ASIST, COPA, DINO, LËSHIM, OTURAK, I RI.

Sudoku

shumë i lehtë

	5		3				4	
6								5
	1	9	5	8		3	6	
				3		2		6
		8	2		1	5		
9		2		4				
	8	4		6	3	9	2	
7								8
	3				4		5	

mesatar

		1	5		9	3		
	2			3			4	
			6		4			
3		7				9		1
	8						7	
4		2				5		6
			9		2			
	6			1			5	
		3	7		5	2		

Shumë i lehtë: 857326149, 623419785, 419587362, 145938276, 368271594, 972645813, 584763921, 796152438, 231894657. **Mesatar:** 641579328, 729138645, 835624197, 357246981, 986351472, 412897536, 574962813, 268413759, 193785264.

Turizmi, malazezët i sjell më shumë përfitime Shqipërisë

Një shtetas nga Kosova qëndron në Shqipëri mesatarisht 3.8 ditë dhe 83% e tyre qëndrojnë në hotel, ndërsa shpenzimi mesatar ditor për person arrin në 55 euro. Gati njëlloj janë me shpenzimet edhe shtetasit nga Maqedonia. Por për sa i përket shpenzimeve që bëjnë, malazezët janë më të pakursyer në argëtim

Vitet e fundit, në Shqipëri është shënuar një rritje e numrit të turistëve nga disa prej tregjeve të synuara europiane dhe botërore. Megjithatë ata që merren me turizmin e dinë shumë mirë se sa peshë ka një turist shqiptar dhe sa një i huaj kur vjen puna për të bërë pagesat.

Por cilët janë turistët që i sjellin më shumë përfitime ekonomisë shqiptare? Nuk diskutohet që vendin e parë vijojnë ta mbajnë turistët fqinjë nga Kosova dhe Mali i Zi, të cilët ndonëse kanë një tendencë për ta braktisur vendin amë mbeten përsëri të parët sidomos në vijën bregdetare. Sipas Scan Tv, një shtetas nga Kosova qëndron në Shqipëri mesatarisht 3.8 ditë dhe 83% e tyre qëndrojnë në hotel, ndërsa shpenzimi mesatar ditor për person arrin në 55 euro. Gati njëlloj janë me shpenzimet edhe shtetasit nga Maqedonia. Por për sa i përket shpenzimeve që bëjnë, malazezët janë më të pakursyer në argëtim.

Shpenzimet ditore për person të një turisti nga Mali i Zi arrijnë në 105 euro dhe 93% e tyre zgjedhin luksin e një hoteli, për një kohëzgjatje mesatare prej 2.7 ditësh. Malazezët janë kombësia që shpenzon më tepër ndër grupin e 5 shteteve me vizitorët më të shumtë në Shqipëri. Pas tyre ndjekin italianët që prishin 92 euro në ditë për person, por për një kohëzgjatje më të madhe me mesatarisht 6.2 ditë. Edhe turistët nga Greqia kanë një mesatare të mirë shpenzimi, prej 78 eurosh në ditë, duke llogaritur që një turist i huaj në vendin tonë shpenzon mesatarisht 63 euro në ditë. Ajo që vihet re është një rritje e numrit të turistëve të huaj, sidomos gjatë vitit të kaluar.

Gjatë sezonit veror të 2017 ka patur një rritje të numrit të vizitorëve ku përmenden rritja me 111% e vizitorëve ukrainas, rritja me 63% e vizitorëve suedezë, rritja me 42% e vizitorëve bullgarë, rritja me 33% e vizitorëve norvegjezë, rritja me 30% e vizitorëve polakë dhe rritja me 22% e vizitorëve kroatë.

ISLANDA, vendi më paqësor në botë

Instituti për Ekonomi dhe Paqe me seli në Sidnei publikoi të mërkurën Indeksin e Paqes Globale, duke radhitur 163 shtete dhe territore në bazë të nivelit të tyre të paqes. Lista u përpilua me matjen e gjendjes në tri fusha: siguri sociale, konflikt të brendshëm dhe ndërkombëtar dhe militarizim. Islanda mbetet vendi më paqësor në botë, një pozicion që ka që nga viti 2008, ndërsa Siria mbetet e fundit në listë për të pestin vit me radhë. Nga vendet e Ballkanit, Kosova radhitet më keq, në vendin e 92-të, pastaj vjen Bosnja në pozitën numër 89, Maqedonia 87, Mali i Zi 58, Serbia 54 dhe Shqipëria 52.

Dy herë fitues i lotarisë, sfidon ligjet e probabilitetit

Të fitosh një milion euro në lotari është fat i madh. Por, të fitosh dy herë në të njëjtën lotari brenda një periudhe kohe prej vetëm 18 muajsh, kjo do të thotë të sfidosh ligjet e probabilitetit. E megjithatë, një gjë e tillë ka ndodhur në Evian të Francës, ku një burrë, identiteti i të cilit nuk bëhet publik, do të fusë në xhep edhe një çmim të dytë, megjithëse mundësitë për këtë ishin një në gati 16 trilionë. Gazeta "Le Parisien" thotë se personi nga rajoni Haute-Savoie, ka pasur bileta fituese të lotarisë "My Million" më 11 nëntor 2016 dhe më 18 maj të këtij viti. Lotaria është e lidhur me "Euro Millions", e cila ofrohet në 12 vende europiane, dy herë në javë, me një çmim të madh prej 100 milionë eurosh. Francezët që blejnë një biletë të "Euro Millions" hyjnë automatikisht në shortin "My Million", ku mund të fitohet edhe shuma një milion euro. Në këtë rast, ndryshe nga "Euro Millions", lojtarët nuk i zgjedhin dot numrat në biletë. Ato përcaktohen rastësisht. Fati i lojtarit francez i ngjason atij të një australiani, që fitoi muajin e kaluar dy herë në një lotari lokale, duke rrëmbyer gati 2.5 milionë dollarë.

KALENDARI HISTORIK 8 QERSHOR

65 - Revolta e hebrenjve kundër Romës, duke okupuar kështjellën e Antonias në Jerusalem
452 - Italia pushtohet nga Atila i Hunëve
979 - Luigji V kurorëzohet Mbret i Francës
1191 - Riçardi I arrinë në Aka të Izraelit për të filluar kryqëzatën e tij
1829 - Pishina e parë komunale jashtë Londrës është hapur në Liverpul
1861 - Lufta Civile në Amerikë - Tenesi shkëputet nga Unioni
1896 - Vidhet vetura e parë
1949 - Siam ndryshon emrin në Tailandë
1967 - Izraeli sulmon anijen USS Liberty në Detin Mesdhe duke vrarë 34 anëtarë të ekuipazhit
1968 - Loja e parë e golfit pa gravitet është luajtur në hënë
1969 - Gjenerali Franko mbyllë kufirin e Spanjës me Gjibraltarin
1974 - SHBA dhe Arabia Saudite nënshkruajnë kontratë ekonomike-ushtarake
1995 - Piloti i rrëzuar i Forcave Ajrore Amerikane, Kapiteni Skot O'Gradi shpëtohet nga Marinsat amerikan në Bosnjë.

A E DINI SE...

Në çdo pesë sekonda një person humb jetën si pasojë e konsumimit të duhanit. Kështu rezulton një studim i fundit nga një shkencëtar në Britani. Një total prej tre milionë njerëzve kanë vdekur për shkak të sëmundjes pulmonare obstruktive kronike, një çrregullim të mushkërive të shkaktuara nga pirja e duhanit, sipas statistikave më të fundit nga 2016. Kjo përbënte gjashtë për qind të vdekjeve globale. Për më tepër, sëmundja e frymëmarrjes pritet të bëhet vrasësi i katërt më i madh deri më 2020, prapa sëmundjeve të zemrës dhe kancerit. Të dhënat tronditëse u liruan gjatë një seminari të organizuar nga pulmonologu Syed Zafaryab Hussain, një ekspert i sëmundjeve që lidhen me frymëmarrjen.

BARSOLETA

I DEHURI

Në gjykatë e pyet gjykatësi të paditurin: I paditur pse keni hyrë në kopsht zoologjik dhe keni tentuar të vidhni dhinë?

I padituri: I nderuar gjykatës, kam qenë tepër i dehur, nuk e dija as kah shkoja e as çfarë bëja.

Gjykatësi: Pasi që ishe i dehur, pse nuk hyre tek ariu?!

THËNIA E DITËS

Asnjë mendje e madhe nuk ka ekzistuar ndonjëherë pa një farë çmendurie! **(ARISTOTELI)**